

Parlament
Edhe një
dështim për
Ligjin e gjuhëve

Fq.3



**BISEDIMET
PËR EMRIN**

Zaevi nuk
do "vija
të kuqe"

Fq.3



Shpreson
të transfe-
rohet te
Reali

Hazard

Fq.19



Koha

www.koha.mk



**Çështja jonë ka
filluar të lëvizë
mbrapshtë!**

Fq.12-13

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3310 · e mërkurë 7 mars, 2018

6°C | 16°C

15 DEN

FORUM

**Shqiptarët e
Maqedonisë
dhe ndërtimi
i shtetit**



Politika shqiptare në Maqedoni
edhe një herë po përballet me
sfidën e ngritjes së projekteve
afatgjata, të ndërtimit të shtetit
ose shfrytëzimit të resurseve në
dispozicion për nevojat të politikës
ditore. Kjo situatë po na përsëritet
në vazhdimësi...

Fq.10

RAJON

**Në pritje të
seancës për
Demarka-
cionin**

Fq.14

GLOBI

**BITCOIN,
skema pirami-
dale e kohëve
moderne**

Fq.15

EDITORIAL

**Dy bedelë rus
në Maqedoni**

Fq.2



ASHAM REFUZON TRE KANDIDATURA SHQIPTARE

VETËM CEKA DHE KALESHI ARRIJNË NË KUVEND



Dy kandidaturat, ajo e Zamir Dikës për në Departamentin e Shkencave Teknike, dhe Mirushe Hoxha për në Departamentin e Shkencave Shoqërore dhe atë të Linguistikës, nuk kanë arritur të marrin mbështetjen e nevojshme në votimin e parë që bëhet nëpër departamentet respektive, duke u eliminuar kështu nga konkurrimi

Fq.7

“Identiteti ruhet me Rusinë e jo me NATO-në”

Shkup, 6 mars - Rreth 400 persona kanë mbushur sallën e konferencave në Hotelin Kontinental të Shkupit ditën e shtunë, ku shumë prej të pranishmëve mbetën në këmbë. Ata ishin atje për të parë yllin mysafir të panelit, analistin, strategun dhe filozofin rus, Aleksandar Dugin, një filozof rus, i cili shpesh cilësohet të jetë “filozofi i preferuar” i kryetarit rus, Vladimir Putin. Dugin, i shoqëruar nga një analist

tjetër i shquar rus, Leonid Savin ishin mysafir në panelin e organizuar nga një parti e vogël proruse “Të bashkuar për Maqedoni”, e cila e zgjodhi këtë emër për të nderuar dhe asocuar me partinë e Putinit, “Rusia e Bashkuar”.

Ndonëse mysafirët rus nuk gjenden në listën këshilltarëve zyrtarë të Putinit, shumica e shohin Dugin si “ideologun” kryesor ose “trurin” e Kremlinit. Sidoqoftë, Dugin...

Fq.4



EDITORIAL

DY BEDELË RUS
NË MAQEDONI

Emin AZEMI

Hulumtimet e herë pas hershme të opinionit publik që janë bërë në Maqedoni, kanë nxjerrë në sipërfaqe disponime të ndryshme sa i përket orientimit të qytetarëve, duke mos fshehur euroskepticizmin si emërues i përbashkët i të gjitha refuzimeve e nismave që vijjnë nga Brukseli e Uashingtoni. "Nëse nuk na duan në Bruksel, të hedhim sytë nga Lindja", është ky lajtmotivi i një thirrjeje në kontinuitet i euroskepikeve maqedonas në Shkup, të cilët haptazi propagandojnë aleanca ekonomike e ushtarake me vendet e Azisë dhe Rusinë.

Këta euroskeptikë të shtunën në Shkup kishin rezervuar një debat me dy analistë nga Rusia, të cilët kishin ardhur në Maqedoni për të dëshmuar prezencën ruse në këto hapësira. Rusia nuk do ta pengojë Maqedoninë që të hyjë në BE ose në NATO. Maqedonia dhe populli maqedonas duhet vetë të vendosin, por duhet të kenë zgjedhje, kanë porositur Aleksandar Dugin, këshilltari i parë i presidentit rus, Vladimir Putin, që njihet njëri nga kreatorët e strategjisë gjithësllovene të Rusisë, në një panel me temën "Republika e Maqedonisë në aleancë strategjike me Rusinë dhe anëtarësimi në Unionin ekonomik Euroaziatik". Sipas vëzhguesve të shumtë Dugin njihet edhe si kreator i strategjisë antiperëndimore të Rusisë.

Në këtë debat mori pjesë edhe Leonid Savin, këshilltar i dytë i Putinit, kurse organizator ishte partia "Të bashkuar për Maqedoni", e Janko Baçevit, emri i së cilës vjen sipas modelit të partisë së Putinit "Të Bashkuar për Rusinë".

Me doza të theksuara rezerve se gjoja Perëndimi nuk është zgjidhje e mire për Maqedoninë, Dugin dhe Savin thanë se Maqedonia duhet të mendojë edhe për opsionin "Unioni ekonomik euroaziatik". Maqedonia nuk duhet të mendojë për anëtarësim në BE, i cili po shkatërrohet, por për një farë aleance ballkanike dhe gjithësi bashkëngjitjen "Unionit ekonomik euroaziatik", porositën ata.

Leximi i keq i këtyre modeleve, krijon për opinionin publik iluzion të rrejshme për një aleancë pansllave, e cila në një të ardhme po rivendoska balancat e humbura në Ballkan dhe po rikthyeka drejtësinë e munguar në favor të popujve të dëmtuar, si maqedonasit, të cilët "nuk duhet të mendojë për anëtarësim në BE, i cili po shkatërrohet, por për një farë aleance ballkanike dhe gjithësi bashkëngjitjen "Unionit ekonomik euroaziatik".

Aleksandar Dugin dhe Leonid Savin, këta bedelë të pansllavizmit që kishin ardhur nga Moskë për të përhapur frymën antieuropiane, nuk sollën as edhe një pike referuese të ndonjë historie suksesi nga Rusia, pos që sollën një qasje anakronike të tyre kundrejt zhvillimeve rajonale e europiane, ku Maqedonia gjithësi ndodhet në orbitën e interesimeve e integriteteve euro-atlantike. Në Maqedoni mund të ketë individë me sensibilitete të caktuara pro-ruse, por kjo është e pamjaftueshme për pritshmëritë e ndonjë kthese që mund të ndodhë këtu, sidomos në favor të tezave që i japin kosës në Lindje, ku Maqedonia përpos ndonjë simptome gripi, nuk mund të merr kurrfarë modeli bë ekonomi, siguri, bashkëpunim rajonal etj. Strategët e Putinit do të kenë mundur ta lexojnë në mes rreshtave situatën poroze që mbretëron aktualisht pas përpjekjeve për tejkalimin e kontestit me Greqinë, por në asnjë mënyrë, as në të kaluarën, as në të ardhmen, nuk ka ndodhur që Rusia të ketë ndonjë qasje të sinqertë për ta ndihmuar Maqedoninë në zgjidhjen e kontestit me Greqinë.

Përpjekjet e Brukselit e Uashingtonit për të vendosur normalitet në klimën e përgjithshme politike në Ballkan, nuk kanë alternativë tjetër dhe të gjithë ata bedelë rus që mundohen të mbulojnë ndonjë boshllëk të politikave europiane në rajon, në fakt japin argument se po duan të mbulojnë diellin me shoshë.

FËMIJA, LODRAT DHE BABAI

"Fëmija do të blejë çdo lodër që sheh. Ai nuk do t'ja dijë për mundësitë e babait të tij. Babai do t'i blejë fëmijës të gjitha lodrat që fëmija do, por ai duhet të mbajë llogari për nevojat e familjes së tij. Fëmija do rritet. Ai do bëhet prind. Fëmija i tij do dojë të blejë çdo lodër që do shohë. Ai nuk do dojë t'ja dijë për mundësitë e babait të tij. Babai do dojë t'i blejë fëmijës të gjitha lodrat që fëmija do dojë, por ai do duhet të mbajë llogari për nevojat e familjes së tij. Kur fëmija të rritet dhe të bëhet prind, ai do ta dojë shumë fëmijën e tij. Atëherë ai do ta kuptojë se sa shumë e ka dashur atë babai i tij", shkruan në profilin e tij në FB, dr.Artan Dika.

KTHIM KOLEKTIV NË FILLORE

"Kosova mund të shkelë shumë ligje, por jo edhe ato të fizikës. Një trup nuk mund të lëviz në dy drejtime (madje të kundërta) njëkohësisht. Nuk mund të kërkosh të njëjtën ditë të integrohesh në Evropë (Juncker) e të përjashtohesh prej Evropës (EQAR, Agjencia e Akreditimit). Kthim kolektiv në fillore", shkruan në Facebook, publicisti nga Kosova, Veton Surroi, duke përkujtuar përjashtimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) nga Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

ASGJË NUK ËSHTË MË E ÇMUESHME SESA LIRIA

"Kujtimi për marsin e vitit 1998 mbetet monument i përjetshëm në zemrat e mbarë kombit tonë. Atë ditë në Prekaz u ndryshua historia dhe epokat. Sakrificat e Adem Jasharit dhe Familjes së tij është rast unik në historinë e njerëzimit. Mesazhi i saj u flet shekujve dhe gjithë popujve: Asgjë nuk është më e çmueshme sesa liria", shkruan në Facebook, kryetari i Parlamentit të Kosovës, Kadri Veseli.

KOMPLEKSI I SUPERIORITETIT,
BAZËN E KA NË INFERIORITET!

"Irrituese dhe e ulët kur sheh 'alamet' profesorë që vetëm veten e lavdërojnë dhe gjithçka që bëjnë të tjerët, madje e dhe miqtë e tyre, me muhabete koti e pa bazë logjike, profesionale, menaxheriale a juridike tentojnë ta 'asgjësojnë!' Njerëzit me shpirt, sjellje dhe fjalor negativ, nevojë imediate e kemi ti bëjmë 'block' edhe në jetën e përditshme, jo vetëm në Facebook! Kjo deri sa ata të reflektojnë! Dunjaja nuk ka filluar me 'shkencëtarizmin' tuaj, po as ka për të përfunduar. Merre më shtruar, 'nderuar!' Pse gjithë ky siklet patologjik permanent i pa justifikuar?! Negativiteti permanent është sjellje socio-patologjike që do kurim e duhet përmirësuar. Trajnues te ne s'keni qenë e s'do jeni meqë nuk dini të mbani raport korrekt me njerëzit, kësisoj, rrezikoheni edhe me kandidatët tonë të gaboni e turpëroheni, më mirë me statuse facebook-u të merreni dhe në shtëpi duke pi 'qaj' të qëndroni e fotografitë e prezencës së 'kolegëve' tuaj t'i shikoni! Kjo, jo vetëm për qejfin tim, mirëpo nga gjitha ato anketime deri sot të realizuara askujt mendja si shkoi emrin tuaj ta shkruaj! Opinioni publik të ngrenë dhe të nokauton. Shihni hallin tuaj 'i nderuar', duke pasur gjithë k'të siklet dëmtoni shëndetin mental, tuajin! Mëria e inati ta then qafën!", shkruan në FB, psikologu Muhamed Jonuzi.

MEDIACitate

Regjimi sirian i Bashar al-Asadit ka kryer sulm me armë kimike me përmbajtje të gazit klorin ndaj Gutës Lindore në Siri. Të paktën 30 civilë nga të cilët shumica gra dhe fëmijë janë prekur nga ky gaz. Sipas informacioneve të marra nga qendra e Mbrojtjes Civile (Helmetat e Bardha) në Gutën Lindore, regjimi dje në orët e mbrëmjes ka sulmuar qytezën Hamuriye me gaz klorin. Nga sulmi u prekën 30 civilë nga të cilët shumica gra dhe fëmijë. Dy prej tyre mësohet se janë punonjës të Mbrojtjes Civile. Regjimi i Asadit përdori armë kimike në Gutën Lindore të dielën e kaluar, pas vendimit të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (OKB) për armëpushim njëmuor ndërkohë që 16 persona u ndikuan nga gaz. Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike (OPCW) më 27 shkurt filloi hetimet lidhur me akuzat për përdorim të armëve kimike në Siri. Përdorimi i armëve kimike nga ana e regjimit të Asadit duhej të përfundonte më 19 gusht të vitit 2014, meqenëse pas vrasjes së 1.400 civilëve me armë kimike në Gutën Lindore më 21 gusht të vitit 2013, ai ishte përfshirë në procesin e asgjësimit të rezervave të marrë përsipër nga OPCW-ja. Hapjen e këtij procesi e kishte mundësuar Rusia për të penguar intervenimin e paralajmëruar nga SHBA-të. Megjithatë, pasi Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike njoftoi se ka përfunduar asgjësimi i të gjithë rezervave, regjimi i Asadit, krahas vrasjeve, vazhdoi edhe sulmet kimike për frikësimin dhe dëbimin e popullatës. Misioni i përbashkët i OKB-së dhe OPCW-së i njohur si Mekanizmi i Përbashkët Hetimor (JIM), më 27 tetor të vitit 2017 i paraqiti KS-OKB-së një raport, sipas të cilit regjimi mban përgjegjësi për masakrën me armë kimike në Han Shejhun më 4 prill të vitit 2017, në të cilën humbën jetën të paktën 100 civilë. Vendimi i JIM-it nuk është i mjaftueshëm për gjykimin e përgjegjësve të masakrës para Gjykatës Ndërkombëtare Penale (GJNP). Meqenëse Siria nuk është anëtare e GJNP-së, regjimi duhet të dërgohet në GJNP nga KS-OKB-ja, në të cilën deri më tani nuk është ndërmarrë ndonjë hap. Ndërkohë, regjimi i Asadit vazhdon të përdorë armët kimike.

(Anadolu Agency, 6 mars)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

ÇFARË NA KAMBETUR NGA VEPRAT E KAVALJOTIT?

Theodor Kavaljoti (1718-1797) ka qenë filozof iluminist shqiptar. Lindi dhe vdiq në Voskopojë, ku zhvilloi edhe veprimtarinë e tij pedagogjike e letrare. U emërua mësues më 1743 e më pas drejtor i shkollës së Voskopojës (1746), e cila më 1750 mori emrin Akademia e Re. Nga veprat e hartuara prej tij si tekste shkollë janë ruajtur dorëshkrimet greqisht "Logjika" (1743), "Fizika" (1752) dhe "Metafizika" (1767). Më 1770 botoi në Venedik librin

Protopiria që përfshin edhe një fjalor trigjuhësh: greqisht, sllavisht dhe shqip me 1770 fjalë. Mendimi filozofik i tij u formua nën ndikimin e filozofisë së V.Domodosit, M.Antrakitit dhe dualizmit të R.Dekartit. Karakteristikë themelore e botëkuptimit të tij filozofik është dualizmi. Përmbajtja e filozofisë së Theodor Kavaljotit është dhënë në veprën e tij "Fizika", në të cilën vendin kryesor e zë doktrina mbi qenien, mbi materien.

Nga burime të sigurta parlamentare u tha se pas mosdakordimit me VMRO-në, shumica kishte skenarin që fillimisht të ndryshonte pikën e parë rendit të ditës dhe të kalojë si pikë e katërt, pas pikave tjera, dhe të gjendet momenti kur deputetët e VMRO-së nuk janë të gjithë në sallë që më pas të kalohet në votim

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 6 mars - Pas një pritje të gjatë, shumica parlamentare as të martën nuk arriti të gjejë gjuhë të përbashkët me VMRO-në për Ligjin për gjuhët. Seanca e 32 me radhë kishte si pikë të parë Ligjin për gjuhët, fillimisht u shty për në orën 15, por që nuk filloi prapë deri në orët e vona të pasdites, që më vonë të shtyhet në një datë të pacaktuar. Pothuajse tërë ditën përfaqësuesit e partive parlamentare kanë pasur koordinim me kryetarin Talat Xhaferi, por pa marrë ndonjë vendim konkret për mënyrën e votimit të Ligjit për gjuhët. Nga burime të sigurta parlamentare u tha se pas mosdakordimit me VMRO-në, shumica kishte skenarin që fillimisht të ndryshonte pikën e parë rendit të ditës dhe të kalojë si pikë e katërt,

TËRË DITËN NUK FILLOI SEANCA PARLAMENTARE



EDHE NJË DËSHTIM PËR LIGJIN E GJUHËVE

pas pikave tjera, dhe të gjendet momenti kur deputetët e VMRO-së nuk janë të gjithë në sallë që më pas të kalohet në votim. Në këtë skenar duhej që në fillim - kryeparlamentari Xhaferi të arsyetojë mospërfilljen e vërejtjeve të presidentit Gjorgje Ivanov ndaj Ligjit për gjuhë, me çka nuk do të vinin në shprehje të diskutoheshin mbi 35 mijë amendamentet e VMRO-së ndaj këtij ligji. Po sipas këtyre burimeve, LSDM nuk ishte e gatshme që Ligji të kalojë në këtë mënyrë, duke u frikësuar për ndonjë eskalim të dhunës nga de-

putetët e VMRO-së. U fol po ashtu që kryeministri Zoran Zaev të vijë në Parlament dhe të bisedojnë drejtpërdrejt me opozitën për të gjetur ndonjë zgjidhje në lidhje me 35 mijë amendamentet, por deri në ora 16, ai nuk u pa të vijë në Parlament. Siç flitej, LSDM ishte më shumë për skenarin që të merrin vesh me VMRO për çështjen e amendamenteve që eventualisht të tërhiqte ajo apo të mos bëj zhurmë nëse do të akumuloheshin në një diskutim të gjitha amendamentet me çka do të mundësohej që të gjithë deputetët e VMRO-së

të diskutonin për amendamentin. Në sallë kohë pas kohe ishin prezent vetëm deputetët e BDI-së dhe nënkryetari Vesel Memedi, ndërkohë nga deputetët e LSDM-së u vërejtën në sallë vetëm në ora 12 kur duhej të fillonte seanca, por jo edhe më vonë. Nga VMRO siç vërehej pothuajse të gjithë deputetët e kësaj partie rrinin gati para sallës kur duhej të zhvillohej seanca plenare dhe kohë pas kohë edhe hynin e dilnin nga salla e madhe. Në një rast, deputeti i VMRO-së, Ilija Dimovski u tha gazetarëve se "vetëm Zoti e di kur do të fillojë

seanca". Deputeti i VMRO-së, Dimitar Stefanaxhija, tha se shumica duket qartë se nuk i ka numrat për Ligjin për gjuhët. Në pyetjen e gazetës KOHA nëse kjo do të thotë se LSDM mund të bëjë pazare me VMRO-në, ai tha shkurt se duhet pyetur deputetët e LSDM-së. Deputet e BDI-së në lidhje me mundësinë që LSDM të bëjë pazare me VMRO për Ligjin për gjuhën, i thanë gazetës KOHA se "pazari pa hanxhinë nuk do ti del mirë askujt, e as LSDM-së". Seanca, thonë deputetët të BDI-së, është shtyrë për afat të pacaktuar.

BISEDIMET PËR EMRIN, SA AFËR AQ EDHE LARG

ZAEVI NUK DO "VIJA TË KUQE"

"Është shumë me rëndësi ta praktikojmë atë që e mbarë bota e di, ndërsa kjo është praktikë e njohur ndërkombëtare të zgjidhjes së kontesteve të tilla dhe atëherë mbetet përgjithmonë. Jam i bindur se përmes qasjeve të këtilla, duke u kujdesur sa është me rëndësi për qytetarët e Greqisë dhe të Maqedonisë, mundemi edhe ta gjejmë zgjidhjen e kontestit që e kemi me Greqinë", tha Zaevi

Shkup, 6 mars - Ndryshimi për çfarëdo qoftë në sistemin juridik të Maqedonisë nuk do të thotë garanci e qëndrueshme për Greqinë, sepse gjithçka që ndryshohet - mund të kthehet mbrapa, deklaroi kryeministri Zoran Zaev, duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve për kërkesën e Athinës për ndryshim të Kushtetutës si garanci për zgjidhje eventuale të kontestit për emrin.

"Është shumë me rëndësi ta praktikojmë atë që e mbarë bota e di, ndërsa kjo është praktikë e njohur ndërkombëtare të zgjidhjes së kontesteve të tilla dhe atëherë mbetet përgjithmonë. Jam i bindur se përmes qasjeve të këtil-

la, duke u kujdesur sa është me rëndësi për qytetarët e Greqisë dhe të Maqedonisë, mundemi edhe ta gjejmë zgjidhjen e kontestit që e kemi me Greqinë", tha Zaevi. Lidhur me shkrimet e "Katimerinit" për arritjen e pajtueshmërisë në tre kapitujt, kryeministri theksoi se është e mbyllur çështja me irredentizmin, me hapat që i ka bërë Maqedonia, gjegjësisht me ndryshimin e emrave të autostradës në "Miqësia" dhe të aeroportit në Shkup. "Është biseduar edhe për të ardhmen, pas marrëveshjes së mundshme, të formohen grupe të punës të cilët do t'i kontrollojnë tekstet shkollorë nga të dyja palët që mos të mbetet

gjurmë e pakëndshme te brezat e ri që të kultivojnë miqësi në vend të armiqësisë", deklaroi kryeministri Zaev.

Në ndërkohë, ish-shefja e diplomacisë greke, Dora Bakoiani, ka thënë për radion "Real FM" se perspektivat për zgjidhje serioze të çështjes për emrin gjithnjë e më tepër po zvogëlohen. Bakoiani është shprehur se Qeveria greke ka pasur mundësi të vërtetë ta zgjidh problemin, por me mënyrën në të cilën menaxhonte me çështjen, tani çon në qorrsoak. "Dëshiroj të bëhem e qartë se mundësia mund të shfrytëzohet dhe do të kishim rezultat pozitiv, nëse kishim një qeveri serioze. Në këtë mo-

ment kemi shumicë qeveritare, të ndarë në tre pjesë", tha Bakoiani. Sipas saj, njofton korrespondenti i MIA-s nga Athina, një nga gabimet kryesore të qeverisë aktuale greke janë pozita e partnerit të koalicionit Panos Kamenos dhe vendimi që të mos krijohet strategji kombëtare me partitë tjera. Rezultat i kësaj, siç tha Bakoiani, ishin që grekët të mos kenë besim te Ciprasin të negociojë, por edhe të përzihen edhe palë të treta. "Këtë e shfrytëzuan edhe forcat tjera, lexo: turqit, kanë hyrë në mes dhe i inkurajuan shkupjanet që të mos bëjnë lëshime për çështjet themelore siç janë Kushtetuta, gjë që është parakusht, ndërsa rezul-



tati është që sot të kemi rritje të nacionalizmit edhe në Greqi edhe në IRJM dhe gjithsesi perspektivat për një zgjidhje serioze të çështjes gjithnjë e më tepër po zvogëlohen", shtoi ish shefja e diplomacisë greke, ndërsa tani deputete e Demokracisë së Re, në intervistën për radion greke.

Dugin u shpreh se nëse Maqedonia vendosë t'i bashkohet Klubit të udhëhequr nga Rusia, identiteti dhe traditat e saj do të ruhen, diçka që nuk do të mund të bëhet nëse, siç tha ai, ajo i bashkohet NATO-s dhe BE-së

Shkup, 6 mars - Rreth 400 persona kanë mbushur sallën e konferencave në Hotelin Kontinental të Shkupit ditën e shtunë, ku shumë prej të pranishmëve mbetën në këmbë. Ata ishin atje për të parë yllin mysafir të panelit, analistin, strategun dhe filozofin rus, Aleksandar Dugin, një filozof rus, i cili shpesh cilësohet të jetë "filozofi i preferuar" i kryetarit rus, Vladimir Putin. Dugin, i shoqëruar nga një analist tjetër i shquar rus, Leonid Savin ishin mysafir në panelin e organizuar nga një parti e vogël pro-ruse "Të bashkuar për Maqedoni", e cila e zgjodhi këtë emër për të nderuar dhe asocuar me partinë e Putinit, "Rusia e Bashkuar".

Ndonëse mysafirët rus nuk gjenden në listën këshilltarëve zyrtarë të Putinit, shumica e shohin Dugin si "ideologun" kryesor ose "trurin" e Kremlinit. Sidoqoftë, Dugin kundërshtoi fuqishëm vlerat liberale perëndimore dhe mbështetë një vëllazëri alternative pan-sllave, e cila përfshinë forcimin e Bashkimit Ekonomik Euroaziatik të udhëhequr nga Rusia. Ai vet tha se ishte në Maqedoni në cilësi jozyrtare si "diplomati i popullit" të Rusisë.

POROSI RUSE PËR MAQEDONINË

"IDENTITETI DHE TRADITA RUHEN ME RUSINË E JO ME NATO-në"



Në këtë debat, Dugin tha se Perëndimi po dështon së bashku me Bashkimin Evropian, duke theksuar vendimin e Britanisë së Madhe për t'u larguar nga BE dhe rritjen e "euro-skepticizmit" në Poloni, Greqi, Itali dhe Hungari. "Turqia tash më ka hedhur poshtë idenë e anëtarësimit në BE", tha ai. "Kur ata ju thonë se nuk ka alternativë veç BE dhe NATO, kjo paraqet shantazh, poshtërim dhe kolonizim", shtoi ai, duke bërë thirrje që Perëndimi t'i shoh punët e veta, në vend se të shpërndajë "ideologjinë e tij të dështuar".

Publiku e dëgjonte me vëmendje, duke brohoritur të ngazëlyer "Rusia, Rusia", dhe duke duartrokatur gjatë çdo ndërprerje të shkurtë.

"Ideologjia liberale është totalitare. Ajo dëshiron të shkatërrojë traditat. Shumë popuj refuzuan atë për të mbrojtur kulturën, gjuhën dhe fenë e tyre. Jemi të kënaqur që Rusia është bërë simbol i këtij procesi", vazhdoi Dugin. "Ju themi se ju keni një alternativë dhe se secili popull duhet të bëjë zgjedhjen e vet. Pa marrë parasysh vendimin tuaj, ju do të mbeten miq dhe vëllezërit tanë", por "ju duhet ta sillni atë vendim, të lirë". Brohoritjet ngazëlyese për Rusinë dhe Putinin vazhduan edhe gjatë fjalimit të mysafirët tjetër rus, Savin.

Ai këmbënguli se Bashkimi Ekonomik Euroaziatik ishte një forcë demokratike, ndryshe nga BE. "Krijimi i BE-së ishte i bazuar në ideologjinë e frikës. Ajo u krijua që disa

vende perëndimore të ndërpresin luftimet mes vete", tha Savin, duke shtuar se "Brukseli është sateliti i Uashingtonit". Nga ana tjetër, ai tha se me Bashkimin Ekonomik Euroaziatik "ju integrohni duke u bazuar në respektin, pa marrë parasysh nëse vendi ka 2 milionë ose 200 milionë banorë". Savin e quajti Bashkimin Euroaziatik "sintezë të sovranitetit të ndryshëm" të bazuar në vendimarrje konsensuale. "Nëse një vend anëtar nuk pranon diçka, ajo nuk do të implementohet. Kjo është demokraci e vërtetë", tha ai. Ai u shpreh se nëse Maqedonia vendosë t'i bashkohet Klubit të udhëhequr nga Rusia, identiteti dhe traditat e saj do të ruhen, diçka që nuk do të mund të bëhet nëse, siç tha ai, ajo i bashkohet NATO-s dhe BE-së.

Synimi për BE-në është arritur

Shkup, 5 mars - Plani 3-6-9 e realizoi njërin nga synimet e tij më të rëndësishme, më se e sigurt është që Komisioni Evropian do të rekomandojë fillim të bisedimeve, vërehet përparim në pjesën e përmbyshjes së aktiviteteve, është përmirësuar matura dhe parashikueshmëria, por vërehet edhe transparencë më e vogël e Qeverisë, janë një pjesë e konkludimeve të raportit të dytë të Institutit për demokraci Societas civilis - Shkup (IDSCSH) për pjesën e gjashtë të Planit 3-6-9. Pjesa e dytë e raportit të Institutit për demokraci, e quajtur "Gara e 3, 6 dhe 9 me pengesa. Drejtë rekomandimit të pastër?" është përgatitur në bashkëpunim me Fondacionin "Konrad Adenauer". "Synimi ambicioz i Qeverisë është përmbyshur, respektivisht në vigjilje të publikimit të perspektivës kredibile evropiane për zgjerim me vendet nga Ballkani Perëndimor, në disa raste funksionare të lartë të BE-së theksuan se Maqedonia do të marrë rekomandim të pastër për fillimin e bisedimeve. Zbatimi i vetë rekomandimit të KE-së nga ana e Këshillit të BE-së, megjithatë do të varet nga sjellja e Maqedonisë në periudhën e ardhshme, si në planin vendor lidhur me përmbyshjen e reformave, ashtu edhe në planin ndërkombëtar, sepse ende ka shumicë të vendeve të izoluar, si Holanda, Gjermania dhe Franca", deklaroi Zoran Neqev, udhëheqës i projektit. Në pjesën e përcjelljes shënohet përparim lidhur me përmbyshjen e aktiviteteve, respektivisht 41 për qind për pjesën 3, në pjesën 6 ka 52 për qind përmbyshje të aktiviteteve, 16 për qind janë përmbyshur pjesërisht, 19 për qind janë përmbyshur dhe 13 për qind janë të pamatura. Korniza kohore për pjesën e gjashtë është deri më 31 dhjetor të vitit 2017. Përmirësim është vërejtur edhe në raport të matjes dhe parashikueshmërisë së vetë aktiviteteve dhe fushave prioritare, ndërsa theksi është vendosur në tre shtyllat kyçe, reforma në gjyqësi, shërbimet e sigurisë dhe kundërbulimit dhe administratën publike. Në pjesën e gjashtë ka zvogëlim të transparencës së Qeverisë.

ANKETË E RE E IFIMES-it

Shumica mbështet zgjidhje të emrit dhe gjuhën shqipe

Mbi 57 për qind e qytetarët mbështesin miratimin e Ligjit për avancimin e përdorimit të gjuhës shqipe dhe gjuhën e bashkësive etnike pakicë, 28 për qind nuk japin mbështetje, ndërsa 13 për qind nuk kanë qëndrim

Shkup, 6 mars - Shumica e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë i mbështesin përpjekjet e kryeministrit Zoran Zaev dhe Qeverisë lidhur me zgjidhjen e kontestit me Greqinë për emrin. Gjashtëdhjetë e tre për qind e të anketuarve në anketën që e zbatoi Instituti ndërkombëtar për studime të Lindjes së Afërt dhe ballkanike (IFIMES) nga Lubjana shprehën mbështetje. Njëmbëdhjetë për qind



nuk japin mbështetje, përderisa 26 për qind u deklaruan se nuk kanë qëndrim. Hulumtimi i mendimit publik është kryer në periudhën prej 19 deri më 28 shkurt për 998 persona.

Shumica e qytetarëve e konsiderojnë Greqinë si vend mike. Në pyetjen nëse Republikën e Greqisë e konsiderojnë për shtet mik, 41 për qind u përgjigjën pozitivisht, 33 u përgjigjën me "jo", përderisa 26 për qind nuk kanë qëndrim. Pe-

sëdhjetë e nëntë për qind e të anketuarve e vlerësojnë pozitivisht punën e Qeverisë së Zaevit, 25 për qind dhanë vlerësim negativ, ndërsa 16 për qind u deklaruan se nuk kanë qëndrim. Punën e presidentit të shtetit, Gjorge Ivanov pozitivisht e vlerësuan 14 për qind e qytetarëve të anketuar. Shtatëdhjetë për qind e vlerësuan negativisht, ndërsa 16 për qind deklaruan se nuk kanë qëndrim.

Shumica e madhe e mbështe-

sin punën e Prokurorisë Speciale Publike, të kryesuar nga prokurorja Katica Janeva. 78 për qind e mbështesin punën e PSP-së, 14 për qind nuk e mbështesin, ndërsa 8 për qind nuk kanë qëndrim. Mbi 57 për qind e mbështesin miratimin e Ligjit për avancimin e përdorimit të gjuhës shqipe dhe gjuhën e bashkësive etnike pakicë, 28 për qind nuk japin mbështetje, ndërsa 13 për qind nuk kanë qëndrim. 66 për qind kanë pikëpamje optimiste ndaj të ardhmes, 24 për qind nuk kanë pikëpamje të tillë, ndërsa 10 për qind deklaruan se nuk kanë qëndrim. Shumica e madhe e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë (83 për qind) e mbështesin hyrjen e vendit në Bashkimin Evropian, 6 për qind nuk dhanë mbështetje, përderisa 11 për qind u deklaruan se nuk kanë qëndrim. 71 për qind e të anketuarve e mbështetën hyrjen e vendit në NATO, 8 për qind konsiderojnë se vendi nuk duhet të hyjë në Aleancë, përderisa 21 për qind nuk kanë qëndrim. (E.H)

REVITALIZIMI I ÇARSHISË SË VJETËR TË SHKUPIT

NË PRITJE TË SISTEMIT TË RI TË SIGURISË

Qëllimi kryesor i sigurimit të ri të Çarshisë, i cili pritet të vendoset së shpejti nuk do të jetë vetëm sigurimi i objekteve dhe dyqaneve, por në përgjithësi mbarëvajtja e rendit dhe qetësisë publike në këtë pjesë të vjetër të qytetit të Shkupit

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 6 mars - Vendet historike si Çarshia e Shkupit, gjithandej botës paraqesin epiqendrën e zhvillimeve kulturore dhe shoqërore. Por, fatkeqësisht një gjë e tillë nuk ndodhë në vendin tonë. Organizimi, zhvillimi, ndërtimi apo investimi në sferën e turizmit, padyshim se kërkon rritjen e sigurisë dhe mirëmbajtjen e tij. Viteve të fundit Çarshia e Vjetër e Shkupit, ka pësuar një rritje të vizitave dhe hapjeve të lokaleve të reja. Mirëpo, njohësit e mirë jetës së Çarshisë, thonë se kapaciteti i këtij kompleksi historik nuk është shfrytëzuar maksimum. Ndonëse në periudhën e fundit nuk ka ndodhur ndonjë eksces më i madhe, me dëmtimin apo vjedhjen e dyqaneve, megjithatë siguria mbetet ndër anomalitë më të mëdha që i ka kjo Çarshi.

Kryetari i shoqatës së "ESNAFIT", Bejtullah Morina, kur flet për çështjen e sigurisë, nuk nguron të thotë se Çarshia e Vjetër e Shkupit, disponon me një lloj sigurimi, por i njëjti ka një kohë të gjatë që është



jashtë funksionit, ka mungesë të kuadrit dhe në përgjithësi ai përballat me problemet në aspektin organizativ. Në interes të përmirësimit dhe kthimit sa më të madh të vizitorëve, ESNAFI i Çarshisë së Shkupit, vitin e kaluar nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me kryetarin e Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov dhe kryeministrin, Zoran Zaev.

"Pikat nga marrëveshje e arritur me institucionet përkatëse, jemi duke u munduar t'i realizojmë në praktikë. Besoj se së shpejti do të fillojë realizimi i projekteve në Çarshi, përfshi edhe çështjen e një sigurimi më të mirëfilltë. Por, para se sigurimi i ri të marrë përsipër kujdesin mbi Çarshinë, duhet paraprakisht ta zgjidhim problemin me lypsarët, shitësit e egër dhe taksistët, të cilët qëndrojnë në të dy hyrjet e Çarshisë" thekson për KOH-

ën, Morina.

Marrëveshja e arritur mes ESNAFIT dhe Qytetit të Shkupit, lidhur me çështjen e sigurimit të ri të Çarshisë, parashihet që në gjashtë muajt e parë, sigurimi të paguhet nga ana e administratës së Qytetit dhe më pas mbulimin e harxhimeve të sigurimit ta marrin vetë dyqanxhinjtë e Çarshisë.

Qëllimi kryesor i sigurimit të ri të Çarshisë, i cili pritet të vendoset së shpejti, siç njoftoi kryetari i ESNA-

FIT, Bejtullah Morina, nuk do të përqendrohet vetëm në sigurimin e objekteve dhe dyqaneve, por në përgjithësi në mbarëvajtjen e rendit dhe qetësisë publike në këtë pjesë të vjetër të qytetit të Shkupit. Gjatë kësaj kohe detyrë shtesë e sigurimit të Çarshisë, sipas ESNAFIT, do të jetë edhe parandalimi i veturave dhe motoçikletave. Me vendosjen e sistemit të ri të sigurisë, paralelisht pritet të bëhet edhe riparimi i shtyllave elektrike, të cilët vite me parë u

vendosen nga autoritet e Komunës së Çairit, me qëllim parandalimin e qarkullimit të automjeteve. Megjithatë, siç dihet me prishjen e tyre, Çarshia gjatë periudhës së verës i ngjanë një piste garash.

"Kërkesa e jonë fillestare është që vetë shtetit t'i largon shitësit e egër dhe lypsarët. Më pas kemi paraparë rregulla të posaçme për dyqanxhinjtë dhe mundësia e tyre për shfrytëzimin e hapësirës publike, për të cilën do të paguajnë një shumë simbolike. Me përmubshjen e këtyre kushteve, detyrë e sigurimi do të jetë mirëmbajtja e rendit dhe qetësisë brenda çarshisë. Qëndrimi i organeve të rendit është se për shkak të mungesës së kuadrove të mjaftueshëm, ato nuk kanë mundësi 24 orë të qarkullojnë brenda Çarshisë", theksoi, Morina. Problemin shumë vjeçar me shitësit e egër të cilët gravitojnë në Çarshi, ESNAFI e ka paraparë t'a zgjedh me sistemin e kësaj kategori të shitësve, brenda tregut të Bit Pazarit. Marrëveshja e arritur mes organeve përkatëse dhe kryesisë ESNAFI, është që për tre muaj me radhë shitësit e egër, pa pagesë t'i shfrytëzojnë tezat e tregut të Bit Pazar.

SHITËSIT E EGËR TË FUTËN NE BIT PAZAR

"Kërkesa e jonë fillestare është që vetë shtetit t'i largon shitësit e egër dhe lypsarët. Më pas kemi paraparë rregulla të posaçme për dyqanxhinjtë dhe mundësia e tyre për shfrytëzimin e hapësirës publike, për të cilën do të paguajnë një shumë simbolike. Me përmubshjen e këtyre kushteve, detyrë e sigurimi do të jetë mirëmbajtja e rendit dhe qetësisë brenda çarshisë. Qëndrimi i organeve

të rendit është se për shkak të mungesës së kuadrove të mjaftueshëm, ato nuk kanë mundësi 24 orë të qarkullojnë brenda Çarshisë. Problemin shumë vjeçar me shitësit e egër të cilët gravitojnë në Çarshi, ESNAFI e ka paraparë t'a zgjedh me sistemin e kësaj kategori të shitësve, brenda tregut të Bit Pazarit", theksoi kryetari i ESNAFIT, Bejtullah Morina.

Kërkohen autorët që e rrahën Sinadinovskin

Të martën, vizitë Sinadinovskit i ka bërë edhe ambasadori i Kosovës në Shkup, Ylber Hysa, i cili pasi ka dënuar sulmin ndaj prof. Sinadinovski, i ka dëshiruar shëndet të shpejtë



Shkup, 6 mars - Rreth mesditës së djeshme është sulmuar fizikisht Branko Sinadinovski themeluesi i Bashkësisë Fetare të Shqiptarëve Ortodoksë në Maqedoni. Siç raportuan mediat, Sinadinovski është sulmuar fizikisht në afërsi të banesës së tij, në lagjen Aerodrom të Shkupit. Rasti është paraqitur në polici, e cila është duke e hetuar incidentin. "Kam qenë duke shkuar tek vajza në banesën e saj rreth orës 10 të mëngjesit. Kam hasur se diku sh me ndiqte, por nuk i vura re shumë. Vazhdova rrugën. Dhe në

një moment dy persona mu vërsulën dhe më sulmuan brutalisht. Akti ka qenë barbarë dhe se të gjitha goditjet i mora në kokë. Kam përjetuar tmerr të vërtetë sepse ata kishin si qëllim eliminimin tim fizik", ka rrëfyer Sinadinovski për agjencinë "INA" duke shtuar se ai është shpëtuar nga dhëndri i tij pasi ka dëgjuar zhurmë dhe i ka ardhur në ndihmë. Sinadinovski shprehet se lidhur me përmubshjen e, siç e quan ai, misionit të tij kombëtar, kërkohen sakrifica dhe përkushtim.

"Unë kam qenë i vetëdijshëm për këto pasoja, por nuk ndalemi në qëllimin tonë. Bashkësia fetare e shqiptarëve ortodoksë në Maqedoni është një realitet dhe shprehje e lirisë fetare dhe kombëtare", thotë Sinadinovski, duke theksuar se me këto veprime po rrezikohet liria themelore e shprehjes së identitetit kombëtar dhe fetar.

Të martën, vizitë Sinadinovskit i ka bërë edhe ambasadori i Kosovës në Shkup, Ylber Hysa, i cili pasi ka dënuar sulmin ndaj

prof. Sinadinovski, i ka dëshiruar shëndet të shpejtë. Njëherësh, Hysa me Sinadinovskin ka biseduar edhe për planet me Kishën Ortodokse Shqiptare në Maqedoni. Lidhur me sulmin fizik të Sinadinovskit ka reaguar edhe kryetari i Akademisë Shqiptaro-Amerikane, prof. dr. Skender Kodra, i cili ka bërë thirrje që të zbardhet akti brutal i rrahjes së anëtarit të tyre të Akademisë dhe iniciuesit të themelimit të Bashkësisë Fetare të Shqiptarëve Ortodoksë në Maqedoni, Branislav Sinadinovskit. Në ndërkohë, në MPB thonë se po hetohen autorët, me qëllim që të njëjtit të vihen para drejtësisë. Sinadinovski është edhe profesor universitar, ndërsa për opinionin u bë i njohur vite më parë pas deklaratës se është shqiptar etnik dhe angazhohet për krijimin e një Bashkësisë Fetare të Shqiptarëve Ortodoksë në Maqedoni. Sinadinovski është me prejardhje nga Beliçica e Rekës së Epërme nga rajoni i Mavrovës në Maqedoni.

Vdes këmbësori, shoferi ka ikur

Një mashkull 33-vjeçar e ka humbur jetën, pasi është goditur nga një automobil në rrugën rajonale Veles-Gradsko, ndërsa shoferi ka ikur nga vendi i aksidentit, njofton MPB. Aksidenti ka ndodhur dje rreth orës 18 kur një person i panjohur duke drejtuar automjetin e udhëtarëve markë e panjohur ka goditur këmbësorin D.V. (33) nga fshati Axhimatovo. D.V. me automjet të Ndihmës urgjente mjekësore është dërguar në Spitalin e përgjithshëm Veles, ku ka ndërruar jetë. Me urdhër të prokurorit publik, trupit i viktimës është dhënë në autopsi.

VAZHDON LËNDA GJYQËSORE "RYSHFETI"



ZAEVI NDJEHET I PAFAJSHËM, VIDEO PRANOHET SI DËSHMI

Zaev tha se edhe përmes video-xhiritimit që nuk është shfaqur plotësisht në publik, do të dëshmohet se ai absolutisht nuk ka pasur asnjë qëllim të marrë ryshfet, ndërsa e luti Gjykatën që të mundësojë qasje të opinionit në të gjitha dëshmitë të cilat do të dorëzohen në seanca gjyqësore

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 6 mars - Kryeministri Zoran Zaev në seancën e djeshme gjyqësore "Ryshfeti" tha se nuk ndihet fajtor dhe se është i bindur se në procedurën gjyqësore do të zbardhet akuzat kundër tij e konstruktuar në periudhën kur ishte lider i opozitës. "Së bashku me Prokurorinë konstruktuan aktakuzë me qëllime të këqija të pengohem për kryerjen e veprimtarisë politike. Do të vërtetohet se aktakuzat për mitmarrje është e pakuptimtë", tha Zaev para Gjykatës.

Sipas tij, bëhet fjalë për një aksion të paramenduar përmes agjentit të fshehtë dhe MPB që të arrihet qëllimi, e kjo është se si lider i atëhershëm i opozitës të

ndaloj me projektin E vërteta për Maqedoninë gjegjësisht të ashtuquajturat bomba. Ai pret se me shqyrtimin e dëshmitë të vërtetohet se bëhet fjalë për grumbullim të donacioneve për Katedralen në Strumicë dhe për apelin të tij drejtuar biznesmenëve që të donojnë për ndërtim të asaj Katedrale, gjë e cila është pranuar prej tyre.

Zaev tha se edhe përmes video-xhiritimit që nuk është shfaqur plotësisht në publik, do të dëshmohet se ai absolutisht nuk ka pasur asnjë qëllim të marrë ryshfet. E luti Gjykatën që të mundësojë qasje të opinionit në të gjitha dëshmitë të cilat do të dorëzohen në seanca gjyqësore. Kërkoj edhe sa më shpejt që është e mundur të caktohen seancat gjyqësore.

Më herët, edhe avokatët e tij theksuan se ai nuk ishte fajtor dhe se derisa ka qenë kryetar Komune i Strumicës, nuk ka kryer asnjë veprim joligjor në bazë të ligjeve të atëhershme për blerje të tokës ndërtimore. Për këtë shkak, mbrojtja vlerëson se nuk ka pasur arsye që të marrë ryshfet. Dëshmitari nuk i ka dhënë asnjë euro Zaevit dhe familjes së tij, e as më pak ka dhanë para për ndërtim të kishës.

I akuzuari Zaev dhe familja e tij, kanë dhënë 50 mijë euro për ndërtim të kishës. Dëshmitari, sipas mbrojtjes ishte i njoftuar për këtë dhe ka dashur të shkaktojë një imazh të rrejshëm se Zaev kërkon dhuratë për vete si kusht që të përfundojnë procedurat për blerje të tokës. Dëshmitari ishte i

vetëdijshëm se bëhet fjalë për donacion të kishës, dhe jo për mitmarrje. Prokurori, përsëri e ngriti akuzën dhe tha se do të vërtetohet fajin e Zaevit. Gjykatësi Darko Todorovski vendosi që videot e vendosura në Jutjub të pranohen si dëshmi. Zoran Zaev në rastin "Ryshfeti" është i akuzuar se gjatë kohës kur ishte kryetar i Strumicës ka kërkuar para prej rreth 160 mijë eurosh nga biznesmeni Ivan Nikolov Sançavaliëv për legalizimin e një toke ndërtimore.

Nikolov dje nuk ishte i pranishëm në seancë, dhe siç u tha në seancë, nuk ka pasur dëshmi për shpërndarje të rregullt të ftesës për në gjyq. Gjykimi duhet të vazhdojë më 19 dhe më 26 mars me shqyrtim të dëshmitë dhe shqyrtimin e CD-ve.

MIJALLKOVIT NUK I JEPET PASAPORTA

Shkup, 6 mars - Gjykata Penale e Shkupit vazhdon ta mbajë të konfiskuar pasaportën e ish-shefit të policisë sekrete, Sasho Mijallkov. Tentimi i radhës për të marrë pasaportën nuk i ka rezultuar me sukses Mijallkovit, i cili nga Prokuroria Speciale Publike ngarkohet si i akuzuar në shumë lëndë. Kërkesën e fundit për marrjen e pasaportës, ish-shefi i Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, Sasho Mijallkov, e ka arsyetuar me nevojën e përbushjes së nevojave private, jashtë shtetit. Megjithatë, nga GJPSH-ja kategorikisht kanë re-



fuzuar. Dokumenti i udhëtimit Mijallkovit iu konfiskuar tetë muaj më parë, si i dyshuar krye-

sor në rastin "Target". Kjo masë e kujdesit e shqiptuar nga GJPSH e asaj kohe, ishte si zëvendësimin

për kërkesën e PSP-së, e cila përkundër insistimit që Mijallkovit t'i shqiptohet masa e paraburgimit, Gjykata nuk e pranoi. Dispozitat ligjore me këtë rast e obligojnë Mijallkovin, njëherë në javë të paraqitet në Gjykatë. Ndryshe, ai nga ana e PSP-së ngarkohet me akuzat në gjithsej katër raste, duke filluar nga "Titanikz" për keqpërdorime zgjedhore, "Tortura" për arrestimin e Lube Boshkovskit, "Arka" për furnizim të jashtëligjshëm të pajisjeve për përgjime, si dhe "Target", për përgjimet e jashtëligjshme. (O.Xh)

25 mijë dollarë shpërblim kush e gjen aktoren nga Shkupi

Tiranë, 6 mars - Autoritetet amerikane ofrojnë shpërblim prej 25 mijë dollarësh për ndonjë informatë të rëndësishme e cila do të ndihmojë në gjetjen e studentes në degën e aktrimit nga Shkupi, Adea Shabani. Sipas sektorit të policisë në Los Anxhelos 25-vjeçarja Adea është zhdukur më 23 shkurt, në orën 11 nën rrethana të dyshimta. "Për herë të fundit është parë në afërsi të bllokut 1700 në Wilcox Avenue, disa blloqe larg teatrit të njohur kinez në qendrën e Hollivodit, jo shumë larg vendit ku ka jetuar. Dera e saj ishte e pa mbyllur pasi ajo priste të rikthehej shpejtë, thonë miqtë e saj, ndërsa nëna e 25-vjeçares menjëherë ka udhëtuar në Kaliforni për të ndihmuar kërkimet, raportojnë mediat shqiptare. Ata që e njohin Adea Shabanin në fillim kanë menduar se është e zënë me punë, por dyshimi është rritur pasi ajo nuk ka qenë e pranishme në një orë të rëndësishme në Akademinë për aktrim të Stela Adler. Atëherë ata kanë raportuar në policinë e Los Anxhelos. Ata vazhdimisht apelojnë që çdokush që ndoshta e ka parë të paraqitet në polici. Adea Shabani nga Maqedonia prej dy vjetësh jetonte në Los Anxhelos ku po synonte një karrierë si aktore.



Edhe Tanturovski dha dorëheqje

Shkup, 6 mars - Kryetari i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, Igor Tanturovski dha dorëheqje. Ai të martën në mëngjes e dorëzoi dorëheqjen në Parlament. Dorëheqje dje dha edhe anëtari i Komisionit dhe ish-kryetar i tij, Goran Milenkov, i cili ishte i pari që u tërhoq nga funksioni, pasi që para disa ditëve u publikua raporti skandaloz nga revizioni i brendshëm i bërë në Komision. Në raport janë cekur dyshimet për pagesë të urdhëresave fiktive për rrugë dhe shpenzim të parave buxhetore. Në raportin e revizorëve për Antikorrupsionin, hetim hapi Prokuroria publike, ndërsa shumica parlamentare u bëri thirrje anëtarëve të japin dorëheqje ose do të inicohet shkarkimi i tyre në Parlament. Tanturovski këto ditë mohoi se ka paligjshmëri në punën e Komisionit dhe tha se nuk do të japë dorëheqje.

Koha, e mërkurë 7 mars, 2018



ASHAM REFUZON TRE KANDIDATURA SHQIPTARE

VETËM CEKA DHE KALESHI ARRIJNË NË KUVEND

Dy kandidaturat, ajo e Zamir Dikës për në Departamentin e Shkencave Teknike, dhe Mirushe Hoxha për në Departamentin e Shkencave Shoqërore dhe atë të Linguistikës, nuk kanë arritur të marrin mbështetjen e nevojshme në votimin e parë që bëhet nëpër departamentet respektive, duke u eliminuar kështu nga konkurrimi

Koha

Evis HALILI

Shkup, 6 mars - Tre kandidaturat shqiptare janë eliminuar nga gara për anëtarë me korrespondencë në Akademinë e Shkencave dhe Arteve (AMSHA). Dy kandidaturat e propozuara nga brenda akademisë, Zamir Dika (rektor i UEJL) për në Departamentin e Shkencave Teknike,

Mirushe Hoxha (profesoreshë në Fakultetin Filologjik të Shkupit) për në Departamentin e Shkencave Shoqërore dhe atë të Linguistikës, nuk kanë arritur të marrin mbështetjen e nevojshme në votimin e parë që bëhet nëpër departamentet respektive, duke u eliminuar kështu nga konkurrimi. Të njëjtin fat ka pasur edhe kandidatura e Lutfi Zulfearit (Fakulteti i Mjekësisë, UT) që është propozuar nga Universiteti i Tetovës në Departamentin e Shkencave të Mjekësisë. Vetëm dy kandidatë të tjerë, Neritan Ceka (arkeolog) i propozuar si anëtar i jashtëm dhe piktori me origjinë nga Kërçova që jeton në Paris, Omer Kaleshi, si Anëtar Nderi, kanë marrë mbështetjen për të kaluar në fazën finale, në votimin e Kuvendit. Konkursi për pranimit të rinj me korrespondencë u hap në muajin nëntor të vitit të kaluar, por numri i kandidatave të propozuara nga pjesa shqiptare ishte i vogël. Dika dhe Hoxha, të propozuar nga brenda Akademisë, refuzohen për herë të dytë, edhe pse kandidaturat e tyre janë përzgjedhur me kujdes dhe përfaqësojnë individë që kanë dhënë kontribut në fushat në të ci-

lat kanë vepruar dhe meritojnë të jenë pjesë e këtij institucioni. Kështu pati deklaruar akademiku Alajdin Abazi, gjatë prezantimit të tyre.

"Vetëm Kaleshi dhe Ceka arritën të depërtojnë dhe të marrin votat dhe shpresoj që të paktën të votohen edhe në Kuvend", thotë Abazi. Akademik Abazi ishte skeptik sa i takon fazën e votimit nëpër departamente, ku nuk mund të mos mungonin surprizat dhe këto kandidatë të hasnin në rezistencën e anëtarëve.

Kur tre vjet më parë, AMSHA ndryshoi kriteret e pranimit dhe të aplikimit për anëtarë me korrespondencë - mundësitë për të rritur numrin e akademikëve shqiptarë u dukën reale. Në fakt, vetëm një anëtar arriti të merrte mbështetjen, Izet Zeqiri, si anëtar me korrespondencë dhe të drejtë për tu bërë anëtar i rregullt brenda pesë vitesh. Lidhur me rezultatet e fundit, Zeqiri thotë se është koha që barrierat për njerëzit e shkencës të eliminohen dhe mbështetja dhe promovimi i tyre të nisë që nga vetë institucionet ku kontribuojnë.

"Gara në AMSHA bëhet në kuadër të njëjësive dhe ky ishte re-

zultati, por jam i bindur se shumë shqiptarë e meritojnë të jenë pjesë e këtij institucioni. Problemi qëndron në motivimin, promovimin e këtyre individëve dhe mbështetjen që ata duhet ta marrin nga Këshillat mësimorë. Si USHT, UEJL dhe UNT duhet të nxisin dhe të motivojnë kuadrot ambiciozë, duhet të eliminohen të gjitha barrierat që pengojnë njerëzimit e suksesshëm. Nga ana tjetër, ndoshta duhet të ndryshohet edhe Rregullorja e pranimit, pasi në Akademi duhet të hyjnë njerëzit që i duhen dhe jo ata që duan", thotë Zeqiri. Nëse kandidatura e Neritan Cekës do ta votohet nga Kuvendi, ai do të jetë anëtar i tretë i jashtëm (Ali Aliu nga viti 2006 - Departamenti i Arteve dhe Rexhep Mejdani - Departamenti i Shkencave Teknike nga viti 2015).

AMSHA numëron gjashtë anëtarë shqiptarë, prej të cilëve tre anëtarë të rregullt - Luan Starova (Departamenti i Arteve - nga viti 2003), Alajdin Abazi (Departamenti i Shkencave Teknike - nga viti 2006) dhe Abdylmenaf Bexheti (Departamenti i Shkencave Shoqërore - nga viti 2009).

Në një vit 200 raste të të sëmurëve nga veshkat

Shkup, 6 mars - Vazhdimisht rritet numri i të sëmurëve të rinj nga veshkat numri i të cilëve në nivel vjetor arrin 200. Në fazën terminale 1600 pacientë kurohen me dializë, ndërsa vdekshmëria te dializa, si dhe në suaza botërore, lëvizë prej dhjetë deri në 11 për qind. Këtë të martën e theksoi doktoresha Olivera Stojčevska nga Klinika Universitare për Nefrologji, e cila tha se vazhdimisht rritet numri i të sëmurëve të cilët

kurohen me këtë terapi. "Meshkujt janë në numër më të madh, ndërsa kjo është vetëm për fazën terminale kur ka nevojë nga kurimi me dializë.

Në fazat paraprake të sëmundjes nga veshkat pak më shumë janë të përfshira femrat tek të cilat më ngadalë përparon sëmundja me veshkat. Për vdekshmërinë e cila është më e madhe te meshkujt, kontribuon jo vetëm sëmundja kronike e veshkave dhe

komplikimet, ndërsa më shpesh ato janë sëmundjet e zemrës", tha Stojčeva në shënimin e Ditës Botërore të Veshkës. Me këtë rast, mbahet konferencë profesionale të titulluar "veshkat dhe shëndeti i grave".

Sipas Stojčevës, rritja e numrit të të sëmurëve nga veshkat ka të bëjë me faktin që popullata po plaket, rritet jetëgjatësia mesatare. Kryetari i Shoqatës të të Sëmurëve nga Veshkat Nefron, Du-

shko Georgiev tha se në periudhën e kaluar është bërë hap i rëndësishëm në pjesën e trajtimit me dializë, janë përmirësuar kushtet për dializë, aparatura dhe materialet të cilat përdoren. Në shënimin e Ditës Botërore të Veshkës nga "Diamed" informuan se në nëntë qendrat e tyre për dializë për çdo ditë kurohen 650 pacientë, ndërsa janë furnizuar 189 aparate të reja për dializë dhe gjashtë osmoza të reja rezervë.



Janaçkova me deklaratë në Prokurori

Shkup, 6 mars - Policia Jasmina Janaçkova, e cila pati incident me funksionarin e BDI-së, Beqir Asani, të martën dha deklaratë në Prokurorinë Publike. Pas bisedës në Prokurori, Janaçkova nuk dha deklaratë për mediat. Ajo pati incident me Asanin para Qendrës Tregtare "Mavrovaska" pasi thirri "karrotrec" për automjetin e tij për shkak të parkimit në mënyrë të parregullt. Fillimisht u përfol se midis polices dhe Asanit ka konflikt verbal dhe fizik, por në takim me ministrin e Punëve të Brendshme Oliver Spasovski, ajo deklaroi se ka pasur vetëm debat verbal me funksionarin e BDI-së dhe se vetë është përplasur në automjetin special të karrotrecit.

Shpëtojnë taksistët, licenca edhe pa njohjen e anglishtes

Shkup, 6 mars - Taksi transportuesit nuk do të kenë obligim për njohje të obligueshme të gjuhës angleze gjatë marrjes së licencës për punë. Ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski, pret që ndryshimet e propozuara në Ligjin për transport në trafikun rrugor, me të cilat pezullohet detyrimi për taksistët për njohjen e gjuhës angleze, pas kalimit të procedurës parlamentare në lexim të parë, së shpejti do të votohen nga deputetët. Ndryshimet, potencoi ministri dikateterial, po bëhen me kërkesë së taksi transportuesve. Sipas tij, me ndryshimet aspak nuk do të sillen në pikëpyetje sigurimi në trafik dhe cilësia për kryerjen e taksi transportit. Parlamenti me propozim të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve i miratoi ndryshimet në Ligjin për transportin rrugor, në lexim të parë. Dispozitat ligjore me të cilat taksistët obligoheshin për njohje të obligueshme të gjuhës angleze si kusht për marrjen e licencës u votuan në vitin 2013, ndërsa hyri në fuqi nga fillimi i vitit të kaluar.

Në Itali apo Greqi edhe pse me 70 për qind dominojnë fermat e vogla në bujqësi, megjithatë ato janë tregim sukcesi me eksport të madh të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 6 mars - Bujqësia në Maqedoni, në vend se të jetë një dege ekonomike me potencial të madh punësimi dhe rritjeje ekonomike, në pjesën më të madhe është shndërruar në veprimtari ekonomike që zgjedh problemet sociale dhe ekzistenciale të një pjesë të konsiderueshme të popullatës. Janë disa faktorë që e pamundësojnë ngritjen e ekonomisë bujqësore në burim kryesor të zhvillimit ekonomik. Parasegjithash, pjesa më e madhe e ekonomive bujqësore në Maqedoni disponojnë me parcela të vogla dhe të shpërndara, që pamundësojnë rritjen e prodhimitarisë dhe konkurrencës së bujqësisë, si rrjedhojë e madhësisë mesatare të ekonomive bujqësore prej 2.5 deri 2.8 hektar. Sipas të dhënave zyrtare, pjesa dërmuese e ekonomive bujqësore, apo 58 për qind e tyre, për një hektar të tokës punuese fitojnë deri në 2000 euro për 12 muaj. Me fjalë të tjera shpesh ekonomitë e vogla bujqësore prodhojnë vetëm për konsumin e tyre vetanak dhe më pak janë të orientuara të shesin prodhimet e tyre në treg.

Ekspertët bujqësor thonë se ekzistojnë shembuj të suksesshëm evropian në prodhimin bujqësor në vend të mbijetesës nga, përkundër dominimit të ekonomive të vogla bujqësore në këto shtete. Në Itali apo Greqi, edhe pse me 70 për qind dominojnë fermat e vogla në bujqësi, megjithatë ato

RESURSE TË PASHFRYTËZUARA ZHVILLIMORE

EKONOMITË BUJQËSORE, ENDE NË MARGJINA



janë tregim sukcesi me eksport të madh të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Me fjalë të tjera në Evropë edhe fermave të vogla ua shohin "hajrin" si shteti ashtu edhe fermerët. Gjithashtu, analizat tregojnë se përveç këtyre dy shteteve, në Rumani ato marrin pjesë me 99 për qind në totalin bujqësor, ndërsa në Hungari, Sllovakia apo Lituanin marrin pjesë me më shumë se 90 për qind të totalit bujqësor.

Sipas profesorit universitar, Boris Anakiev, edhe fermerët e vegjël në Maqedoni kërkojnë një vëmendje më të madhe nga shteti, për shkak se nuk mund të anashkalohej rëndësia ekonomike dhe sociale e ekonomive të vogla bujqësore për zhvillimin e bujqësisë, rajoneve rurale, por edhe shtetit në përgjithësi. Ai shton më tej se ekonomitë e vogla bujqësore aktualisht kanë një rëndësi të madhe për zhvillimin e komunave, punësimin alternativ në ekonomitë lokale, si dhe shpërndarjen e bujqësisë në veprimtari jobujqësore si përpunimi, agrobiznesi dhe agroturizmi. Ato kontribuojnë edhe për rritjen indirekte të ekonomisë si dhe kanë një rol të madh social për shkak se veprojnë si rrjet mbrojtës social që siguron ekzistencën e shumë njerëzve, por edhe plotëson të ardhurat në viset

rurale që shquhen me papunësi të lartë dhe të ardhura më të vogla.

"Politika e shtetit ndaj ekonomive të vogla bujqësore duhet të jetë qartë e definuar dhe ato nuk duhet shikuar si pengesë për rritjen e aftësisë konkurruese të bujqësisë, por, përkundrazi, theksi duhet të vendoset në kontributin e tyre ndaj krijimit të pasurisë kombëtare. Duhet të stimulohet bashkimi i prodhuesve dhe lidhja më e madhe e tyre me fabrikat përpunuese, ndërsa edhe komunat nevojiten të përfordohen me qëllim që të sigurojnë tregje lokale dhe t'u lehtësojnë shitjen direkte, përmes përmirësimit të infrastrukturës lokale", thekson Anakiev.

Sipas tij, edhe bashkimi i tokës deri tek madhësitë optimale përmes rrugës natyrore të shitblerjes së tokës bujqësore në kushtet tona mund të zgjasë edhe më shumë se 50 vite, andaj qasja ndaj bashkimit të punës dhe prodhimit të fermerëve, përmes formave të ndryshme në shoqata dhe kooperativa, është rruga më e mirë që të zvogëlojnë harxhimet e larta për prodhimtari bujqësore dhe blegtorale, dhe të kenë plasman më të lehtë në treg. Anakiev më tej thekson se në të ardhmen duhet të mbështeten anët e fuqishme të ekonomive të vogla bujqësore si

motivi i madh për të zhvilluar fermën, shumëllojshmëria e prodhimeve, prodhimi cilësor në aspektin e konsumatorëve, individualizmi në sipërmarrje, mundësitë që ofron përkrahja financiare e shtetit, tendenca e shtrenjtimit të ushqimit, promovimi i brendeve lokale të ushqimit, rritja e kërkesës për ushqim organik, kërkesa për prodhime cilësore bujqësore etj. Gjithashtu në të ardhmen për ekonomitë e vogla bujqësore duhet të zgjidhen edhe problemet me ndikimin e ulët ndaj çmimeve të ulëta grumbulluese, çmimet e larta prodhuese, sasitë e vogla të prodhimit cilësor, mungesa e vullnetit për bashkim të punës, mungesa e përvojës në konkurrimin për fondet e ndryshme, mungesa e kapitalit qarkullues, investimeve të vogla etj.

Ndryshe, analizat tregojnë se investimet në bujqësi nuk kthehen aq shpejt, dhe se nevojitet një kohë më e gjatë për qarkullimin e kapitalit. Problem shtesë janë edhe ikja e të rinjve nga fshatrat dhe humbja e interesimit të tyre për bujqësi, disponimi me mekanizëm të vjetër bujqësor, mungesa e kredive të volitshme për fermerët, betonizimi i një pjese të madhe të tokës bujqësore, vaditja jo e kënaqshme e tokave bujqësore etj.

Ambasadori i Norvegjisë viziton Zonën e Tetovës

Tetovë, 6 mars - Ambasadori norvegjez në Maqedoni, Arne Sannes Bjornstand, ka qëndruar për vizitë në Zonën Industriale në Tetovë, ku për së afërmi nga drejtuesit e kompanisë "Lear" është njoftuar për të arriturat, zhvillimet të cilat kanë ndodhur dhe që priret të ndodhin në këtë kompani, si dhe me procesin e prodhimit të kësaj kompanie. Ambasadori i Norvegjisë me këtë rast tha se shqyrtohet mundësia e zgjerimit të Zonës ekonomike. "Kjo është një nga investimet më të rëndësishme në Maqedoni. E rëndësishme për ne është se është e suksesshme. Ka ende potencial për rritje, e dimë se ka fabrika përmes së cilëve do të mund rritet numri i të punësuarve. Biseduam se si mund të përmirësohet situata. Kemi një bashkëpunim të mirë edhe me qeverinë edhe me pushtetin lokal. Jemi duke biseduar për mundësinë e zgjerimit të zonës", tha ambasadori i Norvegjisë. Arben Halili, drejtor i Zonës ekonomike tha se si sukses më të madh është punësimin e 1450 njerëzve në Lear Korporejshën. "Ndamë përvojat se si kemi arritur që të përballemi me sfidat e deritanishme, me mundësinë që të zhvillohet kjo Zonë ekonomike. Si sukses më të madh kemi punësimin e 1450 njerëzve në Lear Korporejshën. Theksuam nevojën e zgjerimit të Zonës ekonomike, plotësimin e kushteve dhe tërheqjen e më shumë kompanive jo vetëm në hapjen e vendeve të punës, por edhe zhvillimin e bashkëpunimit me kompanitë në këtë rajon", tha Halili. (U.H)

Nga java e ardhshme nisin me punë 1600 administratorë

Shkup, 6 mars - Nga java e ardhshme, 1600 të punësuar sipas Marrëveshjes të Ohrit, e të cilët rrinin në shtëpi, do të sistemohen në vende të punës. Me këtë fillojnë reformat në administratën publike. Një mijë e gjashtëqind administratorë publik do të fitojnë vende të punës që janë përkatëse me arsimin e tyre, aftësitë e punës dhe diturinë. Kështu ka thënë ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Damjan Mançevski, sipas të cilit, ky është pilot edhe si do të rrjedhë puna, sipas analizave funksionale, do të shohim se si do të funksionojë. "Kemi

bërë analizë të këtyre njerëzve, e dimë se cilët janë saktësisht, cilët janë përgatitjet e tyre profesionale, përvoja. Ndërsa i dimë edhe nevojat e institucioneve dhe tani vetëm e bashkojmë nevojën dhe atë që është tepriçë e të punësuarve të cilët nuk kanë detyra pune", deklaroi Mançevski. Ai shprehet se deri në fund të muajit do të jetë i njohur numri i përgjithshëm i të punësuarve në administratën publike. Kudo ku do të vërtohet tepriçë e të punësuarve, do t'u ofrohet të zgjedhin nëse duan të largohen në sektorin privat ose nëse vendosin të mbeten në administratë.

Mielli serb, Laiq sot vjen në Shkup

Shkup, 6 mars - Ministri i Tregtisë së Serbisë, Rasim Laiq, sot vjen në Shkup në bisedime me Ministrin e Bujqësisë së Maqedonisë, Lupço Nikollovski për zgjidhjen e problemit me importin e miellit të Serbisë në Maqedoni. Këtë për MIA-n e konfirmuan nga kabineti i Laiqit, i cili të martën herët paralajmëroi se Serbia nga e mërkura do të vendosë kundërmasa ndaj Maqedonisë për shkak të importit të vështirësuar të miellit. Nga kabineti i tij, gjithashtu, kumtuan se nëse nesër nuk arrihet zgjidhje rreth këtij problemi, Serbia do të vendosë kundërmasa për Maqedoninë, të cilat siç thonë, tashmë janë përgatitur. Ministri i Bujqësisë së Maqedonisë, Lupço Nikollovski, dje deklaroi se "nuk është në dijeni për paralajmërimet për kundërmasa nga

Serbia", por se janë në kontakt të vazhdueshëm dhe se bisedimet për gjetjen e zgjidhjes vazhdojnë. Opsion i pranueshëm për Maqedoninë, theksoi Nikollovski, është që pullat kontrolluese për import të një, dy dhe pesë kilogramëve miell të ngjiten në Serbi, ndërsa për paketimet prej 25 dhe 50 kilogramëve në Maqedoni në pajtim me Rregulloren e re. "Gjendja e krijuar me importin e miellit nuk do të shkaktojë mungesë të miellit në treg dhe rritje të çmimit të miellit", pohon Nikollovski, duke përsëritur se qëllimi është që të respektohet Rregullorja e cila më herët ka ekzistuar dhe se me atë do të zvogëlohet çmimi i pullave kontrolluese dhe shkurtohen procedurat administrative. Siç thotë, aktivitetet e

ndërmarrja janë në bazë të argumenteve të cilat kanë treguar se ka dallim prej 25.000 tonëve në miellin e importuar dhe pullat e dhëna të kontrollit. "Një janë numrat zyrtarë për import të cilat i jep Drejtoria Doganore, ndërsa të tjera janë ato të cilat i jep Agjencia për Ushqim dhe Veterinari, ndërsa krejtësisht të tjera janë të dhënat zyrtare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave për pulla të dhëna kontrolli. Kemi dallim prej 25.000 tonë për të cilët nuk janë dhënë pulla kontrolli, ndërsa Drejtoria Doganore thotë se kanë hyrë në kufi", deklaroi Nikollovski. Siç sqaroi, importuesit në kërkesën për tërheqjen e Rregullores, përveç argumentit për ngjitjen e pullave, reagojnë se duhet ta respektojnë pjesën për deponim të miellit në depot

VAZHDOJNË PËRMBYTJET E LUMENJVE NË POLLOG

VARDARI VËRSHON JEGUNOCËN

Kryetari i Bërvenicës, Enver Pajaziti, tha sot se gjendja është stabilizuar dhe se vërshimet e djeshme kanë ndodhur për shkak të zënies së kanaleve për ujitje nga hedhja e mbeturinave



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 6 mars - Rritja e nivelit të lumit Vardar ka bërë që të ketë përmbytje edhe në fshatrat rajonin e Komunës së Jegunocit. Dëme u shkaktuan në fshatin Raotincë dhe Kopanicë ku janë vërshuar dhjetëra hektarë tokë dhe disa shtëpi. Sipas banorëve, vërshimet ndodhin çdo vit në muajt e parë të vitit kur fillon të shkrihet bora dhe rritet në mënyrë enorme niveli i lumit Vardar. Banorët nënvizuan se disa herë është premtuar që të rregullohet shtrati i lumit në këtë pjesë, por nuk janë marrë masa.

Për momentin, sipas informacionit të pikave hidrologjike, shihet se kudo nivelet janë të larta, por nivele të larta me tendencë rritjeje ka në lumin Vardar në pikën Jegunoc dhe Radushë. Shkrirja e borës e shoqëruar me reshje të cilat ranë në 48 orët e kaluara, kontribuuan për rritjen më të shpejtë të nivelit tek të gjitha rrjedhat lumore në Maqedoni. Nga Komuna e Jegu-

nocit thonë se në bashkëpunim me Qendrën për Menaxhimin e Krizave, është tanimë në terren po mbikëqyr pasojat nga vërshimet. "Po ndërmerren masa dhe aktivitete që janë në kompetencë të komunës, është informuar edhe Qeveria, Qendra e menaxhimit të krizave, momentalisht jemi në terren po ndërmarrim masat e nevojshme me vendosjen e thasëve

aty ku mund të intervenohet, presim që të kemi mbështetje nga Komiteti drejtues", theksuan nga Komuna e Jegunocit.

Po ashtu, gjatë ditës së djeshme ka patur përmbytje edhe në rajonin e Komunës së Bërvenicës dhe Zhelinës. Kryetari i Bërvenicës, Enver Pajaziti, tha sot se gjendja është stabilizuar dhe se vërshimet e djeshme kanë

ndodhur për shkak të zënies së kanaleve për ujitje nga hedhja e mbeturinave. Ai njoftoi se tashmë këtë vit pritet të rregullohen disa kanale për ujitje përmes një projekti me Ambasadën e Zvicrës në ato vende ku dihen që janë kritike dhe ka më shumë vërshime. "Vërshimet e djeshme në territorin e Komunës së Bërvenicës janë si pasojë e zënies së kanaleve me mbeturina nga persona të pandërgjegjshëm. Kanalet për ujitje në këtë territor nuk duhet të jenë vend për të hedhur mbeturina, sepse pasojat i ndjejmë kur ka reshje të shiut. Dje ka patur rritje të nivelit të ujit dhe ka ardhur deri tek përmbytjet. Fatmirësisht nuk kemi dëme në prona private. Ne jemi në një projekt me Ambasadën e Zvicrës për të rregulluar shtratin e këtyre kanaleve në disa vende që janë si pika më kritike dhe ku ka përmbytje më shumë në periudhën e vjeshtës dhe në pranverë", deklaroi Enver Pajaziti, kryetar i Komunës së Bërvenicës. Edhe më tej priten nivele të larta të ujit dhe rrezik prej derdhjeve lokale të lumenjve në Maqedoninë Perëndimore.

SHIU DHE SHKRIRJA E BORËS KA SHKAKTUAR DËMET E PARA

Jashtëzakonisht janë rritur nivelet e ujit të lumenjve Vardar, Cërna Treska, Sateska, Radika, si dhe lumit Pčinja



AKTIVIZOHEN MASAT PËR PËRMBYTJET

Shkup, 6 mars - Institucionet kompetente në pjesën e parandalimit dhe ballafaqimit me përmbytjet nga dje duhet të zbatojnë aktivitetet në pajtueshmëri të konkluzioneve nga seanca e djeshme e Komitetit drejtues për koordinim dhe menaxhim në sistemin për menaxhim me kriza. Sipas informatave të Komitetit drejtues situata është më kritike në rajonin veriperëndimor të Republikës së Maqedonisë, por edhe në luginën e Pellagonisë, si dhe në Qytetin e Shkupit, ku ka derdhje në Zelenikovë dhe tek ndërtesa e Fondit të SPIM-së. Jashtëzakonisht janë rritur nivelet e ujit të lumenjve Vardar, Cërna Treska, Sateska, Radika, si dhe lumit Pčinja. Dalje nga shtrati janë regjistruar në rrjedhat e epërme të Vardarit, Cërna dhe lumit Treska dhe pellgjet e tyre më të vogla. Në Komunën e Jegunocit është vërshuar një sipërfaqe e madhe e tokës bujqësore. Por nëse edhe më tej rritet niveli i lumit Var-

dar, institucionet konstatuan se edhe një pjesë e shtëpive mund të përmbyten. Gjithashtu, në fshatin Forinë të Gostivarit, janë përmbytur një pjesë e shtëpive dhe hapësirat e bodrumeve. Është regjistruar edhe rrëshqitje e dheut tek fshati Novosellë i Tetovës. Një pjesë e hapësirave të bodrumeve në pjesët më të ulëta të qytetit të Strugës janë përmbytur gjatë ditës, për shkak të nivelit të lartë të ujërave të zeza. Gjithashtu, është përmbytur edhe tokë e punuar bujqësore për shkak të derdhjes së lumit Drini i Zi. Në Kërçovë është intervenuar në një pjesë të qyte-

tit, nëpër rrjedhën e lumit Zajashka. Është vendosur mbrojtje me thasë me rërë dhe mekanizëm. Ka edhe derdhje më të vogla të lumit Vardar në rrethinën e Shkupit. Duke pasur parasysh situatën, këto gjendje mund të ndryshohen në afat prej disa orëve. Duke i pasur parasysh paralajmërimet e Drejtorisë për Punë Hidrometeorologjike për reshje të reja të shiut në 24 orët e ardhshme, Komiteti drejtues për ballafaqim me kriza në seancën e djeshme solli disa konkluzione: Në pajtueshmëri të konkluzioneve të Komitetit drejtues Ministria e Transportit dhe

Lidhjeve, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Qendra për Menaxhim me Kriza, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, SHA Ujësjellësi i Republikës së Maqedonisë dhe Bashkësia e njëjësive të vetëqeverisjes lokale, duhet të mbajnë takime koordinuese me të gjithë institucionet kompetente nën kompetencë të tyre, me qëllim të përpilimit të planit të hollësishëm aksional me aktivitete pune sipas institucioneve, në pajtueshmëri të resurseve të disponueshme nga institucionet, në drejtim të veprimit parandalues për pengim të përmbytje-

ve. Rekomandohet që në këto takime koordinuese të vendoset theks në gjendjet me kanalet e lumenjve në territorin e Republikës së Maqedonisë, posaçërisht në rajonet e komunave të goditura dhe në qoftë se është e nevojshme, të ndërmerren aktivitetet për pastrim urgjent të kanaleve. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, në bashkëpunim me komunat nga rajoni i Pollogut, Pellagonisë dhe Shkupit dhe shtabi rajonal për menaxhim me kriza, duhet menjëherë të ndërmarrin aktivitete për sanim dhe pastrim të terrenit ku nevojitet. (U.H)

Shqiptarët e Maqedonisë dhe ndërtimi i shtetit

Nga
Bilall KASAMI



Politika shqiptare në Maqedoni edhe një herë po përballlet me sfidën e ngritjes së projekteve afatgjata, të ndërtimit të shtetit ose shfrytëzimit të resurseve në dispozicion për nevojat e politikës ditore. Kjo situatë po na përsëritet në vazhdimësi për këto tre dekada të tranzicionit të sistemit politik dhe atij ekonomik. Që në fillim, kur u ballafaquam me përvojat e para të organizimit politik pluralist, nuk arritëm që të organizohemi për të ndërtuar një sistem i cili do të shërbente gjeneratave pasardhëse, si udhërrëfyes por edhe si motiv për të vazhduar aty ku e lanë të parët.

Nuk mund të themi se nuk kemi pasur model nga i cili duhej mësuar, nuk mund të themi as se nuk kemi pasur mësues që do të donin që të na ndihmonin dhe më së paku mund të ankohemi se nuk kemi pasur mundësi financiare për të implementuar një model të tillë në jetën politike dhe atë shoqërore.

Duke nisur nga e para, modeli ka qenë aty që në fillim. Me ose pa dashje, që nga shpërbërja e Jugosllavisë dhe pavarësimit i Maqedonisë, i vetmi opsion që është diskutuar nga politika zyrtare ka qenë integrimi i Maqedonisë në strukturat euro-atlantike. Dhe kur jemi këtu, kemi pasur mundësi që të zgjedhim cilindo nga shtetet themeluese të BE-së dhe atë përvojë ta bëjmë pjesë të përkushtimit tonë për të bërë politikë dhe për të ndërtuar një shtet me sistem të ri vlerash, rrjedhimisht edhe ngritjen e institucioneve që ju përshtaten këtyre vlerave. Si sot më kujtohen tregimet për atë se si gjermanët arritën që të ndërtojnë gjithçka nga e para me sakrificë, që në momente dukej se i kalonte limitet njerëzore dhe Gjermania shumë shpejtë pas Luftës së Dytë Botërore të bëhej njëra ndër ekonomitë me të zhvilluara dhe forca motorike e një unioni edhe më të gjerë të shteteve të Evropës. Por gjithë këtë e dëgjoni si një tregim për diçka që nuk na përkiste neve. Dëshironim që të jetojmë jetën e gjermanëve të viteve të nëntëdhjeta, pa dashur të kujtojmë investimin dhe sakrificën e tyre në vitet e dyzeta, pas Luftës së Dytë Botërore. Edhe mësuesit kanë qenë të gatshëm që të na ndihmojnë në këtë rrugëtim. Gati se çdo shtet i BE-së ka pasur projekte për të na ndihmuar në përfaqimin e vlerave evropiane aq shumë të dëshiruara

ra dhe të diskutuara nëpër odat e burrave dhe debatet televizive. E di që diaspora shqiptare ka qenë pjesa më e ndritur e kombit, e gatshme gjithmonë për të sakrifikuar.

Por, politikanët shqiptarë të Maqedonisë nuk e kuptuan seriozitetin e përgjegjësisë që i kishin marrë mbi supet e tyre për të ngritur një shtet nga asgjëja. Në vend se të ulen dhe të ndërtojnë një strategji afatgjatë të veprimit politik, ata filluan që të merren me politikë ditore, sikur Maqedonia ishte një shtet me demokraci të konsoliduar u turrën pas pozitave që ju ofronte pushteti, pa menduar se ai pushtet nuk ju përkiste atyre. Filluan garën me pushtetarët maqedonas për ndarje të kulaçit të pushtetit, pa qenë të gatshëm që të konkurrojnë në udhëheqje të shtetit. Dëshpërimi dhe si pasojë edhe përçarja. Përçarje që e thelloi dëshpërimin deri në atë nivel sa që më nuk kishte shpresë se mund të rikthehet diçka me mjete demokratike dhe filluan edhe organizimet e para më serioze për një luftë të armatosur kundër "pushuesit maqedonas", pa dashur të pranojmë se edhe ne ishim pjesë aktive e gjithë këtij "pushtimi". Njëjtë si në vitet e nëntëdhjeta, të gjithë e përkrahëm këtë të ashtuquajtur luftë çlirimtare. Edhe këtu

me kujtohen situata në raste edhe të pashpjegueshme se si adoleshentë pa lejen e prindërve të tyre iknin nga shtëpitë për të bashkangjitur kësaj lufte çlirimtare. Shpejt mbaroi edhe lufta me ndërhyrje të miqve tanë amerikanë dhe evropianë. U nënshkrua një marrëveshje, e cila në vend se të ishte një themel për ngritje të një shteti të përbashkët ku edhe ne shqiptarët do të ishim pronar të barabartë me maqedonasit, u bastardua në një marrëveshje koalicioni për ndarje të kulaçit të pushtetit. Dhe përsëri dështuam, jo për faj të maqedonasve po për fajin tonë, sepse e përsëritëm po të njëjtin gabim, shkak i të cilit erdhi edhe konflikti i armatosur. Vlerësuam se shteti është i joni pa menduar se edhe sikur të ishte ashtu, shteti kërkon burrështetas për ta udhëhequr dhe jo politikanë që kalkulojnë sa ministri apo drejtori do të marrin në emër të hises që demokraci takon shqiptarëve po ku do të rehatohen të dëgjueshmit e nënës parti. Vërtetë që i morën ministrinë dhe drejtorinë që i dëshiruan, por kur nuk u bënë hisetarë të shtetit.

Pas disa tentimeve të pasuksesshme të iniciativave të reja politike nga njëra anë si dhe dështimeve të njëpasnjëshme të çlirimtarëve të djeshëm dhe tenderomenëve të

sotëm nga ana tjetër, më në fund u paraqit një dritë në fund të tunelit. Një dritë që jepte shpresë se shqiptarët e kanë kuptuar më në fund se duhet të luftojnë për shtetin dhe jo pushtetin. Një dritë që jepte Besën shqiptare se do ta ridefinojë shtetin si shtet të barabartë, ku edhe shqiptarët do të jenë pronarë të këtij shteti bashkë me maqedonasit, pa i anashkaluar të tjerët. Edhe një herë shqiptarët e përkrahën këtë iniciativë po me të njëjtin elan si herët e tjera dhe në zgjedhjet e para që pasuan kjo lëvizje fitoi votat e tyre.

Dhe përsëri tregimi fillon nga e para. Atëherë kur pritej që kjo shpresë të ngritet në një forcë reale politike që do të dijë të artikulojë drejtë kërkesat e shqiptarëve për të qenë shtetformues dhe kjo të arrihet përmes një debati gjithëpërfshirës mes elitave shoqërore maqedonase dhe shqiptare, erdhi goditja e radhës. Në vend se legjitimitetin e fituar në zgjedhje ta shfrytëzojmë në mobilizim të elitave intelektuale të shqiptarëve të Maqedonisë për të përgatitur një vizion më të prekshëm se si do të dukej një shtet i ridefinuar dhe rrjedhimisht edhe strategjinë e jetësimit të këtij vizioni, filloi lufta për të qenë pjesë e një pushteti duke e harruar shtetin. Dhe ata më të paduruarit, të cilët as që e kishin

imagjinuar një fitore në zgjedhje, e shpallën veten pronar të kësaj shprese të rinisë intelektuale të shqiptarëve të Maqedonisë. Atëherë, kur ky organizim politik arriti pjekurin e nevojshme për të ecur vetë drejtë sfidave të radhës, ata u kujdesën që t'i jepnin goditjen vdekjeprurëse me idenë që nëse nuk është e imja - të mos jetë fare. Por, kësaj radhe planet nuk iu dolën ashtu si i kishin menduar, sepse kjo shpresë e rinisë intelektuale tanimë ishte forcuar mjaftueshëm që jo vetëm se të mund të funksionoj si një organizim autonom, autokton dhe autentik, ai kishte krijuar potencialin e mjaftueshëm që të mund të mbijetojë edhe kësaj goditjeje. Dhe përsëri jemi para sfidës për të përfutur dhe materializuar këtë që e kemi arritur deri tani me ndonjë post ministri ose zv.ministri nga njëra anë ose të qëndrojmë stoik dhe të palëkundur rreth idesë se, shqiptarëve të Maqedonisë nuk iu duhet që me maqedonasit të ndajnë pushtetin para se të merren vesh për pronësinë mbi shtetin. Gjithë ata që janë të interesuar për shtetin para pushtetit janë të mirëseardhur t'i bashkohen karvanit të Besës.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet pdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 6 mars | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

ÇFARË FSHIHET PAS "VARDISJES" SË BE-SË NDAJ BALLKANIT DHE POZICIONI I RUSISË



Nga
Michael WINFREY

Në hartën e vendeve anëtare të Bashkimit European ekziston një hapësirë e madhe, qartësisht e dukshme ku ndodhen pesë shtetet e ish-Jugosllavisë dhe Shqipëria. Liderët e këtyre shteteve janë entuziastë se do të bëhen pjesë e këtij Bashkimi. Të shqetësuar për ruajtjen e stabilitetit dhe sidomos për ndikimin në rritje të Rusisë në këtë rajon, edhe zyrtarët e BE-së dëshirojnë që këto vende të jenë pjesë e tij, por jo menjëherë dhe jo në gjendjen që këto shtete janë aktualisht.

1. CILI DËSHIRON TË BËHET PJESË E BE-SË?

Pas pranimit të Sllovenisë në vitin 2004 dhe Kroacisë në vitin 2013, BE-ja "ia ka vënë syrin" edhe gjatë vendeve të tjera në Europën Juglindore që të bëhen pjesë e saj. Këto shtete, të cilat njihen edhe si vendet e Ballkanit Perëndimor janë: Bosnjë-Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Kosova, Republika e Maqedonisë dhe Shqipëria. Referuar një raportit të rëndësishëm që u bë publik në fillim të muajit shkurt, liderët e BE-së kanë përcaktuar vitin 2025, si periudhën e pranimit kur këto vende mund të gëzojnë nga përfitimet e të qenët pjesë e tregut të përbashkët më të madh në botë. Po në këtë raport specifikohet edhe se secili nga këto shtete duhet të forcojë sundimin e shtetit ligjor, të zgjidhë mosmarrëveshjet kufitare dhe të përmirësojnë ekonomitë e tyre, për të qenë të denja përballë konkurrentëve të tjerë të këtij blloku.

2. PSE TË ZGJEROHET MË TEJ BE-JA?

Shtetet e BE-së e shohin zgjerimin si një mënyrë për të përmirësuar stabilitetin dhe sundimin e ligjit në epiqendrën e konflikteve më të përgjakshme të kontinentit që nga Lufta e Dytë Botërore, si dhe për të stabilizuar edhe volatilitetin. Nëse shtetet e BE-së do të arrijnë që ta rrisin ndikimin në mesin e 18 milionë njerëzve në rajon, do të jenë më pak të shqetësuar për pasigurinë e së ardhmes. Përveç kësaj, zgjerimi i bashkimit është një mënyrë për të kundërshtuar ndikimin në rritje të një Rusie gjithnjë e më ekspansioniste nën drejtimin e Presidentit Vladimir Putin dhe përpjekjet e Kinës dhe Turqisë që duan të rrisin ndikimin në Ballka-



nin Perëndimor, nëpërmjet investimeve dhe nismave të ndërmarra aty.

3. A MUNDET QË 6 PREJ TYRE TË BËHEN PJESË E BE-SË NË 2025?

Në draftin fillestar për Strategjinë e saj për Ballkanin Perëndimor, Komisioni European, organi ekzekutiv i BE-së, veçoi vetëm Malin e Zi dhe Serbinë, si dy prej shteteve më potenciale për t'u bërë pjesë e BE-së deri në vitin 2025. Referuar po të njëjtit draft, bisedimet e anëtarësimit mund të kenë filluar edhe për Shqipërinë dhe Republikën e Maqedonisë deri në atë periudhë kohore, ndërsa Kosova dhe Bosnjë-Hercegovina mund të kenë kaluar në statusin e vendeve candidate. Por vetëm një ditë më pas, Komisioni bëri disa ndryshime të rëndësishme të draftit fillestar. Sipas tij, deri në mesin e dekadës së ardhshme, të gjashta këto shtete mund të bëheshin pjesë e BE-së, por me kusht që secili të bënte punën e tij ashtu siç duhej. Ai e krahasoi këtë proces me "një karvan" dhe jo me një "garë varkash", edhe pse realiteti është disi ndryshe, sepse disa vende janë më përpara se të tjerat.

4. CILA ËSHTË PENGESA MË E MADHE?

Ndoshta sundimi i shtetit ligjor, dhe Mali i Zi është shembulli më konkret që mund të merret në këtë drejtim. Edhe pse ai i ka filluar bisedimet për t'u bashkuar me BE-në që në vitin 2012, është një prej shteteve që ka mbetur më mbrapa në rrugën drejt anëtarësimit. Por si asaj ashtu edhe shteteve të saj fqinje i është kërkuar nga Komisioni European që të ulë nivelin e kri-

mit të organizuar dhe ndikimin e politikës në gjykata dhe në media. Por duhet thënë se sipas raportit të fundit të 2016-s të Komisionit European, ky shtet ka bërë përparime në drejtim të uljes së nivelit të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

5. SI NDIKOJNË MOSMARRËVESHJET RAJONALE NË KËTË DREJTIM?

Mosmarrëveshjet e tejzgjatura mbi kufijtë, si dhe armiqësia nga luftërat e viteve 1990, janë një pengesë tjetër. Rasti më tipik në këtë drejtim është refuzimi i Serbisë për të njohur sovranitetin e Kosovës si shtet i pavarur që nga viti 2008. Por teksa Serbia është shteti kandidat i dytë që ka ecur më shumë në anëtarësimin drejt BE-së, Komisioni i ka vënë si kusht pranimit, normalizimin e lidhjeve me shtetin fqinj, Kosovën. Presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, ka deklaruar se do të përpiqet që deri në muajin prill do të ketë gjetur një zgjidhje. Por Serbia ka edhe mbështetjen më të ulët publike për anëtarësimin në BE, në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

6. CILAT JANË KONSIDERATAT EKONOMIKE?

Komisioni arriti në përfundim se asnjë nga shtetet e Ballkanit Perëndimor nuk ka një "ekonomi tregu funksionale" dhe as aftësinë për të përballuar "presionin konkurrues të forcave të tregut" në BE. Shqipërisë, për shembull, i është dhënë statusi i shtetit kandidatit, gjë që i paraprin fillimit të bisedimeve. Brukseli po kërkon që vendi të ulë borxhin publik, që është më shumë se 70% e prodhi-

mit ekonomik vjetor, të ulë deficitin buxhetor, të rrisë konkurrencën në treg dhe të përmirësojë infrastrukturën në një vend që ka vetëm 1.4 kilometra rrugë për çdo 1.000 banorë, vetëm 1/7 e mesatares së BE-së.

7. A KA PENGESA TË TJERA?

Po. Rasti i fundit është mosmarrëveshja e Maqedonisë me Greqinë fqinje. Ndërsa Republika e Maqedonisë ka qenë e para në rajon që të merrte statusin e shtetit kandidat, përparimi i saj në rrugën drejt anëtarësimit në BE dhe NATO ka hasur në pengesa të shumta nga Greqia. Të dy vendet janë në bisedime për të gjetur një zgjidhje, sepse vetëm pas saj, Republika e Maqedonisë mund të nisë zyrtarisht negociatat e pranimit në BE.

8. PSE BOSNJË-HERCEGOVINA ËSHTË MË MBRAPA SE SHTETET E TJERA?

Bosnjë-Hercegovina është më mbrapa se shtetet e tjera për shkak të nivelit të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Faktorë të tillë nuk gjenden vetëm në këtë shtet, por ajo është edhe burim paqëndrueshmërie, duke pasur parasysh se dy komponentët e saj kryesorë, Republika e madhe etnike Srpska dhe Federata Kroato-Bosnjake, akuzojnë njëra-tjetrën se po nxisin realizimin e objektivave të kundërta të njëra-tjetrës. Sipas KE-së, ajo mund të bëhet një shtet kandidat me anë të përpjekjeve të nevojshme dhe një angazhimi të qëndrueshëm. Kosova është ajo që po përballlet me pengesa edhe më të mëdha në krahasim me të tjerat, sepse 5 prej 28 shteteve anëtare të

Rusia gjithnjë ka dashur dhe është përpjekur vazhdimisht që të rrisë ndikimin në rajon. Mali i Zi akuzoi Kremlinin për nxitjen e një grushti shteti në 2016-n, përpara se vendi të bëhej pjesë e NATO-s. Por Moska e mohon akuzën. Rusia gjithashtu mbështet refuzimin e Serbisë për të njohur Kosovën në forumet ndërkombëtare, si edhe shitjen e tankeve, aeroplanëve të luftës dhe ofrimin e investimeve të shumta në këtë shtet


Bashkimit European nuk e kanë njohur atë ende si shtet i pavarur. Ajo ka qenë gjithashtu pjesë e tensioneve politike midis qeverisë dhe opozitës, situatë e cila ka shkuar edhe në përlëshje të shpeshta në Parlament, ku janë hedhur granta-gazi lotsjellës.

9. CILI ËSHTË POZICIONI I RUSISË?

Rusia gjithnjë ka dashur dhe është përpjekur vazhdimisht që të rrisë ndikimin në rajon. Mali i Zi akuzoi Kremlinin për nxitjen e një grushti shteti në 2016-n, përpara se vendi të bëhej pjesë e NATO-s. Por Moska e mohon akuzën. Rusia gjithashtu mbështet refuzimin e Serbisë për të njohur Kosovën në forumet ndërkombëtare, si edhe shitjen e tankeve, aeroplanëve të luftës dhe ofrimin e investimeve të shumta në këtë shtet. Në mbështetje të të gjitha këtyre veprimeve, Serbia ka refuzuar të bashkohet me vendet e BE-së në vendosjen e sanksioneve ndaj qeverisë së Putinit.

ABDULLA MEHMETI

ÇËSHTJA JONË KA FILLUAR TË LËVIZË MBRAPSHTË!



Shumë dijetarë vendës dhe të huaj këtë shekull e kanë cilësuar si shekulli i shqiptarëve, por kjo ka të bëjë me rrethanat e reje të krijuara pas rënies së regjimit komunist, ndërsa pak njerëz kanë mundur ta paramendojnë se me krijimin e rrethanave të reja nuk do të ndryshojë edhe mentaliteti i njerëzve, sidomos i elitave intelektuale, të cilat duhet të jenë pararojë e ndryshimeve pozitive në një shoqëri...

Koha

Delvina KËRLUKU

Abdulla Mehmeti (Voka) u lind në Shipkovicë të Tetovës, më 2 janar 1962. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme në Gjymnazin e Tetovës. Arsimin e lartë e kreu në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Filologjisë - Dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe. Njëkohësisht studioi me korrespondencë edhe në Fakultetin Juridik të po këtij Universiteti. Studimet pasuniversitare i ka ndjekur në Universitetin e Shkupit, për kulturologji në fushën e letërsisë. Gjatë kohës së studimeve në Prishtinë, ishte pjesë aktive në lëvizjen studentore dhe demonstratat e vitit 1981. Për bindjet e tij politike u dënua me burg dhe iu morën të gjitha të drejtat qytetare, për shkollim të mëtejshëm, punësim dhe zhvillimin e veprimtarive publike. Në vitet e 90-ta ishte formues i Bashkësisë Kulturore Shqiptare në Maqedoni. Ishte pjesë e Kuvendit themelues të Universitetit të Tetovës, më 1994. Ndërsa, si veprimtar, studioi dhe krijoi i lirë, deri më vitin 2002. Ku, për herë të parë u punësua si profesor i gjuhës dhe komunikimit në Shkollën e mesme për kuadro të ekonomisë "Mosha Pijade", në Tetovë. Vetëm pas një viti do të largohet nga puna, për arsye të panjohura, të motivuara nga politika ditore dhe qarqet antishqiptare në radhët e partive politike shqiptare në Maqedoni. Në vitin 2007, punësohet në Universitetin e Tetovës. Deri më tani ka publikuar me dhjetëra punime shkencore, publicistike, analiza politike dhe studime për kulturën, gjuhën dhe letërsinë shqipe, në shumë gazeta, revista dhe publikime të tjera. Ka marrë pjesë në disa konferenca, simpoziume, tribuna dhe manifestime të tjera shkencore. Përveç që kryen

detyrën e kryetarit i disa asociacioneve kulturore dhe shkencore shqiptare në Maqedoni, si: kryetar i Bashkësisë Kulturore Shqiptare, kryetar i Forumit Kombëtar të Forcave të Bashkuara, është edhe anëtar i organeve drejtuese të disa asociacioneve kulturore dhe shkencore brenda dhe jashtë vendit, ku merr pjesë aktive në organizimin e veprimtarisë së tyre. Në shkurt të vitit 2016 është zgjedhur Shefi Seksionit për Evropën, i Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave edhe Arteve, dhe anëtar i Bordit të Drejtorëve të kësaj Akademie, me seli në Nju Jork, si dhe Kryetar i Degës në Maqedoni të kësaj Akademie (me shtrirje të aktiviteteve edhe Shqipëri, Kosovë dhe Mal të Zi), me seli në Shkup. Aktualisht jeton në Tetovë dhe punon në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

KOHA: Z. Mehmeti, duke lexuar biografinë Tuaj, fitohet përshtypje se gjithë jetën ia keni kushtuar çështjes kombëtare. Mund të na thoni me disa fjalë se cila është gjendja konkrete e shqiptarëve në Maqedoni? Ç'kanë arritur në planin shoqëroro-politiko-ekonomik dhe atë arsimoro-kulturor?

MEHMETI: Gjendja e sotme e shqiptarëve në Maqedoni është tepër e rëndë, me tendencë përkeqësimi të mëtejshëm, nëse nuk do të ndërmerren masa konkrete për parandalimin e tendencave negative që e kanë përfshirë shoqërinë shqiptare, sidomos gjatë viteve të fundit. Shumë dijetarë vendës dhe të huaj këtë shekull e kanë cilësuar si shekulli i shqiptarëve, por kjo ka të bëjë me rrethanat e reje të krijuara pas rënies së regjimit komunist, ndërsa pak njerëz kanë mundur ta paramendojnë se me krijimin e rrethanave të reja nuk do të ndryshojë edhe mentaliteti i njerëzve, si-

domos i elitave intelektuale, të cilat duhet të jenë pararojë e ndryshimeve pozitive në një shoqëri. Përballë strategjisë për mbajtjen edhe më tej të shqiptarëve në pozitë të varur, të nënshtruar dhe nën sundim, shqiptarët nuk arritën të ndërtojnë një strategji për mbrojtjen e tyre, zhvillim dhe progres, siç ua mundësuan proceset e reja demokratike. Përkundrazi, procesin e pluralizmit shqiptarët e filluan mbrapshtë, ose ua imponuan faktorë të tjerë strukturën e udhëheqësve politik me mentalitet të vjetër nga ish sistemi, me çka shqiptarët më tepër janë dëmtuar se sa janë ndihmuar. Shoqëria shqiptare sot nuk është në rrugë të mbarë të zhvillimit, por në rrugë të shkatërrimit, moral, politik, ekonomik dhe kulturor, me tendencë të tkurrjes etnike dhe të zvogëlimit të hapësirës për jetë të lirë dhe të denjë qytetare. Më tepër se kurrë, sot jeta, ekzistenca dhe qenia shqiptare është e këncënuar dhe rrezikuar, nga politikanët e vetë dhe qarqet e huaja, nga veset e politikanëve dhe pseudointeligjencias, përgjithësisht nga ligësitet e të gjitha llojeve nga pushteti dhe mënyra jodemokratike e sundimit. Të gjithë këto, gati sa e kanë shndërruar jetën e shqiptarëve në një ferr të vërtetë. Asnjëherë gjatë historisë shqiptarët nuk kanë qenë më keq të sunduar, të mashtruar dhe plaçkitur siç janë sot. Korrupsioni dhe kriminaliteti, pasiguria dhe mungesa e perspektivës në vend, padrejtësitë dhe pashpresa, i kanë detyruar shumicën e qytetarëve, sidomos të rinisë shqiptare, të largohen në botën e jashtme, jo për jetë më të mirë, por thjeshtë për sigurimin e ekzistencës. Këtu politikën e bëjnë njerëzit e lig dhe të papërgjegjshëm, që kurrë nuk kanë denjuar të japin llogari për dështimet e tyre në pushtet. Periudha e stërzgja-

tur e të ashtuquajturit tranzicion demokratik po vazhdon ende, edhe pas tri dekada dështimesh, stagnimi, krize dhe kaosi të përgjithshëm në shoqëri. Kjo pasqyrë e errët nuk është shprehje e pesimizmit, por duhet të shërbejë si alarm për zgjimin tonë, që ta kuptojmë se është koha e fundit për të ndërmarrë masa konkrete dhe të menjëhershme për tejkalimin e kësaj gjendje tejet të pashpresë. Shqiptarët kanë potencial ekonomik dhe kadrovik, traditë shtet formuese dhe forcë morale për ndërtimin dhe konsolidimin e një shoqërie të përparuar, demokratike dhe progresive, për ndërtimin e shtetit ligjor, zhvillimin e ekonomik, forcimin e institucioneve të pushtetit, përparimin arsimor, shkencor dhe kulturor, përparimin e demokracisë, lirive dhe të drejtave të njeriut, dhe për këtë nuk duhet të presim ditë më të mira. Koha është sot të investojmë për të ardhmen tonë më të mirë.

KOHA: Keni reaguar gati për çdo ngjarje të rëndësishme që ka pasur të bëjë me shqiptarët. Por partitë tona politike kanë vazhduar me "itinerarin" e trenave të tyre. Përse?

MEHMETI: Kjo pyetje kërkon një përgjigje më të plotë, më sqaruese dhe gjithëpërfshirëse, për t'u kuptuar nga lexuesit se cili është thelbi, nyja e këtij problemi që kërkon zgjidhje. Demokracia si proces, fatkeqësisht u kuptua mbrapshtë nga shqiptarët, si edhe nga shumica e popujve në shtetet e ish bllokut socialist. Transformimi demokratik i shoqërisë në të gjitha këto vende, sidomos në vendin tonë, është zhvilluar si proces e kontrolluar nga strukturat e ish sigurimeve të shtetit në këto shtete, dhe kjo ka qenë fatkeqësia kryesore. Fatkeqësia tjetër ka ndodhur edhe me fajin tonë, meqë strukturat e pushtetit të ri krijuan

strategji të re për t'i mashtruar qytetarët, duke shkatërruar gjithçka, çdo vlerë nga e kaluara, në ekonomi, industri, institucione dhe infrastrukturë, në emër të demokracisë, të së resë që duhej të sjellë ndryshime në shoqëri, zhvillim dhe progres, frymë të re, qytetërim, më shumë liri dhe të drejta për qytetarët, por kjo fatkeqësisht nuk ndodhi. Në vend të saj u promovuan antivlerat me të cilat nuk ishte përballur kjo shoqëri më parë, si korrupsioni, krimi i organizuar, rritja në përmasa galopante e prostitucionit, drogës dhe shumë fenomeneve të tjera devijante në shoqëri. Është e vërtetë se unë kam reaguar vazhdimisht për parandalimin, ose kundërvënien e qytetarëve ndaj këtyre fenomeneve negative në shoqërinë tonë; kam reaguar edhe për veprimet e gabuara të faktorit politik shqiptar, devijimet e pushtetit nga koncepti themelor i demokracisë, liria dhe barazia e qytetarëve, pavarësisht nga përkatësia etnike, fetare, gjuhësore dhe çfarëdo përkatësie tjetër. Pushteti fatkeqësisht dita-ditës është zhytur edhe më tepër në pellgun e korrupsionit dhe krimin, duke i ndryshuar vetëm metodat e veprimtimit, fjalorin dhe teknikat e mashtrimit, duke prodhuar krizë të vazhdueshme, në esencë duke mbetur i njëjti, i pandryshuar, sidomos në raport me të drejtat kombëtare të shqiptarëve.

KOHA: Është krijuar bindja se partitë tona, në aspektin e programeve teorike, i ngjajnë si veza vesë. Përse nuk janë të profilizuara në aspektin ideologjik? Nuk kanë ç'të ofrojnë, apo më lehtë e kanë t'i vardisen popullit me parulla "patriotike" dhe me metoda populiste?

MEHMETI: Çështja që parashtruat përmes kësaj pyetje lidhet me mungesën e traditës politike dhe të demokracisë në këtë shtet. Shoqëritë që dalin nga regjimet totalitare vështirë mund të ndryshohen, nëse mungojnë, shkelen dhe mohohen liritë dhe të drejtat themelore qytetare, nëse nuk u jepet mundësi dhe hapësirë elitave intelektuale që të kontribuojnë për ndryshimet e domosdoshme në shoqëri, si dhe në ndërtimin e koncepteve të reja, zhvillimin, përparimin dhe zbatimin e teorive politike moderne, sikur në shtetet tjera perëndimore me demokraci të zhvilluar. Këtu tek ne drejtuesit e subjekteve politike më parë kanë qenë njerëz të dëgjueshëm të pushtetit dhe bashkëpunëtorë të ish regjimit. Këta individë, pa përgatitje më elementare teorike për sistemet politike dhe pa njohje të mjaftueshme për ideologjitë, formatet dhe orientimet partive që i kanë udhëhequr dhe i udhëheqin. Këta individë as që kanë menduar ndonjëherë dhe as duan ta dinë se cila parti është me orientim të djathtë e cila të majtë. Shpeshherë i përziejnë këto koncepte, ngjyrat dhe ideologjitë, deri në atë masë sa që nuk i dallojnë ideologjitë politike dhe fetare nga ideologjia kombëtare. Mjaf-ton që mashtrimin dhe propagandën e tyre e mbështetin kryesisht në frymën kombëtare, pa çka se asnjë rezultat konkret nuk kanë arritur në këtë drejtim deri më sot.

KOHA: Jeni ndër themeluesit e

Universitetit të Tetovës. Mendoni se është mirë për arsimin dhe shkencën shqiptare këtu që edhe universiteti i dytë "u ngulit" aty, apo mbase edhe i treti të ishte po në Tetovë? Ose, mos mendoni edhe ju si një pjesë e strukturave të caktuara politike, se kryeqytet nuk është Shkupi, por Tetova, apo ky veprim është një gabim me pasoja historike?

MEHMETI: Universiteti i Tetovës, si universitet i parë i shqiptarëve me mësim në gjuhën amtare, nuk ka qenë vetëm një projekt arsimor, por para së gjithash projekt kombëtar, për emancipimin, ngritjen dhe zhvillimin e popullit shqiptar në Maqedoni, me këtë edhe sigurimin e barazisë së plotë në këtë shtet. Shumë individë me ndikim na kanë sugjeruar që në fillim të punës sonë, si nismëtarë të këtij projekti, që selia e Universitetit të Tetovës të jetë në Shkup. Në njërin nga elaboratet fillestare për këtë Universitet është analizuar seriozisht kjo ide. Që me Platformën për hapjen e Universitetit Shqiptar në Maqedoni (nga Kuvendi themelues i emëruar sipas selisë së tij: Universiteti i Tetovës), kjo çështje është trajtuar hollësisht dhe me përgjegjësi të lartë intelektuale dhe kombëtare. Nuk ka mundur askush ta thejë këtë koncept atëkohë, meqë unë dora vetë kam qenë hartues i këtij dokumenti strategjik, dhe atëherë, sot dhe në të ardhmen mbaj përgjegjësi për këtë, askush tjetër, sepse kam konsideruar që nuk ka asnjë mundësi që një projekt kaq i rëndësishëm kombëtar, më tepër se arsimor, shkencor dhe kulturor, mund të realizohej në Shkup ose në ndonjë qytet tjetër. Ne jemi veprimtarë që kemi punuar dhe vepruar me dekada, e kemi studiuar në hollësi gjendjen në të cilën gjenden shqiptarët, rrethanat dhe qasjen e pushtetit të atëhershëm ndaj kësaj çështje dhe përgjithësisht ndaj shqiptarëve. Universiteti i dytë lindi si projekt politik e jo kombëtar, me tendencë dhe besim të plotë se do të arrijë ta shuaj, shkrijë dhe fuzionojë gjithë atë që ishte arritur gjatë disa viteve në Universitetin e Tetovës, tanimë kur i përfundonin studimet gjenerata e dytë dhe e tretë e studentëve. Ju siguroj që kjo nuk ka të bëjë me ndonjë tendencë shpirtngushtësie, provincializmi ose lokalizmi nga ana e tetovarëve, apo të ndonjë interesi tjetër individual ose grupor, por ka qenë thjesht strategji e përgatitur

mirë, që ky projekt të mos dështojë, por t'i rezistojë makinerisë propagandistike dhe represive të pushtetit të atëhershëm. Më në fund koha e dëshmoi se kemi pasur të drejtë. Ka disa vite që janë hapur studime të dizpersuara të UT-së dhe UEJL-së edhe në Shkup dhe qytete të tjera. U krijuan kushte edhe për hapjen e Universitetit "Nëna Terezë" në Shkup. Tani është shumë lehtë të hapet një universitet, kur dhjetëra universitete private janë hapur gati në çdo qytet të vendit. Por, Universiteti i Tetovës sot ka arritur moshën e tij të pjekurisë së plotë, duke hyrë në dekadën e tretë të punës dhe veprimtarisë së tij.

KOHA: Jeni kryetar i Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve, me seli në Shkup. Është kjo një gjë virtuale, apo merreni me diçka konkrete, meqë nuk na ka rastisur të lexojmë për ndonjë veprimtarë dhe rezultat konkret? Cila konkretisht është detyra parësore dhe aktivitetet e Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve në Maqedoni?

MEHMETI: Akademia Shqiptare Amerikane e Shkencave dhe Arteve nuk është virtuale, por është simotër e Akademisë me të njëjtin emër, me seli në Nju Jork, e cila funksionon që nga viti 1995 atje. Kjo Akademia është subjekt juridik i regjistruar që nga viti 2016 dhe ka zhvilluar një serë aktiviteteve shkencore, kulturore dhe arsimore. Varet nga mediat dhe gazetarët sa kanë qenë të interesuar t'i ndjekin dhe pasqyrojnë këto aktivitete, për shkak të krizës politike që e përfshiu vendin, kur gjithçka u shndërrua në politikë, në media, lajme e opinion. Akademitë kudo në botë nuk janë institucione që bëjnë zhurmë, ato kanë fushën e tyre specifike të veprimit. Planet e punës së tyre janë afatgjata. Sigurisht që kemi plane, jemi në realizim e sipër të disa projekteve të rëndësishme të cilat pritet së shpejti t'i japin rezultatet e tyre. Për më tepër mund të flasim në një rast tjetër, përmes ndonjë interviste të veçantë në lidhje me programin, veprimtarinë dhe projektet e kësaj Akademie.

KOHA: Z.Mehmeti duke i ditur rrethanat tona politike, ekonomike dhe sociale në Maqedoni, të gjithë ne kemi kaluar jetë të vështirë. Çfarë mund të na thoni për jetën tuaj të ndikuar nga këto rrethana?

MEHMETI: Nuk e kam shprehur as dëshirë të flas për veten time. Secili

prej nesh ka kaluar jetë të vështirë dhe kjo është tepër e kuptueshme përderisa kemi jetuar nën një regjim totalitar dhe tepër represiv, përse ende vazhdojmë të jetojmë në një shoqëri në tranzicion, e cila ende është në konsolidim e sipër, ku duhet secili prej nesh të jep kontribut konkret për një të ardhme më të mirë. Por kjo varet nga shumë faktorë dhe mund të them se rruga jonë do të vazhdojë të jetë e vështirë edhe për një kohë, përderisa nuk ndërtojmë shoqëri me vlera të mirëfillta demokratike, nuk konsolidohet shteti ligjor dhe nuk përparojmë në masë të duhur të drejtat dhe liritë e njeriut në këtë shtet. Ky shtet ende është jodemokratik, ku nuk ka filluar ta marrë dënimin e merituar korrupsioni dhe krimi me përmasa kaq të mëdha, ku degradimi moral i shoqërisë ende është në rritje, ku qenia njerëzore e ka çmimin më të lirë se çdo gjë tjetër, si një mall me të cilin mund të manipulohet çdokush dhe si të dojë, duke filluar nga oligarkët dhe grupacionet politike, strukturat kriminale, segmente të caktuara të pushtetit, pa edhe një pjesë e papërgjegjshme e inteligjencies, grupime të caktuara fetare dhe biznesmenë të paskrupullit.

KOHA: Si i shihni ndryshimet, veçmas gjeopolitike në Maqedoni, nga rinia e juaj e deri më sot?

MEHMETI: Ne jemi pjesë e botës, nuk jemi masë amorfe njerëzish të izoluar një hapësirë, pa mundësi t'i përcjellim dhe përfjetojmë përparimet e mëdha në botën e sotme, sidomos zhvillimet teknike dhe teknologjike. Sot jetojmë në periudhën e revolucionit të tretë teknologjik, në kohën e internetit dhe teknologjive informatike. Ndryshimet janë aq kolosale sa që gjeneratat më të vjetra nuk kanë mundësi t'i ndjekin dhe të bëhen pjesë e këtyre ndryshimeve. Por, çështja është se sa janë të dobishme dhe humane këto zhvillime dhe në dobi të njerëzimit, a kanë vetëm qëllime komerciale, apo e humanizojnë dhe ndryshojnë shoqërinë në kahe pozitive. Nga disa vlera të së kaluarës nuk duhet të heqim dorë menjëherë, as të përkrahim vetëm aspektin komercial të ndryshimeve të reja, siç ka tendenca të na imponohen pa asnjë analizë paraprake profesionale. Kjo mund të krijojë kaos në të ardhmen, siç na ka krijuar për shembull koncepti i ekonomisë të tregut, të cilin ne e kuptuam mbrapshtë, duke e shkatërruar ekonominë vendëse, industrinë dhe duke e shndërruar vendin në treg të hapur për konsum të mallrave nga jashtë. Si mund të sigurohet progres në një shoqëri e cila asgjë nuk prodhon, nuk eksporton, ndërsa kërkon rritje të standardit jetësor si në vendet me industri të zhvilluar, të cilat konkurrojnë me prodhime cilësore, luftojnë për burime energjetike dhe tregje të reja? Ne aktualisht eksportojmë vetëm fuqi punëtore dhe kjo na shpie drejtë shkatërrimit, edhe atë, për një kohë të shkurtë. Përkundër kësaj, në planin gjeopolitik dhe gjeostrategjik, shqiptarët janë popull me perspektivë të madhe, jo vetëm në rajon por edhe në Evropë, me vetë faktin se janë pjesë e integritimeve globale, BE-së dhe

NATO-s, të gjithë shqiptarët së bashku, në nivel kombi dhe me të gjitha trojet shqiptare të ndara në disa shtete aktuale.

KOHA: Çfarë flet jeta e juaj, si pjesë aktive në lëvizjen studentore dhe demonstratat e vitit 1981 dhe cilat janë pasojat e asaj kohe?

MEHMETI: Gjenerata ime ka kaluar nëpër një ferr të vërtetë. Pushteti socialist ka qenë tepër i mirë për një pjesë të popullsisë, tepër joshës për një shtresë, sidomos për familjet që kanë marrë pjesë në pushtet ose kanë qenë të lidhura me atë. Propaganda e regjimit të asaj kohe ka qenë aq perfide, sa nuk ka mundur ta kuptojë secili, deri në momentin e shndërrimit të tij në përbindësh gjakatar, me fillimin e konfliktit të armatosura në ish republikat jugosllave. Kanë qenë një numër i vogël i familjeve me tradita atdhetare të kultivuara brez pas brezi që kanë mundur ta kuptojnë filozofinë mashtruese të atij regjimi, i cili për qëllim të fundit e ka pasur krijimin e një shoqërie pa identitet. Nga popujt jugosllavë, por edhe nga shqiptarët dhe popujt tjerë jo sllavë, filloi të krijohet një komb të ri jugosllav, në të cilin filluan të konvertohen edhe një pjesë e shqiptarëve. Ku do të kishim arritur me këtë shkombëtarizim total, po të mos ishte zgjimi i madh i shqiptarëve në vitin 1981, përmes pranverës studentore, pjesë aktive të cilës kam qenë edhe unë dhe shumë të tjerë, kryesisht studentë të Universitetit të Prishtinës. Pas kësaj periudhe filloi procesi i madh i diferencimit, izolimi, dënimet e këtyre individëve dhe familjet e tyre, jo vetëm nga pushteti por edhe nga një pjesë e madhe e vetë shqiptarëve, sidomos këtu në Maqedoni. Është një çudi e vërtetë se si kemi arritur të mbijetojmë në këtë betejë të padrejtë, kur përveç pushtetit i kemi pasur kundër edhe shumë njerëz të afërt me të cilët kemi jetuar dhe punuar më parë. Kjo është vështirë të përshkruhet me pak reshta. Më vjen keq se kjo frymë antishqiptare ndaj këtyre individëve është zbatuar edhe më vonë nga regjimi demokratik, kundër të njëjtëve njerëz dhe gati me të njëjtat metoda. Nuk ka peshore më të mirë se kur njeriu e njuh vetveten, vlerat dhe virtutet, dhe përballë e ka pushtetin me strukturat politike dhe partiake që u shiten shqiptarëve për forca atdhetare, ndërsa për asgjë nuk dallojnë nga ish regjimi totalitar komunist, me diferencime, izolime, mospërfillje, përbuzje, shkelje e mohime, pa edhe dëmtimin në të gjitha format të këtyre njerëzve, të cilët bartin me vete përvoja të jashtëzakonshme nga e kaluara jo e largët, të cilat mund t'u shërbejnë shumë gjeneratave të reja, sidomos lëvizjes politike të shqiptarëve, e cila ende ka nevojë për individë që u kanë pri ndryshimeve dhe mund të kontribuojnë në ndërtimin e një vizioni të ri për të ardhmen e shqiptarëve në Maqedoni dhe jo vetëm.

KOHA: Çfarë i ke lënë mangët familjes tuaj, duke shpenzuar kohë në aktivitet tuaja për të mirën e shoqërisë shqiptare?

MEHMETI: Është tepër vështirë për ta dhënë një përgjigje të saktë në

lidhje me këtë pyetje, për disa arsye: e para, sepse jo vetëm unë, por një kategori njerëzish siç na quajnë "idealiste" janë të tillë për nga natyra, nga edukata familjare dhe mënyra e arsimit. Ne nuk kemi nxënë vetëm atë që na kanë ofruar programet shkollorë, por kemi qenë hulumtues të pa ndalur të fenomeneve shoqërore, shfrytëzues të literaturës që vetë e kemi zgjedhur, ose na e kanë sugjeruar të afërmit tanë më të moshuar me përvoja jetësore tepër begatshme. Po të kisha mundësi ta rikthej edhe njëherë të kaluarën, do ta kisha zgjedhur edhe një herë po atë rrugë nëpër të cilën kam shtegtuar në jetë dhe veprimtarinë time, por me intensitet më të shtuar dhe me sakrificë edhe më të mëdha. Nga kjo distancë kohore prej disa dekadash vërej që kemi qenë në rrugë të drejtë, por është dashur të jemi më këmbëngulës, më pa kompromis për realizimin e disa qëllimeve tona jetësore në të mirën e përgjithshme. Sa i kam lënë mangët familjes time, këtë mund ta dinë vetëm prindërit, të afërmit dhe sidomos fëmijët tanë, të rritur me baba dhe përherë me mungesën e tij në familje, me mirëqenie të përgjithshme në familje, ku shpenzuesi më madh është pikërisht prindi, i cili duhet t'u sigurojë fëmijëve mirëqenie, dashuri dhe ngrohtësi prindërore. Këtë luks fëmijët tanë nuk e kanë pasur dhe kjo është një sakrificë e madhe e tërë familjes, jo vetëm e jona si individë.

Në rrugën që ne kemi kaluar, sidomos gjatë regjimit komunist kanë mundur të jenë të lumtur vetëm njerëzit e bindur ndaj pushtetit, të përlurur dhe lakmitarët, ndërsa ne të tjerët që kemi qenë në anën tjetër, në luftë të përhershme me pushtetin jemi dëmtuar tepër shumë, dhe jo vetëm ekonomikisht. Me mundin, kohën dhe sakrificat tjera për aktivitetet të ndryshme në vazhdimësi, me dekada të tëra, do të kishim realizuar dhjetëfish më tepër interesin personal dhe mirëqenien e familjeve tona. Ne u kemi lënë fëmijëve tanë dhe brezave diçka që nuk do ta arrinin pa këtë sakrificë. Kjo nuk është vetëm karakteristikë e jona, këtë e kanë bërë ndër shekuj të gjithë prijësit e lëvizjeve politike dhe kulturore të popujve të përparuar të botës. Më vjen keq pse nuk kemi mundur edhe më tepër, sepse populli ynë ka pasur dhe ende ka nevojë për sakrificë të këtilla.

Çështja jonë ka filluar të lëvizë mbrapshtë nga momenti kur në një farë mënyre është ndryshuar kodi ynë i veprimit, tek shumica e veprimtarëve të mëvonshëm; në vende se të japin për interesin e përgjithshëm, kanë shfrytëzuar dhe zhvatur gjithçka që kanë mundur për ta dëmtuar këtë interes dhe kjo do të reflektohet negativisht për një kohë të gjatë në vetëdijen e gjeneratave të reja.

Sot kjo shihet në dezorientimin e rinisë, largimin nga vendlindja, më tepër duke menduar për vetveten se për interesin e përgjithshëm. Kjo tendencë e dëmton, e gjymton rëndë, e paralizon lëvizjen shoqërore dhe progresin, e pamundëson realizimin e idealeve të mëdha që duhet t'i bart secila gjeneratë në kohën e saj.





Vazhdimi i seancës së Kuvendit të Kosovës për ratifikimin e Marrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, sipas partive parlamentare, mund të mbahet gjatë kësaj jave, por që nuk është specifikuar ndonjë datë e saktë

Deputetë nga koalicioni qeverisës dhe ata nga një pjesë e taborit opozitar, shpresojnë se gjatë kësaj jave do të reflektojnë deputetët të cilët po e kundërshtojnë Marrëveshjen, edhe pse të njëjtat vlerësimet i kanë bërë edhe para seancave të kaluara, të cilat u mbyllën pa asnjë vendim. Kuvendi i Kosovës, deri më tash, ka thirrur tri seanca për ratifikimin e Demarkacionit, por për shkak të mungesës së 80 votave të domosdoshme për kalimin e marrëveshjes, ato janë shtyrë vazhdimisht, përkatesisht janë ndërprerë. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është shprehur optimist se shumë shpjet do arrihet një konsensus i përbashkët me partitë tjera për ratifikimin e Marrëveshjes, pasi sipas tij, Kosova është vonuar në këtë çështje.

NË PRITJE TË SEANCËS PËR DEMARKACIONIN

shtje. Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe partia politike opozitare Lidhja Demokratike e Kosovës, tashmë kanë arritur një konsensus për votimin e Demarkacionit.

Por, të gjitha së bashku nuk e mbërrijnë dot numrin prej 80 votave të nevojshme për ratifikim. Andaj, ato janë në pritje të reflektimeve edhe nga deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje apo ata të Listës Serbe. Zenun Pajaziti, deputet i Partisë Demokratike të Kosovës, tha për Radion Evropa e Lirë se seanca me gjasë do mbahet gjatë kësaj jave, pasi sipas tij, pritet që të reflektojnë edhe deputetët që po e kundërshtojnë këtë marrëveshje. "Siç duket edhe të Lista Serbe ka diçka që mund të ndodhë në aspektin pozitiv gjatë kësaj jave. Po presim që kjo të bëhet e ditur sa më shpejtë dhe të caktohet një seancë në të cilën do të bëhen të ditura të gjitha", tha Pajaziti.

Ndërkaq, deputetja e Mimoza

Kusari-Lila nga Alternativa, parti e cila është pjesë e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, tha për Radion Evropa e Lirë se nuk ka nevojë që të humbet më kohë, por duhet të veprohet shpejtë me votim dhe ratifikim të Marrëveshjes. "Po besoj se duhet të votohet. Është një prej temave që e ka mbajtur Kosovën shumë gjatë dhe e cila për veç faktit që po pengon Kosovën në rrugën drejtë liberalizimit të vizave, gjithashtu po e pengon një funksionim normal të Kuvendit të Kosovës, për shkak se javë pas jave po lidhemi më caktimin e seancave të jashtëzakonshme për Demarkacionin, përderisa seancat e rregullta po pësojnë shumë, pasi po humb vëmendja për seanca të rregullta dhe trajtim të mirëfilltë të projektligjeve detyrues kryesore e cilit është Kuvendi i Republikës së Kosovës", tha Kusari-Lila. Lista Serbe edhe pse pjesë e koalicionit qeverisës, deri tani nuk i ka dhënë mbështetje ratifikimit të Marrëveshjes së demarkacionit. Ndërkaq, me një pozicion të qartë

kundër kësaj marrëveshje vazhdojnë të jenë deputetët nga Lëvizja Vetëvendosje. Albulena Haxhiu, nga Lëvizja Vetëvendosje tha se kurdo që thirret vazhdimi i seancës, deputetët e kësaj lëvizje do votojnë kundër Demarkacionit. "Ka shpifje propaganda në këtë drejtim. Por, asnjë deputet i Lëvizjes Vetëvendosje nuk e përkrah një marrëveshje që falë territor. Nuk mund të jesh deputet i Vetëvendosjes që çon dorën lart për një marrëveshje që falë territor", u shpreh Haxhiu. Ndryshe, ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Greg Delawie, të hënën ka thënë se ratifikimi i Marrëveshjes së Demarkacionit të kufirit të Kosovës me Malin e Zi është më afër se kurrë. Për ratifikimin e Marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi, nevojiten së paku 80 vota të deputetëve nga 120 sa ka Kuvendi i Kosovës. Komisioni Evropian e ka bërë të qartë se pa ratifikimin e Demarkacionit, Kosova nuk do të mund të përfshihet në zonën e lëvizjes së lirë, brenda BE-së, pa viza.



Për tre vjet EULEX-i hoqi dorë prej 20 proceseve gjyqësore

Njëzet procese gjyqësore i ka dorëzuar Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) te gjyqtarët vendorë në Gjykatën Themelore të Prishtinës, gjatë tre vjetëve të fundit. Në mesin e tyre janë edhe të akuzuar të profilit të lartë, si Sami Lushtaku, Ukë Rugova, Azem Sylja dhe Enver Sekiraça, shkruan sot Koha Ditore. Disa lëndë EULEX-i i ka dorëzuar, edhe pse kanë qenë thuhet në fund të gjykimit, siç është rasti ndaj ish-kryetarit të Skënderajt, Sami Lushtaku, kurse disa të tjera në momentin që ato janë kthyer nga Gjykata e Apelit në rigjykim. Të vetmen arsye që zyrtarët e këtij misioni e kanë dhënë për "Kohën Ditore" rreth transferimit të këtyre lëndëve te vendorët është se "janë në proces të dorëzimit të lëndëve që nga viti 2014". Ata, po ashtu, kanë paralajmëruar se po përgatiten për t'u larguar nga Kosova në qershor të këtij viti. Për Gjykatën në Prishtinë, transferimi i këtyre lëndëve është ngarkesë.

Zgjidhje politike për "Trepçën"

Qeveria nuk po arrin ta zbatojë Ligjin për "Trepçën", të miratuar në tetor të 2016-s. Në konkursin për anëtarë të Bordit Mbikëqyrës të kësaj ndërmarrjeje të hapur para tre muajve, sipas zyrtarëve qeveritarë, nga 100 aplikantë asnjë prej tyre nuk i përket komunitetit serb, shkruan Koha Ditore. E me Ligjin për "Trepçën" Qeveria synon që t'i përfshijë nën menaxhimin e një bordi dy pjesët e kësaj ndërmarrjeje, pra edhe atë që menaxhohet nga serbët në veri të vendit. Formalisht "Trepça" si e tërë ndodhet në menaxhim të AKP-së, ani se përmes ligjit, tri asetet thelbësore të kësaj ndërmarrjeje kanë marrë statusin e shoqërisë aksionare. Ligji e bën Qeverinë aksionaren kryesore të Minierave me Flotacion Trepça - Stantërg, Minierave me Flotacion Kishnicë dhe Artanë si dhe Minierave me Flotacion Kopaonik - Leposaviq. Ekzekutivi i mban 80 për qind të këtyre aksioneve, kurse pjesa tjetër u takon punëtorëve.

Kosova në udhëkryq, 25 milionë euro për marrjen e vizës Shengen

Nga viti 2010 deri në vitin 2016 qytetarët e Kosovës kanë shpenzuar mbi 25 milionë euro vetëm për aplikim për marrjen e vizës Shengen, pa llogaritur edhe shpenzimet tjera që u kërkojnë për plotësuar dosjen për aplikim. Gjatë kësaj kohe janë dorëzuar mbi 507 mijë aplikacione, ndërsa rreth 97 mijë janë refuzuar, shkruan gazeta "Zëri". Por, këtu nuk janë llogaritur shpenzimet tjera që kanë të bëjnë me plotësimin e dokumentacionit për viza, të cilat janë; shpenzimet

për fotografi, sigurimi shëndetësor, shërbimet e përkthimit, shpenzimet bankare e ato të rrugës. Paga për aplikim për vizë Shengen dallon varësisht nga ambasada. Më e lira është 35 euro, ndërsa taksat më të larta shkojnë në 60 ose në 65 euro. Sipas statistikave të Komisionit Evropian dhe të Eurostat-it, gjatë viteve 2010-2016 kosovarët kanë pasur mbi 507 mijë aplikime për viza Shengen, të cilat sipas një përlogaritjeje me pagesën mesatare u kanë kushtuar mbi 25 mi-



lionë euro. Dhe le të përmendim dhe faktin, se 97 mijë prej apliki-

meve gjatë këtyre shtatë vjetëve janë refuzuar.

Në çelje të kongresit të përvitshëm popullor në Kinë, kryeministri Li Keqiang bëri të ditur se do ta rrisë dukshëm buxhetin për ushtrinë. "Gatishmëria për një luftë" do të përmirësohet

Rivaliteti midis Kinës dhe SHBA po shtohet dhe Republika Popullore grindet me fqinjët e saj për pretendime territoriale. Në këtë sfond, kryeministri Li Keqiang bëri të ditur se vendi i tij do t'i rrisë shpenzimet ushtarake me 8.1 për qind.

Në këtë mënyrë, buxheti i mbrojtjes së Kinës do të rritet më shpejt se ekonomia kineze. Ekonomia e dytë në botë për nga madhësia, këtë vit do të rritet pak më ngadalë, me "rreth 6.5 për qind". Përballë "ndryshimeve të mëdha në ambientin e sigurisë nacionale" forcat e armatosura duhet të fuqizohen, tha Li në raportin e tij të llogaridhënies në hapje të mbledhjes vjetore të Kongresit Popullor në Pekin.

"Stërvitja ushtarake dhe gatishmëria për një luftë" duhet të përmirësohen, tha kryeministri para rreth 3000 delegatëve në Sallën e Madhe të popullit. Rritja e buxhetit zyrtar ushtarak me 8.1 për qind në 1,1 bilionë Yuan (afërsisht 128 miliardë euro) është më e lartë se vitin e kaluar kur ishte



7.6 për qind. Ekspertët vlerësojnë se shpenzimet e vërteta janë 25 për qind ose 50 për qind më të larta.

SHBA e vështrojnë Kinën krahas Rusisë si sfidën e tyre më të madhe ushtarake - jo më terrorizmin si deri tani. Strategjia e re e mbrojtjes të SHBA e janarit Kina e përshkruan Kinën si konkurrente strategjike, e cila u bie në qafë vendeve fqinje me "politikën e saj ekonomike grabitqare". Vatra kon-

flikti janë pretendimet e Kinës në Detin e Kinës Jugore dhe Lindore dhe kërcënimet e Kinës ndaj Tajvanit demokratik, të cilin Pekini e vështron si provincë të pabindur. "Ne nuk do të durojmë kurrë intriga separatiste ose aktivitete për një 'pavarësi të Tajvanit'", tha Li. Në qendër të mbledhjes së sivjetme, e cila do të zgjasë në mënyrë të pazakontë shumë, 16 ditë dhe e cila do të përfundojë në 20 mars, do të jenë ndryshime të kushte-

tutës së vendit. Ato do t'i mundësojnë Presidentit Xi Jinping një kohë të pakufizuar në post. Kufizimi i tanishëm në dy herë nga pesë vjet do të eliminohet me një votë në 11 mars. Kritikët paralajmërojnë për rreziqet e një pushteti të pakufizuar për Xi Jinpingun, gjë që do të çonte në një sjellje më të sigurt në vete në politikën e jashtme.

Do të krijohet edhe një komision i ri kontrolli shtetëror. Me këtë organ me pushtet të gjerë, do të zgjerohet lufta kundër korrupsionit, shkeljeve në shërbim dhe mungesës së besnikërisë nga komisioni disiplinor prej anëtarëve të partisë të të gjithë nëpunësit shtetërorë. Askush nuk dyshon se Parlamenti i Kinës që nuk zgjidhet me zgjedhje të lira nuk do t'i miratojë planet. Parlamenti nuk ka refuzuar asnjëherë deri tani ndonjë projektligj.

175 MILIARDË DOLLARË PËR ARMATIMIN

Kina ka përcaktuar një prej buxheteve më të mëdha për ushtrinë për vitin e ardhshëm, që arrin 175 miliardë dollarë. Shifra, një rritje prej 8% në krahasim me vitin e kaluar, u njoftua nga kryeministri Li Keqiang ndërsa nisi takimi vjetor i Parlamentit në Pekin. Li gjithashtu caktoi një objektiv të rritjes prej 6.5% për ekonominë. Kongresi Kombëtar i Popullit pritet gjithashtu të heqë kufirin dy-vjeçar presidencial, duke i mundësuar Xi Jinping të mbetet në detyrë për një kohë të pacaktuar.

Rreth gjysmë milionë amerikanë pa energji elektrike

Rreth 440.000 amvisëri dhe ndërmarrje nga Virxhinia deri në Masachusets ende janë pa energji elektrike pas stuhisë së fortë e cila javën e kaluar e kaploi Bregdetin Lindor në SHBA. Në shtetin

Nju - Jork pa ujë janë 123.000 konsumatorë, në Pensilvani 114.000 dhe 72.000 në Nju-Xhersi. Rrymë nuk kanë edhe rreth 70.000 konsumatorë në pjesën jugore të Anglisë së Re. Ekipet e

elektrodistributimit punojnë pa ndërprerje me qëllim që në zonat e prekura përsëri të vendoset furnizim me energji elektrike. Mediat amerikane përkujtojnë se gjatë sulmit më të fortë të

stuhisë pa rrymë kanë mbetur më shumë e dy milionë amvisëri dhe firma. Në këtë rajon nga nesër pritet sërish mot i keq me stuhi dhe edhe me më shumë reshje të borës.

BITCOIN, skema piramidale e kohëve moderne

"Mendoj se është një skemë piramidale. Nuk ka kuptim. Jam kaq i befashuar që njerëzit po i besojnë kaq shumë", tha Kovacevich



Është shëndërruar tashmë në një tendencë fitimprurëse por disa sipërmarrës dhe drejtues të kompanive të mëdha financiare kanë nisur t'i bien kambanave të alarmit duke paralajmëruar se bëhet fjalë për një skemë piramidale. Kundër

monedhës virtuale - bitcoin, ka dalë së fundmi edhe "Wells Fargo" - CEO i prestigjiozes financiare me qendër në San Francisco, Richard Kovacevich, i cili pohoi për rrjetin CNBC se bitcoin me shumë mundësi do të rezultojë një mashtrim. "Mendoj se

është një skemë piramidale. Nuk ka kuptim. Jam kaq i befashuar që njerëzit po i besojnë kaq shumë", tha ai në programin televiziv "Squawk on the Street". Kovacevich i bashkohet një liste të gjatë me bankierë dhe sipërmarrës që kanë

denoncuar maninë globale ndaj kriptomonedhës. Jamie Dimon, kryetar i J.P Morgan pati deklaruar në shtator të vitit të kaluar se bitcoin ishte një skemë pashtimi që do të fusë në kolaps të gjithë ekonominë botërore. Frikës së një goditje të mundshme në tregjet financiare i druhet edhe ministri i financave e Koresë së Jugut, një nga vendet ku kryhen edhe transaksionet më të mëdha të monedhës digitale.

Apelitet publ kundër investimeve në Bitcoin i ka bërë edhe sipërmarrësi i njohur kosovar Behgjet Pacolli. Valuta virtuale, sipas tij, në momentin që del prej këtij sistemi, dhe fillon të merret paraja e gatshme që është investuar, aty piramida

fillon të bjerë. Po ashtu, edhe investitori legjendar Warren Buffet në vitin 2014 u citua të thoshte "qëndro larg prej saj". "Ideja që Bitcoin ka një vlerë të madhe, sipas mendimit tim është vetëm një shaka", pati thënë Buffet. Bitcoin bëri një hap drejt pranueshmërisë më të gjerë pas debutimit të tij në bursën e "Cboe Global Markets Inc.". Shqetësimi kryesor për ekspertët e ekonomisë është mungesa e një rregullatori për Bitcoinin. Ndërsa teknologjia vazhdon të përshejtohet, entet rregullatore nuk po kuptojnë ende se çfarë po ndodh me inovacionin. Është kjo arsyeja përse ekspertët financiarë nuk rekomandojnë investimin në Bitcoin.



Edhe një skandal i madh në Vatikan

Një dosje prej 1200 faqesh është paraqitur në Vatikan nga Kryepeshkopata e Napolit, ku ka të bëjë me biseda dhe foto të priftërinjve "gay". Në skandalin e fundit, 34 priftërinj dhe gjashtë seminaristë u identifikuan si homoseksualë. Në dosje përfshihen biseda nga Grindr, Telegram, Facebook dhe WhatsApp, ndërsa Francesco Mangiacapra, i cili paraqiti provat, tha se ishte anëtar i Kishës Katolike. Ai është shprehur se dosja nuk është për të dëmtuar emrat që përmenden në atë dosje por, për t'u shpjeguar atyre se jeta e tyre e dyfishitë nuk është e dobishme as për ata as për viktimat. Sipas Mangiacapra, asnjë prej priftërinjve të larguar nuk dyshohet për pedofili ose ndonjë vepër seksuale. Jo krime, por mëkate. Mangiacapra, i cili ka punuar si avokat para se të bëhej një "Zhiglllo" i vetëshpallur, paraqiti listën me emrat dhe provat shoqëruese. Kreu i kryepeshkopatës, Kardinali Crescenzo Sepe, tha: "Mbetet e rënduar çështja për të cilën ata që kanë gabuar duhet të paguajnë çmimin, dhe të pendohen për dëmin e bërë. "Priftërinjtë që përmendeshin, shtoi ai, u përkasin famullive të ndryshme dhe asnjëri prej tyre nuk është nga Napoli. Mediat italiane, të cilat kanë paraqitur dosjen inkriminuese, përmendën fragmente të bisedave pa i zbuluar emrat e atyre që ishin përfshirë. "Nëse të pëlqen do të doja të të kisha për gjithë ditën si skllav timin, i lidhur dhe duke mu bindur mua", shkruhej në një nga sms-të. Në ditët në vazhdim priten zhvillime të tjera.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIE E EKONOMISË

Në bazë të pjesës II, sfera V, masa 1 – “Klastere për inovacione dhe biznese të orientuara ndërkombëtare” nga Programi për konkurrencë, inovacione dhe sipërmarrësi për vitin 2018 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/2018), Ministria e ekonomisë

Publikon
THIRRJE PUBLIKE

Për mbështetje dhe zhvillim të klaster shoqërimin në Republikën e Maqedonisë për vitin 2018

Lëndë e Thirrjes publike është ndarja e mjeteve financiare nga ana e Ministrisë së ekonomisë për financim të klaster shoqërimin, në pajtim me Programin për konkurrencë, inovacione dhe sipërmarrësi për vitin 2018, pjesa II, sfera V, masa 1 - “Klastere për inovacione dhe biznese të orientuara ndërkombëtare” (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/2018), në shumë prej **5.000.000,00** denarë.

II

Në Thirrjen publike mund të paraqiten të gjitha bashkësitë klaster të regjistruara (odat ekonomike, organizatat e punëdhënësve, organizatat joqeveritare dhe fondacionet e organizuara sipas parimit të klasteringut). Ministria e ekonomisë do të financojë projektet e bashkësive klaster të cilat përfshijnë aktivitetet në lidhje me përpilimin e projekteve të orientuara ndaj:

- Zhvillimit të shërbimeve të përbashkëta të klasterëve,
- Furnizimit të pajisjes specifike e cila do të përdoret nga anëtarët e klasterëve,
- Bashkëpunim të klasterëve me universitetet,
- Zhvillim të prodhimeve të brenduara në kuadër të klaserit (prejardhja gjeografike),
- Përilim dhe realizim të projekteve të përbashkëta inovative që kanë të bëjnë me zhvillim prodhimeve të reja ose të përmirësuara, proceseve ose shërbimeve,
- Përsosmëri të klasterëve dhe anëtarëve të tyre përmes organizimit të trajnimeve të specializuara, punëtorive, seminareve për nxitje dhe shkëmbim të njohurive,
- Aktivitete promovuese për klasteret (pjesëmarrje të përbashkëta në panaire).

III

Kërkesa për ndarje të mjeteve duhet të parashtrohet në formular të caktuar me dokumentacion të bashkëngjitur, përmes postës ose drejtpërdrejtë në arkivin e Ministrisë së ekonomisë. Të bashkëngjitur me kërkesën, shfrytëzuesi i mjeteve duhet të parashtrorë dokumentacionin në vijim:

1. Formular të plotësuar – Kërkesë (Klasterë 2018),
2. Vendim për regjistrim ose gjendja aktuale nga Regjistri qendror (origjinal ose kopje të me vullë dhe nënshkrim të parashtruesit, jo më të vjetër se gjashtë muaj),
3. Plan dhe program për shfrytëzim të mjeteve (projekt),
4. Deklaratë për ndihmë të ndarë shtetërore të klaserit,
5. Fletëpagesa prej - 50,00 dhe 250,00 denarë për taksë administrative.

IV

Projektet do të vlerësohen dhe radhiten në pajtim me kriteret në vijim:

Kriteret	Pikët
1. KRITERET THEMELORE	
1.1. Përshkrim i shkurtër i përgjithshëm për veprimtarinë e klaserit dhe projektet e realizuara më herët të bashkësisë klaster (dëshmi: listë referente)	5
1.2. Kapaciteti i ekipit i përfshirë në realizimin e projektit (dëshmi: CV, listë referente)	5
Gjithsej pikë:	10
2. RELEVANCA E PROJEKTTIT	
2.1. Projekti ka aktivitetet të mbështetjes dhe zhvillimit të përgjithshëm afarist të shërbimeve të përbashkëta ose prodhimeve të cilat intensifikojnë bashkëpunim mes	

aktorëve të ndryshëm (shtojcë: dëshmi):	10
- Hulumtime,	10
- Edukim,	10
- Inovacione,	10
- Internacionalizim.	
Gjithsej pikë:	40
3. REALIZIMI I PROJEKTTIT	
3.1. Realizimi i projektit dhe rrjetëzimi i shoqatave klaster realizohet në bashkëpunim me:	
- Anëtarët në bashkësinë klasterë,	10
- Bashkësitë klasterë mes vete,	10
- Me universitetet dhe me institucionet shkencore, (dëshmi shtesë)	10
Gjithsej pikë:	30
4. REZULTATET E PRITSHME	
4.1. Dobitë dhe efektet nga realizimi i projektit (nxitje të inovacioneve dhe transferim të teknologjive në drejtim të ekonomisë dhe mes kompanive, pushtim të tregjeve të reja, përforcim të njohurive dhe aftësive për zhvillim të klasterëve, rritje të konkurrencës së ekonomisë së Maqedonisë etj)	20
GJITHSEJ	100

V

Për aktivitetet nga masa 1 nga pjesa II, sfera V. Mbështetje dhe zhvillim të bashkësisë klasterë, pjesa e shpenzimeve për këtë qëllim i mbulon Ministria e ekonomisë në shumë prej 75% të projektit, por jo më shumë se **1.000.000,00** denarë veç e veç për secilin kërkuar për aplikacion. Bashkësitë klasterë mund të parashtrorë vetëm një kërkesë nga aktivitetet e theksuara nga pjesa II, sfera V. Mbështetje dhe zhvillim bashkësisë klasterë, masa 1 – “Klasteret për inovacione dhe biznese të orientuara ndërkombëtare”.

VI

Fletëparaqitjet për ndarjen e mjeteve shqyrtohen në Ministrinë e ekonomisë, ndërsa vendimin për ndarjen e mjeteve e sjellë Ministri, pas çka vijon nënshkrim i Marrëveshjes me shfrytëzuesin e mjeteve.

Shfrytëzuesi i mjeteve të ndara të pakthyeshme, obligohet të parashtrorë dëshmi për shfrytëzim me qëllim të mjeteve. Ministria e ekonomisë e mban të drejtën për përcjellje të realizimit të projekteve, si dhe kontrollin e shpenzimit të qëllimshëm të mjeteve.

Fletëparaqitjet për ndarje të mjeteve parashtrohen deri më **18.04.2018**.

VII

Formularin Kërkesë Klaster -2018 për paraqitje në Thirrjen publike dhe Deklaratën për ndihmë të ndarë shtetërore të klaserit, parashtruesit mund t'i marrin në Ministrinë e ekonomisë, rr. “Jurij Gagarin” nr. 15 – Shkup, ose në ueb faqen e Ministrisë: www.economy.gov.mk. dhe www.konkurentnost.mk.

VIII

Shpenzimet e dedikuara për realizim të masës 1 të pjesës II të sferës V Mbështetje dhe zhvillim të bashkësisë klasterë, do t'u paguhen bashkësive klasterë varësisht nga mjetet e disponueshme në Buxhet.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E EKONOMISË

Në bazë të Programit për konkurrencë, inovacione dhe sipërmarrësi për vitin 2018, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/2018), pjesa II, sfera B, Implementimi i politikës industriale, masa 1, pika 1.1 nga Ministria e ekonomisë publikohet:

THIRRJE PUBLIKE

Për mbështetje për rritje të konkurrencës të subjekteve afariste nga industria përpunuese – zhvillim të subjektit afarist, zhvillim të prodhimit dhe zhvillim të tregut

1. Lëndë e Thirrjes publike është kompensimi i një pjese të shpenzimeve të subjekteve afariste për zhvillim të subjektit afarist, zhvillim të prodhimit dhe zhvillim të tregut për çka janë paraparë gjithsej 2.500.000,00 denarë për aktivitetet në vijim:

1. Përpilim të dokumentacionit teknik për prodhim të ri gjegjësisht për përmirësim të prodhimit ekzistues dhe/ose përpunim të dizajnit industrial/ridizajnim të prodhimit;
2. Përpilim të zgjidhjes ideore dhe/ose shtypje të: ambalazhit të ri, etiketit, logos së prodhimit dhe materialit të botuar promovues;
3. Përpilim të studimeve për hulumtim të tregut dhe/ose marketing strategjisë dhe/ose aktivitetet për zhvillim të brendit;
4. Përpilim të projekteve për efikasitet energjetik dhe/ose vënie të standardeve për menaxhim energjetik ISO 50001;
5. Furnizim të softuerit specifik me rëndësi për avancim të aktivitetet afariste të sipërmarrjes;
6. Bashkëfinancim të një pjese të shpenzimeve për sigurim të certifikatës për konformitet të prodhimit;
7. Përpilim të dokumentacionit teknik-projektues ose studim për fizibilitet teknik për: projekte të planifikuara investuese, përgatitje të sipërmarrjes për rritje të efikasitetit energjetik, vendosje të sistemit të brendshëm për menaxhim me mbeturinat dhe sistemin për mbrojtje të ambientit jetësor.

Ministria e ekonomisë kompenson pjesën e shpenzimeve në shumë prej 75% të shpenzimeve të dëshmuara të kërkuarit, por jo më shumë se 180.000,00 denarë veç e veç për secilin kërkuar.

2. Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë subjektet afariste për kryerje të veprimtarive prodhuese në kuadër të sektorit Industria përpunuese, në pajtim me Klasifikimin nacional të veprimtarive rev 2 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 147/2008 dhe 4/2013), me veprimtari kryesore/shifra kryesore e të ardhurave në sektorin Industria përpunuese, pavarësisht madhësisë së subjektit afarist.

Një kërkuar mund të parashtrorë fletëparaqitje dhe kërkesë vetëm për një aktivitet.

Shfrytëzuesi i subvencionit nuk mund të jetë subjekti afarist i cili ka fituar ndihmë shtetërore për aktivitetin e njëjtë në 2 vitet paraprake.

Kërkesa për aplikim, formulari për deklarata për ndihmë shtetërore, deklarata dhe udhëzimi për përpilimin e raportit për projektin e realizuar me indikatorë për sukses janë të mundshme në ueb faqen e Ministrisë së ekonomisë www.economy.gov.mk dhe www.konkurentnost.mk ose mund të merren nga arkivi i Ministrisë së ekonomisë. (formularët 1 dhe 1.1 PKIP 2018 B. IP, Formulari “DEKLARATA - 2018” dhe Udhëzimi).

3. Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formulari 1 PKIP 2018 B. IP “Kërkesë për aplikim për kompensim të një pjese të shpenzimeve për zhvillim të subjektit afarist, zhvillim të prodhimit dhe zhvillim të tregut)
- Gjendja aktuale e subjektit afarist të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më të vjetër se 3 muaj;
- Informacion për gjendjen ekonomiko-financiare të subjektit afarist të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më të vjetër se 3 muaj, prej ku shihet se subjekti afarist ka interpretim pozitiv në pjesën e shenjave për vlerësim për shoqërimin;
- Certifikatë për tatime dhe kontribute tjera të paguara nga Drejtoria për të hyra publike të Republikës së Maqedonisë, jo më të vjetër se 3 (tre) muaj;
- Marrëveshje mes subjektit afarist dhe përpiluesit, të lidhur gjatë vitit 2017 dhe vitit 2018;
- Faturë nga përpiluesi të lëshuar në qarkullim gjatë vitit 2017 dhe vitit 2018;
- Certifikatë nga banka deponent në të cilën shihet se subjekti afarist tërësisht ka kryer obligimet ndaj përpiluesit, në pajtim me Marrëveshjen ;
- Deklaratë për projektin e realizuar me indikatorë për sukses (të përpiluar në pajtim me udhëzimin);
- Deklaratë për ndihmën e ndarë shtetërore (Formulari 1.1 PKIP 2018 B. IP);
- Deklaratë (Formulari “DEKLARATA-2018”) të vërtetuar në noter dhe
- Fletëpagesa për taksë administrative në shumë prej 50,00 dhe 250,00 denarë.

4. Parashtrim të dokumenteve

Kërkesa për aplikim, deklarata për ndarje të ndihmës shtetërore dhe raportit për projektin e realizuar duhet të jenë të nënshkruara nga personi i autorizuar i subjektit afarist dhe të vërtetuara me vullë.

Deklarata (Formulari “DEKLARATA-2018”) duhet të jetë e nënshkruar nga personi i autorizuar i subjektit afarist, të vërtetuar me vullë dhe të vërtetuar në noter.

Dokumentacioni tjetër parashtrorë në origjinal ose kopje. Nëse dokumentacioni parashtrorë si kopje, besueshmërinë e secilës faqe e vërteton me nënshkrim personi i autorizuar i subjektit afarist dhe e vërteton me vullë. Dokumentacioni në gjuhën e huaj parashtrorë si kopje dhe përkthim të vërtetuar nga përkthyes i autorizuar gjyqësor.

Aplikantët duhet të parashtrorë kërkesë të kompletuar me të gjitha dokumentet e nevojshme. Nëse kërkesa e parashtruar është e pakompletuar, Komisioni në pajtim me nenin 39, paragrafi 3 i Ligjit mbi procedurën e përgjithshme të rregullt (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 124/2015) do t'i drejtohet aplikantit në afat prej 15 ditëve shtesë të Kërkesës për subvencionim.

5. Kërkesat e parashtruar i shqyrton Komisioni i formuar nga Ministria e ekonomisë. Kërkesat e miratuara do t'u paguhen kërkuarëve varësisht nga mjetet në disponim nga Buxheti, sipas radhës së paraqitjes së tyre në arkivin e Ministrisë së ekonomisë (i pari i ardhur i pari i shërbyer), deri në harxhimin e mjeteve në disponim nga Buxheti për vitin 2018. Me qëllim që të kihet kujdes parimi “i pari i ardhur, i pari i shërbyer”, për Kërkesat me dokumentacion jo të kompletuar, si datë të parashtrimit të Kërkesës do të konsiderohet data e shtesës së fundit të Kërkesës, gjegjësisht data kur Kërkesa për subvencionim do të kompletohet tërësisht.

Ministria e ekonomisë, e mbanë të drejtën që të kërkojë të parashtrorë i tërë projekti i përpiluar, të realizojë monitorim të projektit, të vizitojë kompaninë dhe personalisht të sigurohet në rezultatet e raportit.

6. Afati përfundimtar i parashtrimit të kërkesave: 31 gusht 2018.

Kërkesat duhet të parashtrohen në arkivin e Ministrisë së ekonomisë, rr. “Jurij Gagarin” nr. 15, Shkup



Në bazë të nenit 20-g paragrafi 1 nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2014, 199/2014 dhe 27/2016) dhe neni 22 paragrafi 1 pikal dhe neni 23 nga Ligji për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 149/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015, 167/2015 dhe 27/2016), Ministria e punëve të brendshme, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësimin e 2 personave në Ministrinë e punëve të brendshme me kohë të pacaktuar edhe atë:

- Kamerier – 2 realitues

Kandidatët duhet ti plotësojnë kushtet e përgjithshme në vijim:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
- të jenë të moshës madhore;
- të ketë aftësi shëndetësore të përgjithshme për vendin e punës dhe
- me aktgjykim të plotfuqishëm të mos kenë ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Përkrash kushteve të përgjithshme, kandidatët të cilët do të paraqiten duhet ti plotësojnë **kushtet e posaçme** të vërtetuara me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e punëve të brendshme:

- të kenë të mbaruar arsim të mesëm pa përvojë pune

Kandidatët e interesuar duhet ti dorëzojnë dëshmitë në vijim për plotësimin e kushteve të nevojshme për vendin e punës, në origjinal ose kopje e vërtetuar te noteri:

- diplomë për arsim të mesëm të mbaruar
- certifikatë të lindjes,
- biografi të shkurtë dhe letër motivuese dhe
- dëshmi se me aktgjykim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar dënimi për ndalesë të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës ditore dhe javore:

-orari i punës ditore vërtëtohet me fillim të orarit të punës ndërmjet orës 7:30 dhe orës 08:30 dhe përfundimi i orarit të punës së njëjtë ndërmjet orës 15:30 dhe orës 16:30, ndërsa me kohëzgjatje të orarit të punës ditore prej tetë orë. Të drejtën e pushimit të orarit të punës ditore shfrytëzohet nga ora 12:00 deri në ora 12:30, me kohëzgjatje të plotë prej 30 minuta.

-orari i punës javore është 40 orë pune (nga e hëna deri të premten).

Neto rroga bazë për vendet e punës është 16.560,00 denarë.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm është 5 (pesë) ditë pune, duke llogaritur nga dita e ardhshme e botimit të shpalljes (duke mos llogaritur vetë ditën e shpalljes)

Ministria e punëve të brendshme me obligim zyrtar e siguron dokumentin për dëshminë e shtetësisë.

Kandidatët nuk janë të obliguar të dorëzojnë dëshmi për aftësi të përgjithshme shëndetësore, gjegjësisht Ministria e punëve të brendshme gjat lidhjes së kontratës për punësim do të vendosë nëse kandidati do të udhëzohet në barë të Ministrisë, para Komisionit shëndetësor të Ministrisë së punëve të brendshme për arsye të vërtetimit të gjendjes së përgjithshme shëndetësore e nevojshme për vendin e punës.

Procedura për seleksionim dhe zgjedhje të personave të cilët do të themelojnë marrëdhënie pune në Ministrinë e punëve të brendshme në bazë të shpalljes publike do ta zbatojë komisioni i posaçëm i formuar në Ministrinë në afat të përcaktuar me Ligjin për marrëdhënie pune.

Kandidatët e interesuar dokumentacionin e nevojshëm janë të obliguar që t'parashtrijë në arkivin e Ministrisë së punëve të brendshme ose përmes postës në adresën: "Dimçe Mirçev" nr. 9, 1000 Shkup (me shenjë "për shpallje për punësim").

Dokumentacionin e nevojshëm, kandidatët e dorëzojnë çdo ditë pune në afatin e përcaktuar, gjatë orarit të punës (ora 07:30-16:30).

Dokumentacioni jo në kohë dhe i pa kompletuar nuk do të shqyrtohet.

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Në bazë të neneve 125 dhe 131 të Ligjit për Arsimin e Lartë (Gaz. Zyrtare e RM-së nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16, 120/16 dhe 127/16), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të nenit 144 të Statutit të Universitetit të Tetovës, shpallet

KONKURS

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore në Universitetin e Tetovës

Shpallet Konkurs për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës:

FAKULTETI JURIDIK

1. Një mësimdhënës për lëndët:
 - E drejta e mediave
 - Teoritë shoqërore politike bashkëkohore.

Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, të parapara me nenin 125 të Ligjit për Arsimin e Lartë.

*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

Tetovë, 06.03.2018

Universiteti i Tetovës

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për kadastër të patundshmërive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 55/2013, 41/2014, 115/2014, 116/2015, 153/2015, 192/2015, 61/2016 dhe 172/2016) dhe Vendimit për publikim të Shpalljes publike për zgjedhje të zëvendës drejtorit të Agjencisë për kadastër të patundshmërive numër 0202-8114/1 të datës 16.03.2018, Këshilli drejtues i Agjencisë për kadastër të patundshmërive, publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Nr. 02/2018

Për zgjedhje të zëvendës drejtorit të Agjencisë për kadastër të patundshmërive

I. Këshilli drejtues i Agjencisë për kadastër të patundshmërive publikon Shpallje publike për zgjedhje të:

1. Zëvendës drejtorit të Agjencisë për kadastër të patundshmërive.

II. Të drejtë për pjesëmarrje në shpalljen publike ka personi fizik i cili krahas kushteve të përgjithshme përmbush edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për kadastër të patundshmërive edhe atë:

1. Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
2. Në momentin e zgjedhjes me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
3. Ka arritur 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar;
4. Të ketë minimum pesë vjet përvojë pune;
5. të posedojë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë:
 - TOEFL-IBT – së paku 74 pikë,
 - IELTS – së paku 6 pikë,
 - ILEC Cambridge English: legal, së paku niveli B2,
 - FCE Cambridge-English: first – të dhënë,
 - BULATS – së paku 60 pikë;
 - APTIS – së paku niveli B2 dhe
6. të ketë të dhënë test psikologjik dhe test për integritet.

III. Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët patjetër duhet të dorëzojnë dokumentacionin në vijim:

- Biografi të shkurtë;
- Certifikatë të shtetësisë;
- Dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- diplomë për arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar;
- Dëshmi se ka minimum pesë vjet përvojë pune;
- një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë: TOEFL-IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC Cambridge English: legal, së paku niveli B2, FCE Cambridge-English: first – të dhënë, BULATS – së paku 60 pikë; APTIS – së paku niveli B2 dhe
- Dëshmi për test të dhënë psikologjik dhe test për integritet.

IV. Dokumentet nga pika III duhet të dorëzohen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter dhe të njëjtat të dorëzohen në arkivin e Agjencisë për kadastër të patundshmërive ose përmes postës në adresën: Agjencia për kadastër të patundshmërive rr. "Trifun Haxhi Janev" nr. 4, 1000 Shkup me shenjë: "Për shpallje publike për zgjedhje të zëvendës drejtorit të Agjencisë për kadastër të patundshmërive".

Orari i punës është 40 (dyzet) orë në javë, gjegjësisht 8 (tetë) orë në ditë gjatë javës së punës, prej ora 7.30/8.30 deri në ora 15.30/16.30, prej ditës së hënë deri ditën e premte – orar të plotë të punës.

V. Koeficienti i pagesës për drejtor të Agjencisë për kadastër të patundshmërive është 2.3 në pajtim me Vendimin për përcaktimin e koeficienteve për përllogaritje të pagesës të funksionarëve të cilët i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e RSM" nr. 36/90 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2005, 71/2005, 2/2006, 8/2006, 46/2006, 18/2007, 94/2007, 103/2007, 126/2007, 138/2007, 39/2008, 137/2008, 154/2008, 63/2009, 76/2009, 144/2009, 39/2010, 63/2010, 158/2010, 5/2011, 75/2011, 133/2011, 70/2012, 82/2012, 161/2012, 172/2013, 16/2014, 21/2014, 99/2014, 116/2014, 152/2015, 161/2015, 218/2015, 19/2016, 71/2016 dhe 189/2016).

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit.

Zgjedhja e kandidatëve të paraqitur do të realizohet nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES

Nrtist i përmasave kombëtare, Shkodran Tolaj, është bërë emblemë e pashmangshme e vlerave muzikore të ne. Paraqitja e tij asnjëherë nuk ndodhë pa ndonjë shkas dhe ka diçka dramatike në hapat e tij në skenë, tekta në vëmendjen e publikut sjell ndonja fabulë historie, apo ndonjë personalitet me statuspavdekësisë.

Pas këngës së suksesshme të 10 vjetorit të shtetit të Kosovës, që u promovua në vigjilje të 17 shkurtit, duket se artisti Shkodran Tolaj nuk ka të ndalur. Ai gjithnjë e më tepër po vjen në shprehje si vokal dhe artist i fuqishëm, duke u dëshmuar se di të jetë artist i datave dhe përvjetoreve të mëdha. Ka përzgjedhur pikërisht 5 marsin, 20 vjet nga fillimi i luftimeve Në Drenicë dhe sulmi që iu bë familjes së komandantit legjendar Adem Jashari që të sjellë këngën e re premierë, realizuar me videoklip.

Por nga ky artist mbahen mend balada "Njeriu" dedikuar presidentit Rugova, më pas dy këngë të fitores së Kërcovës "Shqipet e Uskanës" dhe "Kërcovari" si dhe kënga dedikuar dhjetë vjetorit të shtetit të Kosovës "Cjaku i Kastriotit" që u publikua në vigjilje të 17 shkurtit. Por, ai nuk u ndal me kaq. Pikërisht më 5 mars në 20 vje-

SHKODRAN TOLAJ, ARTISTI I DRAMAVE TË MËDHA KOMBËTARE



torin e "Epopesë së UÇK-së" ai vjen me një projekt shumë profesional i cili sjell figurën e heroit legjendar Adem Jashari, simbolit të qëndresës dhe krenarisë kombëtare.


Duke dashur që figura e legjendarit të ngritet në pedestal, Tolaj ka vendosur që kënga ti takojë stilit të artit elitor-klasikes, e mbi këtë bazë muzikore edhe teksti i shkruar nga Ilir Shaqiri, orkestrimi nga Damir Imeri. Orkestra e përbërë

nga 50 instrumentistë i kanë dhënë ngjyrat institucionale kësaj vepre.

Një pjesë e xhirimeve të videoklipit janë realizuar në Prekaz, pikërisht në kompleksin memorial "Adem Jashari" ku artisti na paraqitet me uniformën ushtarake të Kosovës dhe dy flamujt, atij të Kosovës dhe Shqipërisë, simbole këto që tregojnë se shqiptarët janë të pandashëm.

Pjesa e dytë e xhirimeve është kryer në Shkup, në studion franceze, pranë TVM-së.

"Heroi i zmerës sime" dedikuar marsit të madh dhe legjendarit Adem Jashari, tashmë një vepër e realizuar enkas nga artisti Shkodran Tolaj, mund ta ndiqni edhe në kanal "Arkiva". Heroi i zemrës sime" dëshmon se Shkodran Tolaj, është artisti i përvjetoreve të mëdha.



Ilir Shaqiri përuron poemën "Adem Jashari"

Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës organizoi të hënën akademinë letrare-artistike "Ora e lirisë për veprimtari tradicionale" në kuadër të Epopesë së UÇK-së. Në kuadër të kësaj akademie, sot është përvjetor edhe poema "Adem Jashari" e Ilir Shaqirit. Kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve Shyqeri Galica ka vlerësuar lart veprën më të re të Ilir Shaqirit "Adem Jashari".

Kjo poemë sipas tij promovohet në 20 vjetorin e rënies së komandantit Adem Jashari dhe përshkruan sakrificën dhe mundin e kësaj familje për lirinë tonë. Gjeneral Kudusi Lame recensent i poemës "Adem Jashari" ka thënë se kjo poemë është e veçantë për shumë arsye. Kjo vepër e madhe sipas tij përshkruan familjen Jashari dhe komandantin Adem Jashari të cilët dolën përballë makinerisë ushtarake serbe për lirinë e Kosovës. Ai tha se autori i poemës ka përdorë një mjeshtri me fjalë të arta. "Poema është një përmendore për komandantin gjithshqiptar Adem Jashari, për UÇK-në dhe mbarë popullin shqiptar", tha Lame. Arben Veselaj recensenti tjetër për poemën "Adem Jashari" ka thënë se kjo poemë bartë shenjat e një kryevepre.

Shqipëria, pjesë e Eurovizionit me instrumentistët e rinj

Shqipëria këtë vit do të marrë pjesë për herë të parë në Eurovision Young Musicians – gara muzikore e Eurovizionit por vetëm për instrumentistë. Shqipëria kësaj ka hapur edhe thirrjen për instrumentistët, për të zgjedhur kështu përfaqësuesin e saj. TVSH fton të gjithë instrumentistët shqiptarë që të aplikojnë për tu bërë pjesë e garës dhe potencialisht përfaqësimi i Shqipërisë në këtë garë. TVSH ka realizuar edhe një videoklip me anë të të cilit fton instrumentistët e rinj. Nga të gjithë konkurruesit, vetëm gjashtë në fund do të mund të kalojnë në finalen shqiptare. Eurovision Young Musicians mbahet në Edinburg, në muajin gusht, përcjellë edhe nga Orkestra Simfonike Skoceze e BBC.



Arabia ndalon transmetimin e serialeve turke

Një rrjet i madh satelitor i Lindjes së Mesme ka ndalur transmetimin e serialeve turke, viktimave më të fundit të argëtimit në politikën e paqëndrueshme të rajonit. Grupi MBC i bazuar në Dubai ndërpreu transmetimin e serialeve të njohura turke në gjuhën arabe më 1 mars, një vendim që erdhi menjëherë pas kryetari, Waleed al-Ibrahim u lirua nga mbajtja e një arrestimi masiv nga autoritetet saudite.

Gazeta kombëtare angleze në Abu Dhabi, së pari njoftoi vendimin e MBC në edicionin e saj të së hënës. Rrjeti nuk pranoi të diskutojë se kush e mori vendimin, por marrëdhëniet midis Arabisë Saudite dhe Presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan janë në një nivel të



ulët, transmeton Telegrafi. Turqia mbështeti Katarin pasi Arabia Saudite dhe tre vende të tjera arabe bënë një bllokadë në Katar. "Ka një vendim për të hequr të gjithë dramën turke nga disa shitore televizive në rajon", tha zëdhënësi i MBC, Mazen Hayek për The Asso-

ciated Press të hënën. "Nuk mund ta konfirmoj se kush e mori vendimin". Hayek nuk pranoi të thoshte nëse vendimi erdhi nga brenda menaxhimit të MBC ose jashtë transmetuesit. Zyrtarët turq nuk bënë asnjë koment të menjëherëshëm mbi vendimin e MBC

Ermonela Jaho në skenën e operas së New Yorkut

Sopranoja Ermonela Jaho po rrëmben duartrokitje në Metropolitan Opera në Nju Jork me rolin Ço Ço Sanit në operan "Madame Butterfly" të Puçinti.

Në datat 8, 13, 16 mars, Madame Butterfly ngjitet sërish në skenën e operës së New Yorkut si produksion i Antoni Mingelës, me regji e koreografi e Karolin Koa. Rolin e Ço Ço Sanit ia kanë besuar sopranos shqiptare Ermonela Jaho, një personazh i brishtë, i ndjeshëm me fund tragjik, të cilën Jaho e ka interpretuar edhe në skenën shqiptare.

Ermonela Jaho është rritur duke shpresuar se një ditë do të këndonte Cio Cio Sanin dhe tanimë që ajo e arriti duket se gjithmonë kur ngjitet në skenë përjeton ëndrrën e saj. Kështu e përshkruan kritika muzikore njujorkese.

"Madame Butterfly" tregon historinë e Butterflait, që beson verbërisht të dashurisë e një oficeri detar, një amerikan cinik i quajtur Pinkerton.

Por, pas martesës, Pinkerton shkon në shtëpi në Amerikë. Kur Butterfly e zbulon që njeriu që ajo



donte është kthyer përsëri me gruan e tij amerikane dhe do të marrë përgjegjësinë e djalit që ajo

lindi pas largimit të tij, ajo i jep fund ëndrrës së saj perëndimore dhe kryen harakiri.

NË TETOVË SHKËNDIJA ZHVILLON NDESHJEN KTHYESE ME VARDARIN

PAS KAMPIONATIT, RADHËN E KA KUPA

Shkëndija të mërkurën pret Vardarin në Tetovë në kërkim të kualifikimit në gjysmëfinale të Kupës së Maqedonisë. Kuqezinjtë me epërsi të bukur në kampionat, tani pretendojnë të nxjerrin kundërshtarin edhe jashtë garës së dytë vendore

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 6 mars - Futbollistët e Shkëndijës pas fitores me Pobodën në kampionat, vëmendjen e kanë rikthyer kah sfida e radhës, ndeshjen kthyesë të çerekfinale të Kupës së Maqedonisë kundër Vardarit, e cila zhvillohet sot (e mërkurë) me fillim në ora 14.00. Katërbëdhjetë pikët epërsi para vendit të dytë në kampionat janë arsye shtesë për atmosferën e shkëlqyeshme në skuadër, ndërsa tani gjithë vëmendja është drejtuar për të materializuar barazimin 1:1 në takimin e parë çerekfinale në Shkup. Cjithë futbollistët tregojnë dëshirë të madhe për punë dhe me përqendrim maksimal kërkojnë të jenë në nivel të detyrës në drejtim të realizimit të objektivit, pa lejuar në performancën e ekipit të ndikojnë "lojërat" anësore të kundërshtarëve. Sulmuesi dhe autori i golit të parë për kuqezinjtë në sfidën ndaj Pobodës, Marjan Radeski thotë se



janë të përqendruar maksimalisht për të dhënë më të mirën që do të sjell rezultatin e duhur. Ai gjithashtu pret mbështetje nga tribuna. "Na pret përballje e rëndësishme në kuadër të Kupës, garë të cilën gjithashtu pretendojmë ta mbyllim me trofe. Por për të vazhduar

më tej na pret detyrë e vështirë përballë një rivali të fortë. Ne jemi duke zhvilluar sezon shumë pozitiv, kemi ngritur performancat në një nivel mbi rivalët dhe tani na duhet vazhdimësi në këtë fazë vendimtare. Në këtë ndeshje nuk kemi hapësirë për gabim, prandaj

jemi të përqendruar maksimalisht për të dhënë më të mirën që do të sjellë rezultatin e duhur. Nuk na defokusojnë gjithë ndodhitë që mundohen rivalët t'i imponojnë përmes mënyrave të ndryshme, pasi ne dimë çka duam dhe jemi të koncentruar qëllimet t'i arrijmë me punë në terren. Pres mbështetje të madhe nga publiku, që në kështu ndeshje ka vlerë të madhe, ndërsa ne në terren do të japim 100 për qind nga mundësitë tona për t'ua kthyer me fitore dhe kualifikim në gjysmëfinale të Kupës", deklaroi për gazetën KOHA, Marjan Radeski.

ME RABOTNIÇKIN TË SHTUNËN

Skuadra e Shkëndijës ndeshjen me Rabotniçkin në kuadër të javës së 23 në Ligën e parë futbollistike të Maqedonisë do ta zhvillojë të shtunën, (10 mars) në stadiumin "Filipi i dytë" në Shkup në ora 14.00. Lajmi është bërë i ditur nga klubi "romantik" në faqen e saj zyrtare. Derisa, ndeshjet e mbetura do të zhvillohen të dielën.

Taulanti ëndërron të luajë sërish bashkë me Granitin

Taulant Xhaka ka treguar se dëshiron që një ditë të ribashkohet me vëllain Granitin duke shtuar se mesfushori i Arsenalit ëndërron që një ditë të kthehet te Bazeli. 26-vjeçari Taulant Xhaka ka luajtur ndaj vëllait të tij më të ri kur "Topçinjtë" u përballën me Bazelin në Ligën e Kampionëve sezonin e shkuar, si dhe ishte përballur edhe me kombëtare ku ai paraqitej për Shqipërinë, ndërsa Graniti për Zvicrën. Duke folur për "Goal", ylli i Bazelit ka thënë se ka ambicie që një ditë të luajë sërish bashkë me vëllain në mesfushë. "E thërras Granitin katër herë në javë. Flasin për gjithçka, jo vetëm për futbollin. Po ashtu sepse është në një fazë të vështirë tek Arsenalit. Shkëmbejmë



këshilla dhe kritikojmë njëri-tjetrin për ta përmirësuar veten. Ai më ndihmon mua dhe unë atij. Jemi lojtarë të ndryshëm. Graniti

është teknikisht më i mirë se unë, por trajnerët i vlerësojnë tjerat. Nuk është e lehtë ta shikoj në TV sepse edhe ne luajmë ato ditë. Kur

kam kohë përpiqem ta shikoj çdo ndeshje të tij", ka thënë Taulanti. Xhaka ish-in bashkë te ekipi i të rinjve në Konkordia para se të kalonin te Bazeli. Tani Taulanti thotë se ëndërron ditën e luajtjes në një skuadër me vëllain e tij. "Nëse jo tek Arsenalit ndoshta te Bazeli kur të kthehet në Zvicër. Është ëndërra ime të luaj sërish me vëllain time. Por ku, nuk është problemi. Besoj se ai dëshiron të kthehet te Baseli në fund të karrierës sepse është rritur këtu dhe Bazeli është ekipi i preferuar i tij. Kurdo që i ka dy ditë të lira, vjen dhe viziton familjen e miqtë. Ka lidhje të fortë", ka thënë Taulant Xhaka. Në këtë intervistë, ai ka thënë se Manchester Siti është skuadra më e fortë aktualisht në Evropë.



Levante njofton se Sadiku ka thyer hundën

Klubi i futbollit Levante ka njoftuar se lojtari i tij, shqiptari Armando Sadiku, ka të thyer hundën pas përplasjes që pati me portierin e Espanjolit, Diego Lopez në ndeshjen e fundjavës, në kuadër të kampionatit spanjoll. "Armando Sadiku pas përplasjes brutale kokë më kokë me portierin Diego Lopez ka thyer hundën. Koha e kthimit të tij do të varet nga faza e rikuperimit", shkruan "eldesmarque.com". Sadiku 26-vjeçar luajti kundër Espanjolit vetëm në 45 minutat e parë. Lëndimin e pësoi në minutën e 39-të. Portieri i Espanjolit, Diego Lopez, pas duelit që pati me sulmuesin e kombëtares shqiptare humbi vetëdijen dhe u dërgua në spital. Sadiku për Levanten është paraqitur në dy ndeshje. U transferua në janarin e këtij viti nga Legia e Varshavës dhe me Levanten ka kontratë deri në qershor të vitit 2020.



Përmbytjet anulojnë ndeshjen Zajazi-Euromilk

Shkup, 6 mars - Ndeshja Zajazi - Euromilk, e vlefshme për javën e parë të sezonit pranveror në Ligën e Dytë Futbollistike të Maqedonisë, e cila duhej të zhvillohet dje, e njëjta nuk u zhvillua. Shkak për anulimin e këtij takimi është përmbytja e stadiumit në Kërçovë. Të reshurat e shiut dhe shkrirja e dëborës skuadrave kërçovare që luajnë në Ligën e Dytë, Zajazi dhe Vëllazërimi po iu shkaktojnë probleme të mëdha. Ndeshja në fjalë Zajazi - Euromilk, do të luhet të martën e ardhshme.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nënpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të Punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rejshe gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 08/2018

për punësimin e 2 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Qeverinë e Republikës së Maqedonisë - Sekretariati i Ligjeve“ për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101V03000 Bashkëpunëtor për 1 realizues(ë)

mbrojtje dhe sigurim, Njësia për mbrojtje dhe sigurim, Sektori për sistem politik dhe resurse njerëzore dhe zhvillim të qëndrueshëm

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalës për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Fakulteti juridik
- së paku 1 (një) vit përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arrijtje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësime strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 22.475,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

2. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor i ri për 1 realizues(ë)

mbrojtje dhe sigurim, Njësia për mbrojtje dhe sigurim, Sektori për sistem politik dhe resurse njerëzore dhe zhvillim të qëndrueshëm

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalës për

kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Fakulteti juridik
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arrijtje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësime strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 20.961,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin

përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Turk(e) 1. Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afat i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësve administrativë.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësve administrativë realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inçizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – teksti i pastruar („Gazeta Zyrtare e RM“ nr. 167/2015), nenit 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve („Gazeta Zyrtare e RM“ nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16 dhe 163/17), nenit 35 paragrafi 2 alineja 2 e Statutit të IPKÇF “Kokicinja” – fshati Tarinci, ndërsa në pajtim me Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës, Drejtori i Institucionit publik komunal – Çerdhja për fëmijë “Kokicinja” – fshati Tarinci, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE nr. 01/2018

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për kohë të pacaktuar të punës

1. Institucioni publik komunal – Çerdhja për fëmijë “Kokicinja” – fshati Tarinci ka nevojë për punësim të:

Nr. rend	Shifra	Titulli i vendit të punës	Nr. i realizuesve
1	DEZ 03/03/V01/001	Edukatore	2
2	DEZ 03/03/G01/001	Përkëdhelës	3
3	DEZ 04/04/A02/001	Gjellëbërës	1
4	DEZ 04/01/A01/004	Mirëmbajtës të higjienës	1

2. Marrëdhënia e punës për të gjitha vendet e punës themelohet për kohë të pacaktuar të punës.

3. Marrëdhënia e punës për të gjitha vendet e punës themelohet për orar të plotë të punës (40 orë në javë), ndërsa gjatë ditës së punës do të zgjasë 8 orë, për vendin e punës me numër rendor:

- 1 me fillim prej ora 08.30 deri në ora 16.30,
- 2 me fillim prej ora 06.30 deri në ora 14.30,
- 3 me fillim prej ora 06.30 deri në ora 14.30,
- 4 me fillim prej ora 06.00 deri në ora 14.00.

4. Secili kandidat duhet të përmbushë kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik
- Të jetë i moshës së rritur
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtjeje ndalës për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, dhe
- Të mos i jetë shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilin dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese.

5. Kandidatët të cilët do të paraqiten për vendin e punës me numër rendor 1, 2, 3, 4 dhe 5 duhet të përmbushin kushtet e posaçme të përcaktuara në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IPKÇF “Kokicinja” – fshati Tarinci, gjegjësisht:

- Për vendin e punës me numër rendor 1: për nivelin VI edukator i fëmijëve të moshës mbi dy vjeçare deri në moshën gjashtë vjeçare, gjegjësisht deri në nisje në shkollë fillore profesor i diplomuar i edukimit parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijëve të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor – me 240 kredi të arritura sipas SETK ose arsim të mbaruar sipëror shkalla VII/1 ose arsim të lartë përkatës të mbaruar për edukator dhe licencë valide për edukator, me ose pa përvojë pune në profesion;
- Për vendin e punës me numër rendor 2: për nivelin G1 përkëdhelës të nivelit të parë arsim të mesëm të mbaruar katërvjeçar dhe licencë valide për përkëdhelës, me ose pa përvojë pune në profesion;
- Për vendin e punës me numër rendor 3: Gjellëbërës – Person në kuzhinë nivel II të kenë të mbaruar arsimin e mesëm trevjeçar ose katërvjeçar të hotelerisë – gjellëbërës, me ose pa përvojë pune në profesion;
- Për vendin e punës me numër rendor 4: Mirëmbajtës të higjienës – Mirëmbajtje të pajisjes nivel I, të kenë të mbaruar arsimin fillor, me ose pa përvojë pune në profesion.

6. Neto pagesa fillestare për orar të plotë të punës për vendin e punës me numër rendor:

- 1 është: 19.240,00 denarë për arsim sipëror dhe 18.420,00 denarë për arsim të lartë,
- 2 është: 14.700,00 denarë,
- 3 është: 13.650,00 denarë për arsim të mesëm katërvjeçar dhe 12.860,00 denarë për arsim të mesëm trevjeçar,
- 4 është: 11.950,00 denarë.

7. Kandidatët për punësim paraqiten në shpalljen publike përmes parashtimit dhe nënshkrimit me dorë të fletëparaqitjes. Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtojnë:

- Për të gjitha vendet e punës:
- Biografik të shkurtë,
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë (original ose kopje të vërtetuar në noter),
- Dëshmi për përdorim aktiv të gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik,
- Kopje të letënjohimit,
- Certifikatë të mjekut,
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënimi për ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (original ose kopje të vërtetuar në noter), të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë,
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilin dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese,
- Dëshmi për arsimin e mbaruar (diplomë original ose kopje të vërtetuar në noter),
- Për vendin e punës me numër rendor 1 licencë valide për edukator,
- Për vendin e punës me numër rendor 2, licencë valide për përkëdhelës,

8. Fletëparaqitjet së bashku me shtojcat të parashtrohen personalisht në IPKÇF “Kokicinja” – fshati Tarinci ose përmes postës në adresën IPKÇF “Kokicinja” – fshati Tarinci nr. 256, 2207 Kurbinci.

Shpallja është e hapur 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit.

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit, jo të plota dhe të parregulluara nuk do të jenë lëndë shqyrtimi nga ana e komisionit për realizim të procedurës për punësim.

9. Procedura për përzgjedhje të kandidatëve të paraqitur përbëhet me kontrollimin e fletëparaqitjeve dhe besueshmërisë së të dhënave dhe dëshmi të parashtuara të bashkëngjitura me fletëparaqitjen. Mendimin dori të drejtori, për zgjedhjen e kandidatëve nga kjo shpallje do të japë Komisioni për përzgjedhje, ndërsa vendimin përfundimtar për zgjedhje do ta sjellë drejtori i IPKÇF “Kokicinja” – fshati Tarinci brenda afatit të caktuar me ligj.

Numër 04 - 11/2
06.03.2018
Kurbinci

IPKÇF “Kokicinja” – fshati Tarinci
Drejtor
Marina Stojanova



Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor
dhe Planifikimit Hapësinor



MKC EN ISO 9001:2009

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë

SHPALL

Kërkesë për dhënie e Lejes për lëshimin e ujërave të zeza nga miniera për mermer të bardhë “Sivec” në një kanal uji dhe si marrësi i fundit i lumit Prasad.

Sipas nenit 30 paragrafi 1 të Ligjit për Ujërat (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15 dhe 52/16), në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është paraqitur kërkesë për dhënie e lejes për lëshimin e ujërave të zeza nga miniera për mermer të bardhë “Sivec” në një kanal uji dhe si marrësi i fundit i lumit Prasad me vendndodhjen e pikës në dalje të PK nr. 2777 dhe PK 2779 KK Prasad, vendbanimi i Prilepit.

Parashtuesi i kërkesës:
Mermeren Kombinat SHA Prilep

Koordinatat e vendndodhjes së pikave të lëshimit në kanal in e ujit sipas sistemit shtetëror koordinativ janë me koordinatat e mëposhtme:
Y=7550788.944; X=4584653.127

Informacione ë lidhje me kërkesën, publiku i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në e-mail d.naumoska@moep.gov.mk Publiku i interesuar në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të kërkesës, ka të drejtë të paraqesë mendime dhe komente me shkrim në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në bulevardin “Goce Dellçev” nr. 18, ndërtesa e RTM (kati 10), 1000 Shkup.

Në bazë të nenit 20 të Rregullores për licenca për kryerje të veprimtarisë energjetike (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 143/11, 78/13, 33/15 dhe 207/16) Shoqëria për tregti dhe shërbime EKS FIS MAKEDONIA SHPKNP Petrovec, me seli në Aeroportin Aleksandri i Madh, ndërtesa e re administrative, zyra 222 Petrovec, në vijim publikon

LAJMËRIM

Informohet opinioni se Shoqëria për tregti dhe shërbime EKS FIS MAKEDONIA SHPKNP Petrovec më datë 27.10.2017 ka parashtuar Kërkesë deri të Komisioni rregullator për energjetikë të Republikës së Maqedonisë për dhënie të Licencës për kryerje të veprimtarisë energjetike: Ruajtje të lëndëve të para të naftës, derivateve të naftës, bioderivateve dhe derivateve për transport – ruajtje të derivateve për motorë të avionëve GM-1 (JET A-1), të regjistruar në numrin arkivues UP1 nr. 11-182/17.

Emri, gjegjësisht titulli i kërkuar:

Shoqëria për tregti dhe shërbime EKS FIS MAKEDONIA SHPKNP Petrovec, me seli në Aeroportin Aleksandri i Madh, ndërtesa e re administrative, zyra 222 Petrovec

Lloji i veprimtarisë energjetike:

Ruajtje të lëndëve të para të naftës, derivateve të naftës, bioderivateve dhe derivateve për transport – ruajtje të derivateve për motorë të avionëve GM-1 (JET A-1)

Rajoni ku do të realizohet veprimtaria:

Veprimtaria Ruajtje të lëndëve të para të naftës, derivateve të naftës, bioderivateve dhe derivateve për transport – ruajtje të derivateve për motorë të avionëve GM-1 (JET A-1) do të realizohet në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Përshkrimi i mënyrës, objekteve dhe mjeteve për kryerje të veprimtarisë:

Pranimi dhe dërgimi i derivateve të naftës derivate për motorë të avionëve GM-1 (JET A-1) do të realizohet përmes 1 (një) rezervuari vertikal mbi tokë me vëllim prej 1000 m³ me kapacitet të përgjithshëm prej 1000 m³, të cilin EKS FIS MAKEDONIA SHPKNP Petrovec e ka marrë me qira nga Shoqëria aksionare ORANZHERII f. Hamzali Bosillovë, dhe është shënuar në Listën pronësore nr. 30 për KK Hamzali, Bosillovë, në PK 589.

Kohëzgjatja e licencës:

Licenca është me kohëzgjatje prej 10 vjet

Mënyra dhe afati përfundimtar për parashtimin e propozimeve, mendimeve dhe sugjerimeve në lidhje me dhënie e licencës:

Të gjitha palët e interesuara juridike dhe fizike mund me shkrim të parashtojnë propozime, mendime ose vërejtjet deri të Komisioni rregullator për Energjetikë e Republikës së Maqedonisë në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të këtij Lajmërimi në shtypin ditor.

Adresa e Komisionit Rregullator për energjetikë të Republikës së Maqedonisë:

rr. “Makedonija” nr. 25, pallati Lazar Pop Trajkov, kati 6, 1000 Shkup

EKS FIS MAKEDONIA SHPKNP Petrovec

SHPALLJE PUBLIKE

Sipas nenit 46-b të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për përmbardim Gazeta Zyrtare e RM nr. 8 të datës 17.01.2008 ndërsa në lidhje me nenin 265 të LP Gazeta Zyrtare e RM nr. 72/2016 të datës 12.04.2016

Përmbardues Aleksandar Kuzmanovski nga Gotivari në bazë të kërkesës për realizim të përmbardimit nga kreditori Hallik Bank SHA Shkup nga Shkupi me seli në rr. “Sv. Kiril i Metohi” nr. 54, bazuar në dokumentin për përmbardim Akti noterial ODU nr. 121/2015 të datës 20.02.2015 të Nokterit Përparim Rexhepi, Gotivar, kundër borxhitul Ardjan Ramadani nga Gotivari me seli në f. Belovishtë dhe debitorit të pengut Qemal Ramadani nga Gotivari me seli në f. Belovishtë, për realizim të përmbardimit në vlerë prej 1.216.747,00 denarë për lëndën përmbarduese të regjistruar në I nr. 1958/2016 të datës 28.02.2018:

FTON

- Borxhulun Ardjan Ramadani dhe debitorin e pengut Qemal Ramadani të dy nga Gotivari me seli në f. Belovishtë, për shkak të dorëzimit të:
 - Konkluzionit për shtyrje të përmbardimit në bazë të nenit 81 paragrafi 1 të LP I nr. 1958/2016 të datës 18.01.2018 të Përmbarduesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gotivari
 - Konkluzionit për shtyrje e dytë publike me gojë në bazë të nenit 167 paragrafi 1, nenit 169 paragrafi 1, nenit 170 paragrafi 1 të LP I nr. 1958/2016 të datës 19.02.2018 të Përmbarduesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gotivari.
- Personin Zhivka Ançevska nga Shkupi me banim në bul. lindin 9-4 për shkak të dorëzimit të:
 - Konkluzionit për shtyrje të përmbardimit në bazë të nenit 81 paragrafi 1 të LP I nr. 1958/2016 të datës 18.01.2018.
 - Lajmërim nga 20.02.2018,
 - Konkluzionit për shtyrje e dytë publike me gojë në bazë të nenit 167 paragrafi 1, nenit 169 paragrafi 1, nenit 170 paragrafi 1 të LP I nr. 1958/2016 të datës 19.02.2018 të Përmbarduesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gotivari.

Në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor.

PARALAJMËROHEN borxhulul Ardjan Ramadani, debitor i pengut Qemal Ramadani dhe personi Zhivka Ançevska se mënyra e këllitë e dorëzimit konsiderohet si e rregullt dhe se pasojat negative që mund të dalin do t'i bartë vetë pala.

Kjo shpallje paraqet SHPALLJEN E GJASHTË.

Përmbardues
Aleksandar Kuzmanovski

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

HAZARD BLOKON RINOVIMIN ME ÇELLSIN

SHPRESON TË TRANSFEROHET TE REALI

Hazard po "zvarritet" për një marrëveshje të re në "Stamford Bridge", me shpresën se Reali do të vihet në rrugën e tij. Ndërkohë, "Daily Mail" shkruan se edhe Kurtoa është në ankth për të ndjekur Hazardin në kryeqytetin spanjoll dhe po pengon, gjithashtu, ofertën e "Blues" për një marrëveshje të re

Eden Hazard do të blloktojë ofertën e rinovimit të Çellsit me shpresën për të siguruar një lëvizje verore te Real Madrid, sipas "Daily Mail".

Lojtari i kombëtares së Belgjikës kërkon të largohet, por interesi i Real Madridit mund të kthehet në veprim këtë verë vetëm nëse Zinedin Zidane mbetet trajner në "Bernabeu". Raporti, gjithashtu, thotë se Tibaut Kurtoa është në ankth për të ndjekur Hazard në kryeqytetin spanjoll. Ylli belg u duk një figurë e frustruar si sulmues i vetëm në humbjen e dëshpë-

ruar 1-0, ndaj Mançester Sitit, të dielën. Dhe tani, Hazard po "zvarritet" për një marrëveshje të re në "Stamford Bridge", me shpresën se Reali do të vihet në rrugën e tij. Real Madridi ka pasur një fushatë të tmerrshme të La Ligas, por Zidane ia doli të marrë një fitore bindëse ndaj PSZH-së në ndeshjen e parë të 1/8 finale të Ligës së kampionëve. Hazard ka thënë shumë herë se Zidane është idhulli i tij. Në anën tjetër, Çellsit është i dëshpëruar për ta mbajtur yllin belg, me trajnerin Antonio Conte në dalje. Edhe portieri Tibaut Kurtoa shpreson të ndjekë Hazardin te Real Madridi dhe po pengon, gjithashtu, ofertën e "Blues" për një marrëveshje të re.



Barcelona ndjek Mendyn

Ferland Mendy, mbrojtësi i majtë 22-vjeçar i Lionit, gjendet nën një monitorim të gjerë nga trajnerët e Barcelonës me qëllim të përfshirjes së mundshme. Kjo është ajo që thotë "France Football" në një informacion që zë një vend preferencial në faqet e saj. "France Football" e kualifikon si të shkëlqyer sezonin e tij të parë në Ligue 1, prandaj futbollisti i Lionit ka kapur vëmendjen e Barcelonës, i cili e ka ndjekur atë që nga debutimi në "Le Havre". Revista e njohur sportive franceze, që jep "Topin e Artë" nga viti 1956, kujton se klubi katalanas ishte një vit më parë në gjurmët e një tjetër Mendy, në këtë rast të Benjamin, por nuk u materializua kurrë, sepse interesi përfundoi ndryshe, në itinerarin Monako-Mançester Siti. Sipas

këtij informacioni, skautët e Barcelonës e kanë verifikuar tashmë emrin e tij. Mendy do të ishte një kandidat për t'u bërë "alter ego" e Zhordi Alba, me cilësitë për t'u përshtatur me stilin e lojës së ekipit katalanas. Me një kontratë deri në vitin 2022 me Lionin, Ferland Mendy ka luajtur 23 ndeshje zyrtare këtë sezon, duke kontribuar me tre asistime. Barcelona ka tashmë një histori të gjerë merkatore me klubin francez, edhe një marrëdhënie të shkëlqyer me skuadrën franceze, ku mori Samuel Umtiti dhe një tjetër mbrojtës të majtë, që ka lënë gjurmë te Barcelona, Erik Abidal. Mendy do të jetë lojtari i ardhshëm?

S'do të qëndroj edhe 5 vite të tjera këtu

David Alaba shkakton panik te Bajerni i Muniut me intervistën e tij dhënë për revistën austriake "Kurier". Anëtori i kampionëve në fuqi të Bundesligës është shprehur se mendon largimin nga bavarezët për të ndryshuar ambient dhe për një sfidë të re në karrierën e tij. Kontrata e 25-vjeçarit me Bajernin përfundon në vitin 2021, por pas prononcimit të tij të fundit vështirë se do të rinovohet. "Jam i bindur që një ditë do të më duhet të marr një vendim. Ndiem shumë mirë këtu, por e imagjinoj veten në një rrugë tjetër, duke hedhur një hap para ose kërkuar një sfidë të re", u shpreh Alaba. Një sinjal ky i Alabas për klubet e mëdha evropiane, mes tyre edhe Barcelona, që ka tentuar prej kohësh blerjen e fut-

bollistit të Kombëtares së Austrisë. "E lë të hapur mundësinë e largimit nga Bajerni. Për momentin jam i përqendruar tek objektivat që kam për këtë sezon. Çfarë mund të ndodhë në të ardhmen? Nuk besoj se do të qëndroj edhe 5 vite të tjera këtu", deklaroi Alaba. Te Barcelona mendojnë se Alba ka profilin e futbollistit që do të përshtatej në mënyrë perfekte me lojën e "blaugranave". Alaba e hodhi hapin e parë, tani u takon katalanëve t'i drejtohen Bajernit me ofertën e duhur.



Publicitet

Republika e Maqedonisë
SHF "D-r. Vladimir Pollezinoski"
Nr. 04-89/01
06.03.2018
Kërçovë

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM nr. 145/2014) dhe në bazë të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008) dhe më pajtim me lajmërimin nga MASH për pëlqimet e miratuara për punësim të vërtetuara me nr. 12-14369/6 të datës 25.01.2018, lajmërimin të Ministrisë së financave dhe Vendimit të UD Drejtorit të vërtetuar nën nr. 02-88/1 të datës 06.03.2018, SHF "D-r. Vladimir Pollezinoski" Kërçovë, publikon

SHPLLJE

Për themelimin të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar të punës – financim i vjetër në SHF "D-r. Vladimir Pollezinoski" Kërçovë edhe atë për:

1. Një ekonom – nikoqir (40 orë pune)

Kandidatët duhet të përbushin kushtet sipas LMP dhe LAF. Pagesa fillestare për punëtorin nën pikën 1 është 14.992,00 denarë. Orët javore për punë do të jenë prej ditës së hënë deri ditën e premte. Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit, zgjedhja e kandidatëve do të realizohet brenda afatit të paraparë me ligj më së voni deri më 21.03.2018. Kandidatët duhet të parashtrorin dokumentacion në pajtim me LAF dhe LMP, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter. Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit. Dokumentet të parashtrorin personalisht ose përmes postës në adresën: SHF "D-r. Vladimir Pollezinoski" Kërçovë rr. "Arso Vojvoda" pn.

SHF "D-r. Vladimir Pollezinoski"
Kërçovë

Nuk e përjashton rikthimin në Evropë

Sulmuesi i Tianjin Quianjan, Alexandre Pato thotë se nuk e përjashton ndonjë rikthim të mundshëm në Evropë në të ardhmen. "E ardhmja? E ardhmja është gjithmonë e vështirë për t'u programuar, siç domos në botën e futbollit. Le të shohim se çfarë do të ndodhë në muajt në vijim, por nuk dua të përjashtoj një rikthim të mundshëm në Evropë", thotë Pato. "Kam luajtur me Milanin në ligën italiane, me Villarealin në La Ligën spanjolle dhe me Çellsin në Premier ligën angleze", shtoi sulmuesi brazilian. "Jam gjithmonë i hapur për mundë-



sitë e reja, kështu që të shohim. Koha do të tregojë, por unë jam i qetë", u shpreh futbollisti, i cili ka realizuar 17 gola në 26 paraqitje për Tianjin Quianjan në vitin 2017.

Në këtë përballje gjithçka është e hapur, pavarësisht se skuadra angleze e sheh vetën në epërsi pas shënimit të dy golave në ndeshjen e parë dhe me një barazim eventual 1-1, do ta sheh vetën në çerekfinale, derisa "zonja e vjetër" duhet të fitojë në "Wembley" ose të arrin një barazim 3-3 ose më lart në rast se dëshiron të plasohet në çerekfinale

Juventus vazhdon të jetë e impenjuar në të gjitha kompeticionet, Serie A dhe Kupën e Italisë, ndërsa në Ligën e kampionëve duhet të përballlet akoma me Totenhemin, për një vend në çerekfinalen e kompeticionit më elitare në kontinent, pas barazimit 2-2 në shtëpinë e bardhezinjve në takimin e parë. Në këtë përballje gjithçka është e hapur, pavarësisht se skuadra angleze e sheh vetën në epërsi pas shënimit të dy golave në ndeshjen e parë dhe me një barazim eventual 1-1, do ta sheh vetën në çerekfinale, derisa "zonja e vjetër" duhet të fitojë në "Wembley" ose të arrin një barazim 3-3 ose më lart në rast se dëshiron të

LIGA E KAMPIONËVE, NDESHJET KTHYESE TË 1/8 SË FINALES

TOTENHEM - JUVE, GJITHÇKA E HAPUR



plasohet në çerekfinale. Ndryshe, për këtë sfidë trajneri Masimilano Allegri po ballafaqohet me probleme. Në fakt Gonzalo Higuain pritet të jetë në skuadrën e Juventusit, por Mario Manxhukij mbetet në dyshim. Higuain nuk luajti ndaj Lacios për shkak të shtrembërimit të

kycit të këmbës, por ai ka kaluar nëpër seancën e plotë të trajnimit të së hënës me shokët e tjerë të skuadrës, kurse sulmuesi kroat është trajnuar veçmas nga pjesa tjetër e ekipit dhe është një dyshim i vërtetë për ndeshjen sotme. Në anën tjetër Paulo Dybala sigurisht

kthehet pas dy muajsh nga një dëmtim i rëndë, pasi ai luajti 90-të minuta kundër Lacios të shtunën në mbremje dhe shënoi golin fitues të këtij takimi. Nëse Higuain dhe Manxhukij nuk janë gati të fillojnë, atëherë Juventus pritet të përdorë një formacion 4-3-3 kundër To-

tenhamit me Daglas Kosta dhe Aleks Sandro në krahët e sulmit, pranë Dybalas si '9-sh' fals. Ndërkohë, trajneri i Totenhemit deklaroi se gjithçka është e hapur, pavarësisht se djemtë e tij arritën të barazojnë shifrat, madje duke shënuar dy gola në fushën kundërshtare. "Jam krenar që arritëm të dominojmë në Torino, por me rezultatin 2-2 asgjë nuk është vendosur ende", tha Poketino.

Në përballjen tjetër, Porto vihet përballë Liverpulit, një një "mision të pamundur" pas disfatës prej 4-0 në ndeshjen e parë në Portugali. Portos do t'i duhet pesë ose më shumë gola në rast se dëshiron të kualifikohet më tutje. Për këtë sfidë trajneri i Liverpulit Jurgen Klop nuk ka ndërmend të lërë pushim asnjë nga tre sulmuesit Mane, Salah të cilët kanë shënuar së bashku 21 gola në këtë edicion të Ligës së kampionëve. Cekim, Liverpuli është një nga tre skuadrat që nuk e ka provuar shijen e humbjes në këtë edicion të "Champions League", ashtu si Totenhem dhe Barcelona.

Kaljari dhe Fiorentina tërheqin numrin 13



Kaljari dhe Fiorentina kanë vendosur të tërheqin numrin 13-të përgjithmonë nga fanellat e tyre. Kjo për të nderuar Davide Astorin pas vdekjes tragjike të tij në mëngjesin e së dielës. Kapitani i Violas, pësoi një sulm në zemër teksa ishte duke fjetur në hotelin e skuadrës në Udine, pak orë para ndeshjes ndaj Udinezes. Ai ishte pjesë e Kaljarit për gjashtë vite,

para se të huazohej te Roma dhe pastaj të kalonte te Fiorentina, ku luajti për katër sezone. Sot (e martë) të dy klubet e lartpërmendura njoftuan publikun se kanë vendosur të pensionojnë numrin 13-të, që më herët ishte bartur nga Astori. Vlen të theksohet se rezultat zyrtarë të autopsisë ende nuk janë publikuar. Funerali i 31-vjeçarit do të mbahet të enjten.

Gattuso "kërcënon" Ançelotin

Janë vetëm dy ditë të mbetura nga ndeshja Milan-Arsenal dhe ekipi i Gattusos nuk ka ndërmend ta ndalë stilin e tij pozitiv. Po, sepse me numrin e golave të shënuara rregullisht dhe efikasitetin mbrojtës, kuqezinjtë kanë arritur në një seri prej 13 lojërash të njëpasnjëshme pa humbje, në të gjitha garat. Siç dëshmohej nga "Corriere dello Sport", "Ringhio" ka filluar të rritë shpejt pozicionet në renditje në historinë e fundit të Milanit. Në këtë mijëvjeçar, në fakt, rekordi i ndeshjeve pa humbje të kuqezinjtë është mbajtur nga Karlo Ançeloti, i cili ka arritur në kuotën e 16 sfidave. Gattuso është aktualisht në nivelin e 13-të, në një nivel me Milanin e Leonardos në vitin 2009. Bilanci i këtyre 13 ndeshjeve të dobishme e të njëpasnjëshme ka 9 fitore dhe 4 barazime. Dhe, sikur të mos ishte e mjaftueshme kjo, skuadra e Gattuso



sos nuk i nënshtrohet golit të pësuar në 6 lojëra të njëpasnjëshme: sfida e dyfishtë kundër Ludogorets, kthimi i Kupës së Italisë kundër Lacios dhe ndeshjet e Seria A kundër SPAL, Sampdoria dhe Roma. Kalendarari në dorë do të ishte i mjaftueshëm që të mos humbasë në sfidën e dyfishtë kundër Arsenalit dhe në kampionat kundër Xhenoas për të

barazuar një rekord prestigjioz të historisë së kuqezinjtë. Ndërkohë, për dy ditë "San Siro" është i gatshëm të përcjellë garën më të mirë. Edhe nëse është "Europa League" dhe jo Liga e Kampionëve, Milani do të kthehet për të jetuar një natë evropiane me një stadium të mbushur plot, me 70 mijë tifozë. Një pamje që të lë pa frymë...


ME MARRËVESHJEN E ARRITUR ME "RT" PËR KUPËN E BOTËS

Murinjo do të fitojë katër herë më shumë se Messi

Murinjo ka arritur një marrëveshje me rrjetin televiziv rus "RT" për të bashkëpunuar në transmetimin e disa lojërave dhe për të ndarë idetë rreth Kupës së Botës, që fillon për pak muaj. Në parim, kontrata e tij është për katër ditë të turneut dhe në këmbim do të marrë 1.9 milionë euro për të marrë pjesë në "Rusia 2018", në ceremoninë e hapjes dhe të qëndrojë atje ato ditë, sipas "Daily Mail". Domethënë, trajneri i Mançester Ju-

naitedit do të përfitojë nga 475.000 euro për secilën ditë që ka për të kaluar në territorin rus. Trajneri portugez, gjithashtu, do të komentojë për televizionin në fjalë rus edhe finalen e turneut, por në atë rast do të jetë nëpërmjet një lidhjeje satelitore dhe nuk do të jetë e nevojshme që ai të udhëtojë në vendin organizator të Botërorit të kësaj vere. Në mes të turneut, Murinjo do të përfitojë për të pushuar me familjen e tij. Me këtë

kontratë, Murinjo do të përfitojë në një ditë më shumë se sa merr Leo Messi në Barcelonë, po në një ditë normale, pasi argjentinas ka një kontratë prej 40 milionë eurosh në vit, ose një 110.000 euro në ditë. Thënë ndryshe, trajneri aktual i Mançesterit, me këtë kontratë, do të përfitojë katër herë më shumë se ylli argjentinas i Barcelonës në ditë, në periudhën e zhvillimit të fazës finale të Kupës së Botës në Rusi.





DASHI 21. mars - 20. prill

Përpiquni të analizoni situatën për të rregulluar më mirë atë që nuk jeni duke bërë veçanërisht në jetën private. Shmangni grindjet nëse doni mbështetjen e partnerit/es. Beqarët do të duhet të pranojnë ftesat për takime nëse duan t'i kthehen dashurisë. Venu-si është në favorin tuaj. Ditë pozitive ju presin në sferën profesionale, ju mund të mbyllni negociata interesante.



DEMI 21. prill - 21. maj

Pas një analize të kujdesshme të ndjenjave tuaja dhe pas pranimit të gabimeve, jeni gati të filloni përsëri një marrëdhënie të shkëlqyer në të cilën keni përqendruar të ardhmen tuaj. Zembrat e vetmuara duhet të jenë të kujdesshme që të mos bien në iluzione. Nuk ka emocione të madha në qiellin tuaj. Dita është plot ambicie në sferën profesionale, mund të arrini një qëllim të rëndësishëm!



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Dashuria sot do të jetë në krye të mendimeve tuaja, ju do të rrëmbeni nga një pasion i jashtëzakonshëm që do t'ju bëjë të jetoni një ditë të lumtur. Mbrëmje e bukur për çiftet! Yjet favorizojnë beqarët e guximshëm dhe iniciativë që duan të lënë pas disa kujtime të këqija. Do jeni të kënaqur me atë që ju sjellë përfundimi në punë, falë Hënës në shenjë. Besoni veten dhe atë që bëni!



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Është një kohë e mirë për të jetuar intensivisht një histori dashurie që sapo ka filluar. Ata që kanë një lidhje të gjatë mund të shprejnë për një të ardhme edhe më të lumtur. Miqësi të reja parashikohen për zembrat e vetmuara, Marsi i mbështet me dashamirësinë e tij. Fokusimi në vullnet dhe qëndrueshmëri për të kapërcyer çdo vështirësi. Ju gjithashtu do të gjeni një pikë takimi me kolegët.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Projekte të reja për jetën private, çiftet e qëndrueshme mund të mendojnë të marrohen ose të fillojnë një bashkëjetesë. Erosi bëhet intensiv dhe i gjallë, ndihmon në gjetjen e balancave të reja. Beqarët do të bëjnë njohje interesante me të cilët do të arrijnë në mendime të njëjta. Në fushën profesionale, aftësia për të kapur në ajër ndjenjën e gjërave do t'ju japë një avantazh mbi kolegët.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Për shumë prej jush fillon një periudhë shumë e zënë, veçanërisht për ata që janë në çift kohët e fundit. Dialogu në çiftet e vjetra do të jetë i hapur. Beqarët do të duhet të dalin në takime përpara se të jetë tepër vonë. Frika për t'u refuzuar nuk ju braktis! Sot do të ishte më mirë të mos krijoni shumë iluzione për mundësitë profesionale: ato nuk mund të shkojnë siç shpresoni.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Do të jetë një e martë plot lumturi për shumë të lindur të Peshores. Të pasionuar dhe krijues, do befasoni partnerin/en me ndonjë surprizë të këndshme. Yjet premtojnë një periudhë rozë për ndjenjat! Beqarët nuk do të ketë kohë për tu mërzitur me aventura intriguese dhe flirte. Mundësi të mira në punë, udhëtimet janë të favorizuara të zgjerojnë horizontet tuaja.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Një sqarim me të dashurin/en tuaj do të lehtësojë zemrën tuaj dhe do të sjellë ekuilibrin në jetën tuaj private. Mbrëmja në familje është shumë e këndshme. Yjet premtojnë dashuri të reja për zembrat e vetmuara në kërkim të shpirtit binjak, ju do të keni mundësi për të zgjedhur! Në punë nuk është koha për të marrë një hap të rrezikshëm. Vetëm në këtë mënyrë planet tuaja do të jenë të suksesshme.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Me Hënën negative, disponimi do të jetë gri dhe energjia juaj do të ndikohet gjithashtu. Nëse diçka shqetëson marrëdhënien tuaj të martesës, përpuni të merrni më afër partnerin/en tuaj. Mbrëmja favorizon takime për beqarët. Perspektiva interesante për ata që kanë ndryshuar vendet e punës, do të gjeni veten duke përjetuar një situatë të re në një nivel profesional.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Jeta në çifti vazhdon të rezervojë shumë surpriza, jeta e përditshme zbavitëse nuk ju shqetëson dhe gjithashtu e vlerësoni rutinën. Meritë e dashurisë! Beqarët do të jenë në gjendje të nisin takimet e reja, një mbrëmje shumë intensive ju pret! Arritja e qëllimeve të caktuara në punë kërkon angazhim. Së shpejti do të vijin lëvdatat dhe kënaqësitë.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Ditë e mrekullueshme, yjet janë në mbështetjen tuaj. Por dikush do të dëshirojë ta prishë këtë harmoni duke ju shkatëruar dhimbje koke, ju mund të rrezikoni një histori serioze. Venu-si ndihmon beqarët të marrin një vendim me qetësi. Ndërrime në hyrje dhe ndryshime rrënjësore për shumë Ujor. Mundësi për të gjetur zgjidhje dhe fitime të reja.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Yjet shpallin një qiell të pastër për çiftet që duan të konsolidojnë lidhjen e tyre. Jini të kujdesshëm! Beqarët do të kenë një pyetje për të zgjidhur me një ish, por nga ana tjetër kanë shumë mundësi të bien në dashuri! Jini në dispozicion të kolegëve që kanë nevojë për ndihmë, por mos harroni qëllimet tuaja.




21 VJET PA TË DASHURIN TONË

PROFESOR NAKIL ABDIU
24.02.1939-07.03.1997

Ti ishe shembull për të gjithë ne, e veçanërisht për dhjetëra generata nxënësish që ende të kujtojnë me mburrje dhe mall. Gjithmonë na udhëzove të duam arsimin dhe vlerat kombëtare. Edhe pse ka kaluar shumë kohë që kur nuk je në mesin tonë, ne gjithmonë do të kemi të freskët kujtimin për ty.


E përkujtojnë: Fëmijët, nipërit, mbesa dhe e tërë Familja Abdiu nga fshati Bogovinë-Tetovë.



KALUAN SHTATË VITE NGA VDEKJA E BABAIT, VJEHRIT DHE GJYSHIT TON TË DASHUR

SABRI MARKU
1933-2011

Dhembjen që na le tash e shtatë vite, nuk mund ta mposht koha që kalon. Koha kalon, por Ti je gjithmonë në zemrat tona. Energjinë, forcën dhe dashurinë që na dhuroje, do të na mungojnë çdoherë, dhe ne të kujtojmë ashtu si ishe dhe virtytet tuaja të larta të një bashkëshorti, babai dhe gjyshi do i përcjellim në brezat e rinj të nipërve dhe mbesave në rritje. Ooftë i përgjeshëm kujtimi për Ty, pusho i qetë në amshim. Të përkujtojnë: FEMIJT nga Dibra, Kosova dhe Amerika



Mensur Mamuti	DREJTORI I PARË I SHKOLLËS SË PARË SHQIPE, SOTIRI	YLLI MË I SHNDRITSHËM I YJESISË SË SHQIPONJËS	HOXHË VOKA I DIBRES, NAJDENI	TEMPERATURA	M	BANOR I RUSISË
TEMIZ, PAQ					Ë	
PËREMËR VETOR				STRUGA ISHULL NË OQEANIN PAQËSOR	S	
EMRI I VJETËR I NISHIT					U	
7 MARS	D	I	T	A	E	PUSHKË E GJATE ME PESË FISHEKE
ERBIUMI QYTET NË KROACI			INSTIT. FOR SUPPLY MANAGEMENT NGEL		S	
MËSUESI QË E VRAU ESAT PASHËN DREJTUES I SHKOLLËS SË PARË, PETRO	A	MBIN	PRINCESHA E EPIRIT, NËNA E LEKËS SË MADH AKTORJA FRËNGJE, EME		I	
A				QYTET NË INDONEZI DREJTUES I SHKOLLËS SË PARË, NAÇO	T	
DREJTUES I SHKOLLËS SË PARË, PETRO MI FEMËR (DEM. SH.)				PJESË E LIGJIT LLOJ ËMBELSIRE		ZORRO NDARËS DHOMASH
M						AKTORJA AMERIKANE, UEST NOTË MUZIKORE
RUMANIA		KALIUMI SËMUNDJE E DHEMBIT		E HAPUR GJINITË		
MBRETËRIA E BASHKIJAR			SPORTISTI ME SKI QYTETI KU U THEMELUJA SHKOLLA E PARË SHQIPE (FOTO)			
PJËE JAPONËZE						
LLOJ ECJEJE TË KALIT KËNGËTARJA AMERIKANE, LAURA						
V						
QYP BALETE PËR UJË LLOJ DRURI (SH.)						
L						



ZGJIDHJET: M, PASTER, ATA, SU, NAISUS, DITA E, ER, ISM, A, OLIMPIA, AVRAMI, BATU, NINI, NEN, Z, MINUSKAT, ME, R, K, E CELUR, UK, SKITARI, SAKE, TROK, VEIRS, MEÇE, LISAT



U fal ushqim të pastrehëve, shqiptari habit Gjermaninë

Dyqani i tyre është i vogël, por zemra e tyre shumë më e madhe. Pronarët e "Ceaser-së", një piceri në Berlin-Steglitz ofron në këtë dimër të ftohtë pica falas dhe çaj të ngrohtë për të pastrehët në këtë zonë. "Këta janë heronj të vërtetë të lindjes së Berlinit!", këto janë fjalët e ngrohta me të cilat Bild.de përshkruan veprën bamirëse të një familje shqiptarësh, që zotërojnë një piceri në Berlin.

Sipas gazetës së njohur gjermane me dyqanin e tij 31-vjeçari Albion Visoka thjesht dëshiron të bëjë diçka të mirë, duke ndihmuar më të pamundurët. "Njerëzit kanë nevojë për ndihmën tonë në këto

temperatura, dhe shpresoj se mund të motivoj shumë të tjerë të bëjnë si unë", thotë ai. I riu u arratis nga Kosova me familjen e tij në 1997 drejt Gjermanisë. Babai i tij, Nasko Visoka (60), është krijuesi i pasionuar i picerisë "Ceaser's", ku familja përbën një ekip profesionistësh të s'prouar me jetën. Për dy vjet, ata kanë furnizuar njerëzit e pastrehë me ushqim falas gjatë dimrit. Albioni thotë: "Kryesisht i përbuzin, ndërsa unë kërkoj që t'i ndihmojë dhe me postimin në Facebook, e kam më të lehtë të arrij shumë më tepër njerëz". Ai shkroi një javë më parë: "Ne, të 'Ceaser-së', për fat të keq, nuk mund të si-

gurojë strehim të ngrohtë, por ne duam t'iu japim të gjithë të pastrehëve nga një filxhan të ngrohtë me çaj në shenjë mbështetëse". "Që nga postimi kemi disa telefonata në ditë", thotë ai për Bild.

Prej asaj dite Ceaser's ka bërë deri në dhjetë Berlinezë që jetojnë në rrugë të lumtur çdo ditë. Njëri prej tyre është Sven. Ai ulet i mbështjellë në çantën e tij të gjumit në një stol të parkut duke dëgjuar muzikë nga radioja e tij e vogël. Sytë e tij shkëlqejnë kur dëgjon Albionin të thotë: "Hej miku im, a dëshironi një pizza?". Sven falënderon me një buzëqeshje.



Zbulohen 150.000 pinguinë, për të cilët askush nuk dinte gjë

Gjatë 40 viteve të fundit numri total i pinguinëve adeliae (*Pygoscelis adeliae*) një nga më të zakonshmit në gadishullin antarktik zvogëlohej vazhdimisht. Ose të paktën këtë besonin biologët. Tani një studim i publikuar në "Nature" sinjalizon që po humbim një koloni të madhe prej 150.000 në ishujt Peligro, një zinxhir ishujsh shkëmborë rreth ekstremit verior të gadishullit antarktik. Deri para pak kohësh ishujt Peligro nuk ishin një habitat i rëndësishëm për pinguinët. Këto koloni nuk janë zbuluar për dekada për shkak të largësisë së ishujve si dhe për shkak të ujërave që i rrethojnë. Edhe në verë oqeani përreth është i mbushur me akuj, çka e vështirëson hyrjen në këta ishuj. Në vitin 2014 ekipi i Lynch zbuloi njollat e glava në imazhet e Nasës në ishuj duke aluduar për një sasi misterioze të madhe të pinguinëve. Për të qenë të sigurt Lynch organizoi një vizitë në ishuj me objektivin për të numëruar zogjtë. Kur grupi mbërriti në dhjetor të 2015 gjetën qindra mijëra të tillë dhe filluan menjëherë t'i numëronin me sy të lirë dhe përmes një droni për t'i numëruar në vendet ku ishte e pamundur të arrinin. Imazhet e marra nga droni u hodhën në një software. Numri i pinguinëve mund të japë informacion jo vetëm për dinamikën e popullatës së tyre, por edhe për efektet e ndryshimit të temperaturave dhe të akullit në ekologjinë e rajonit.



A po harrojnë fëmijët si mbahet lapsi?



Teknologjitë e reja kanë ndryshuar jetët tona. Në shumicën e rasteve për mirë, por ka edhe pasoja të tjera që nuk janë edhe aq pozitive. Në ndryshim nga brezat e kaluar fëmijët e sotëm ndërveprojnë gjithnjë e më tepër me kompjuterë ose aparate të tjera dhe kalojnë më pak kohë duke kryer punë tradicionale manuale. Një studim i realizuar në Britani nga terapeutët e "Heart of England foundation NHS Trust" tregon që shumë fëmijë nuk dinë si të mbajnë korrekt lapsin. Sipas të dhënave fëmijët britanikë kanë mesatarisht 10% më pak forcë dhe shkathtësi në duart e tyre sesa brezat e mëparshëm dhe kjo përkehet se shumë kanë vështirësi për të shkruar me laps. Sipas studiuesve të këtij hulumtimi fë-

mijët e kapin të gjithë në mënyrë të njëjtë ashtu siç do ta kapte një njeri i shpellave. Terapeutët shpjegojnë që lëvizjet e dorës dhe muskujt e përfshirë në të, për të shkruajtur, nuk janë të njëjtë me ato lëvizje që përdoren për aparatet teknologjike. Për ta mbajtur si duhet lapsin, fëmijëve u duhet stërvitje e vazhdueshme për disa vite dhe zvogëlimi i kohës që u duhet për këtë aktivitet zvogëlon edhe aftësinë e tyre. Gjithsesi jo të gjithë ekspertët bien dakord me këtë përfundim dhe thonë që ka shumë shkaqe që mund të ndikojnë në këtë aftësi. Ka nevojë për studime më të zgjeruara për të konfirmuar që kjo situatë i atribuohet një efekti të padëshirueshëm të teknologjive të reja.


KALENDARI HISTORIK 7 MARS

- 1530 - Kërkesa për divorc e Mbretit Henri VIII refuzohet nga Papa, pastaj Henri thotë se jo Papa por ai është kryesori i Kishës angleze.
- 1573 - Turqia dhe Venediku nënshkruajnë marrëveshje paqësore.
- 1814 - Napoleoni I i Francës fiton Betejën e Kraonit.
- 1876 - Alexander Graham Bell patenton telefonin.
- 1911 - SHBA dërgon 20.000 trupa në kufirin me Meksikën.
- 1912 - Roald Amundsen shpall zbulimin e Polin të Jugut.
- 1914 - Princi Wilhelm von Wied shpallet Mbret i Shqipërisë.
- 1936 - Hitleri thyen Marrëveshjen e Versajës, dërgon trupa në Rajnland.
- 1941 - 50.000 trupa britanike zbarkojnë në Greqi.
- 1976 - Maroku dhe Mauritania ndërprejnë marrëdhëniet diplomatike me Algjerinë.

Petku i bardhë që mbajnë priftërinjtë gjatë kohës së lutjeve apo ceremonive fetare, tregon hirësinë dhe ndërmjetësimin e tyre mes Zotit dhe besimtarëve. Ndryshe ky petk i bardhë njihet me emrin Alba. Poashtu, shiriti i bardhë që është nën këmbishë tregon dashurinë, besnikërinë dhe adhurimin që klerikët fetarë kanë ndaj zotit.



Gjatë Luftës së Dytë Botërore, fuqitë e mëdha ishin përkrahëse e ndonjërit prej shteteve. Mes tyre ishte edhe Franca, si përkrahësja me e madhe e Serbisë. Pas përfundimit të luftës, Serbia në shenjë të respektit dhe përkrahjes që kishte nga Franca, në sheshin Kalemegdan (Beograd) e ndërtoi një Pllakë falënderuese ku ndër të tjerash shkruan: "Të duam Francë, sepse edhe ti na do neve".



BURRI DHE PSIKIATRI

I ankohet burri psikiatrit:
- Më ndihmo doktor, nuk mund ta shoh më me sy gruan time!
- Po e shoh se paskan përfunduar ditët e mira në lidhjen tuaj. Gjërat do të bëhen keq e më keq. Mendoj se do t'ju ndihmonte nëse shkoni në det.
- Jo bre doktor. E keqja është se ajo di not.



Nëse kërkon vetëm fjalë, pyet një burrë; nëse kërkon vepra, pyet një femër.
(Margaret Thatcher)

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS